RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIM I PËRPUTHSHMËRISË

"AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA (AAPSK)"

Tiranë, më Dhjetor 2017

Nr.	Përmbatja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**	**3-10**
II.	**HYRJA**	**10-13**
a.	Objektivat dhe qëllimi	10
b.	Identifikimi i çështjes	10
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
d.	Përgjegjësitë e audituesve	11
e.	Kriteret e vlerësimit	12-13
f.	Standardet e auditimit	13
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**13-14**
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**14-70**
	Pika 1 e Programit të Auditimit *Auditim mbi vlerësimin e bazës rregullative të funksionimit të Agjencisë.*	14-21
	Pika 2 e Programit të Auditimit *Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.*	21-41
	Pika 3 e Programit të Auditimit *Auditim mbi menaxhimin financiar dhe ligjor të fondeve buxhetore të përdorura nga AAPSK".*	41-70
	REKOMANDIMET	**70-75**
V.	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	**76-84**
VI.	**ANEKSE**	**84-85**
VII.	**DOKUMENTE SHOQËRUESE**	**85-101**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 999/1 prot, datë 06.10.2017, u krye auditim "Auditim i Përputhshmërisë". Auditimi u krye i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë AAPSK Veprimtaria e Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore ku funksioni ekskluziv i kësaj agjencie, *miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara*. Ky administrim ka *si qëllim shtimin e vlerës së produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nëpërmjet ruajtjes, përdorimit, huapërdorjes dhe tjetërsimit dhe si pasojë nxjerrjen e të ardhurave*.

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga AAPSK gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim dhëniën e një sigurie objektive kësaj Agjencie gjatë veprimtarisë së saj .
Nga auditimi i ushtruar në AAPSK gjatë periudhës së auditimit për vitin 2016-30.09.2017, vihet re se, reforma ligjore ka ndikuar pozitivisht në miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara duke miratuar një sërë aktesh nënligjore të cilët kanë parashikuar mënyrat e përdorimit të këtyre pasurive duke mundësuar një kuadër ligjor të plotë dhe dhe në përputhje me Konventat ndërkombëtare si dhe në harmonizim me legjislacionin e brendshëm. Por pavarësisht nga panorama ligjore e cila është e plotë, nga statistikat e AAPSK-së rezulton se ka pasuri të cilat nuk janë dhënë në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji. ***Kjo tregon vështirësitë që ka kjo agjenci e cila nuk ja ka arritur qëllimit kryesor të saj miradministrimin duke shtuar vlerën financiare të këtyre pasurive***, disa nga këto vështirësi konsistojnë në:
-Pasaktësi (konfuzion) në vendimet e gjykatave përsa i përket përputhjes ne teren te sipërfaqeve të tokës dhe pozicionimin e objekteve, shumat e sekuestruara apo konfiskuar, të dhënat identifikuese të shoqërive etj .
-Konfiskimi i 27.342 % te dy apartamenteve(vlerësim i pamundur).
-Ekzekutimi i revokimit te llogarive bankare pa prezencën e përmbarimit dhe administratoreve të AAPSK-së, por vetëm me marrjen e vendimit te gjykatës.
-Mosparaqitja ne ekzekutim e topografëve apo e përfaqësuesve të pushtetit lokal ne rastin e mungesës së subjektit të cilit i sekuestrohet apo konfiskohet pasuria.
Pajisja me dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e procedurave nga institucione të ndryshme shtetërore si ZQRPP dhe DSHTR etj.
Agjencia është e ekspozuar më së shumti ndaj riskut të administrimit të pasurive të konfiskuara sipas nenit 36 të Kodit Penal, si produkte të rrjedhura nga vepra penale por me ndryshimin që këto pasuri konfiskohen vetëm pasi kemi një vendim penal të formës së prerë, ku personi të jetë deklaruar fajtore.

Kështu përvec shpenzimeve që mbart vetë proçesi i administrimit, është i lartë dhe risku i kthimit të këtyre pasurive shoqëruar dhe me padi gjyqësore për fitimin e munguar gjatë periudhës së administrimit nga AASPK.
Kjo agjenci mundësitë e saj për të tjetërsuar pronën apo për të mirë administruar këto pasuri i ka të kufizuara, kur nuk ka titullin e pronësisë. Detyrimi u lind autoriteteve të tjera të zbatimit të ligjit që të vendosin konfiskimin mbi pasuri të tilla, ku kryesisht rolin kryesor e luajnë vendimet e gjykatave.

GJETJE NGA AUDITIMI:

Gjetje nga auditimi, **në zbatimin të Menaxhimit Financar dhe Kontrollit:**
a.Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-^{së} nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.
b.Për vitin 2016-2017, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të AAPSK-^{së}, por nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.
c. Megjithëse janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave, nuk ka miratim nga Ministria e Financës dhe arkivim të kësaj gjurme.
d. Për vitin 2016 është hartuar rregjistri i riskut, dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i është ngarkuar kryeadministratorit, por pa e përditësuar në vazhdimësi dhe pa i ndarë risqet e përgjegjësitë. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III "Identifikimi i risqeve" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
e.Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë instutucion, pasi nuk lihen gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të saj.
f.Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, është hartuar **Kodin e Etikës**, por kamangësi në ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve.

Në zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe zbatimin e tij.
Nga auditimi i detajimit të projekt buxhetit dhe regjistrit të prokurimeve për zërat e shpenzimeve operative buxhetore për vitin 2016, konstatojmë:
-Nuk **janë futur në regjistrin** e prokurimeve blerje e shërbime si: Shpenzime për ngrohje, në vlerë 150 mijë lekë, një zë me vlerë të tillë që nuk ka pse të planifikohet; Mirëmbajtje paisje zyrash në vlerë 400 mijë lekë, apo blerje goma e pjesë këmbimi në vlerë 400 mijë lekë etj.
-Kanë **diferenca** të konsiderueshme regjistri i prokurimeve me projekt buxhetin si: Riparim automjeti, planifikuar për 50 mijë lekë në projekt buxhet dhe në regjister është për 375 mijë

lekë, apo 7.5 herë më shumë; Blerje kancelari dhe tonera, planifikuar për 480 mijë lekë dhe hedhur në regjistrin e prokurimit për 975 mijë lekë, apo mbi 2 herë më shumë, etj.
Megjithese realizimi i 602 në krahasim me projekt buxhetin dhe aprovimin e tij është në masën 100%, **ka ndryshime të mëdha** midis realizimit, apo tejkalimit të zërave që e përbëjnë atë, pra:
-Nuk janë realizuar fare disa zëra të programuar në vlerë 1,300 mijë lekë, pra dieta jashtë vendit në vlerë 200 mijë lekë, shërbime ngrohje në vlerë 150 mijë lekë, bleje pjesë këmbimi e goma në vlerë 400 mijë lekë, shërbime për mirëmbajtje ndërtimore në vlerë 130 mijë lekë, apo mirëmajtje zyrash në vlerë 400 mijë lekë.
-Janë realizuar disa zëra të pa programuar në buxhet si: ruajtje fizike e zyrave në vlerë 1,065 mijë lekë, instalime e riparime të ndryshme në vlerë 36 mijë lekë dhe shërbime interneti 93 mijë lekë.
-Ka ndryshime të mëdha vlerash midis realizimit dhe programimit si: Riparim automjeti realizuar më shumë për 244 mijë më shumë, apo 5 herë më shumë se programimi, sigurim automjetesh realizuar më shumë për 230 mijë lekë, apo 12.5 herë më shumë se programimi etj. Po ashtu sikundër ka zëra që janë realizuar shumë më pak nga programimi si blerje karburanti, energji, telefona dhe dieta brenda vendit.
-V**endime gjyqësore,** janë realizuar në vlerë **2,708 mijë lekë, ose sa 54%** e të gjithë 602, të cilat janë programuar në vlerë 1,300 mijë lekë, pra është realizuar më shumë se dyfishin e vlerës së programuar.
-Për vitin 2016, paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në **raportin e monitorimit** duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016"Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e këtij institucioni për vitin 2016, nuk janë raporte monitorimi sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në anekset përkatëse. Raporti i monitorimit të këtij viti *ka të plotësuara vetëm disa nga tabelat e* raportimit dhe jo relacionin e tij, ku mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit. Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arritjet edhe problematikat.
-Për vitin 2017, jashtë programimit dhe për herë të parë, është shtuar gjatë vitit në artikullin **604** "Transferta të brendëshme", vlera prej **25,000,000 lekë,** me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17928/2, datë 18.01.2016 "Dërgohet urdhër nr.9, datë 18.01.2016, për destinimin e fondit të posaçëm në mbështetje të urdhërit të ministrit të financave nr.84, datë 08.10.2014", vlerë, e cila do të përdoret për disa institucione e shoqëri për likujdime, e që vite më parë janë kryer direkt nga Ministria e Financës. Në këtë institucion dokumentacioni shoqërues i pagesave për këto transferta administroheshin nga Administratori i Terenit, ndërsa veprimet e likujdimit kryheshin dhe kontabilizoheshin nga Financjerja e institucionit, pa dokumenta shoqëruese, duke munguar kështu kontrolli i dyfishtë i këtyre veprimeve kontabël.

Mbi organizimim dhe mbajtja e kontabilitetit, nxjerja e bilancit dhe inventarizimi i pronës.
Organizimi dhe dokumentimi i veprimeve kontabël të aktivitetit nga fondet buxhetore është mbajtur dhe kontabilizuar në regull dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa kontabiliteti i aktivitetit të administratorëve dhe pronat që kanë ata në administrim, rezultuan me problematika regjistrimi, si:
a. Administratorët nga ana financiare, rakordojnë për shpenzimet dhe të ardhurat analitike me Kordinatorin Financiar të institucionit, i cili i kontrollon dhe regjistron ato në partitarë të

veçantë për çdo pronë dhe administrator, por pa i kontabilizuar ato në llogari të veçanta, në mënyrë që këto të ardhura dhe shpenzime të kenë rakordimin dhe kontrollin dyfish të tyre.
b. Për të ardhurat dhe shpenzimet për këtë aktivitet, ky institucion ka të hapur një llogari në bankën e nivelit të dytë "....." dhe lëvizjet e kësaj llogarie i regjistron bruto financierja e institucionit, por pa i kontabilizuar të ardhurat, apo shpenzimet në mënyrë analitike dhe në administrim të kujt prone janë. Në regulloren e brendëshme të këtij institucioni nuk është përcaktuar qartë se kujt i takon mbajtja, regjistrimi dhe nxjerrja e rezultatit nga aktiviteti i administratorëve. Në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar citohet: "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar, ose në bartës informatikë. Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese. *Pra ky aktivitet ekonomik, regjistrimi kontabël bruto behej në sektorin e administrimit (financë) të brendshëm dhe dokumentacioni orgjinal dhe analitik mbahej nga kordinatori financiar, në kundërshtim me ligjin e sipërcituar*.
c.Pjesë e të ardhurave nga ky aktivitet, por jashtë llogarisë të të ardhurave dhe shpenzimeve janë dhe "Depozitat dhe Interesat e depozitave të sekuestruara dhe konfiskuara", të cilat janë të ardhura që kapitalizohen me urdhër të Ministrit të Financave dhe mbas vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Interesat e këtyre depozitave rikapitalizohen në kapitalin themeltar të depozitës dhe janë në administrim të administratorëve përkatës, të cilët i pasqyrojnë në kartela përkatëse për çdo depozitë dhe kuadrojnë si për çdo pasuri me kordinatorin financiar, por pa kaluar nga sektori i financës së institucionit. Pra specialistja e financës disponon të dhëna vetëm për llogarinë likujduese të llogari e cila përdoret për të paguar shpenzimet që duhen për administrimin e pasurive dhe për derdhur të ardhurat e realizuara nga objektet e dhëna me qera, apo nga derdhjet në këtë llogari me urdhër të Ministrit të Financave dhe nuk disponon të dhëna pët interesat e depozitave.
d. Gjithashtu për këtë aktivitet nuk kishte nxjerje të pasqyrave financiare, por vetëm raporte për Komitetin Këshillimor Ndëristitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar për të ardhurat e shpenzimet dhe problematikat e hasura.

Auditimi i dokumentacionit, të inventarizimit në këtë institucion.
a.Urdhëri i titullarit "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK" ka përcaktuar bazë ligjore shumë të prapambetur, kur duhet të ishte cituar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me nr.20, datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
b.Gjatë verifikimit listës së objekteve të inventarizuar dhe të regjistrit të aktiveve të qendrueshme konstatohet se janë kaluar dhe kontabilizuar në aktive të qendrueshme (llogaria 218 inventar ekonomik) edhe një sasi e aktiveve qarkulluese, (pra llogaria 327 "objekte inventari"), për objekte të cilat nuk e kanë as rolin dhe vlerën si active të qendrueshme si: Makina kapse dokumentash copë 5, me cmim 200 lekë; Makina kapse dokumentash të mëdha copë 1, me cmim 2,500 lekë; Kosh plerash copë 5 me cmim 900 lekë; Tabela dyersh copë 6, me

çmim 500 lekë; e kështu me radhë kyce, dryna, shirita,kosha letre, foto presidenti, zgjatuesa dhe usb etj, duke denatyruar vlerën reale të këtyre paisjeve.
c.Nuk është bërë inventarizimi në fund të vitit i llogarive inventariale 311 "Materiale" dhe 327 "Objekte inventari", gjendje në magazine.
d.Në përfundim të invetarizimit, janë përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe antarët e komisionit të inventarizimit, por pa hartuar një raport nga komisioni i inventarizimit lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak të cilësisë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike për titullarin e institucionit dhe materialet që janë për të dalë jashtë përdorimit.
e. Nuk ka dalë urdhër dhe nuk është kryer inventarizimi në fund të vitit i llogarive të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të aseteve dhe magazinës së Administratorëve.

Auditimi i vlersimit të bazës rregullative, konstatohet se Agjencia nuk funksionon nëpërmjet një sistemi të informatizuar në lidhje me pasuritë e mara nën administrim: nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim të procesit**,** mungesa e një sistemi Informatik e bën të pamundur mbikqyrjen e procesve, shton volumin shkresor, ndërkohë që nuk mundëson kryerjen e veprimeve on-line nga ana e administratoreve, ul nivelin e bashkërendimit me institucione të tjera, zeron mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e te dhënave me institucioneve që bashkëpunojmë me Agjencinë si dhe pengon dhëninen në kohë reale të informacioneve të kërkuar nga institucionet vendase dhe të huaja në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.
Gjatë vitit 2016 dhe 8-mujorit të vitit 2017 sipas raportit të aktivitetit 2016 dhe 9-mujorit 2017, në drejtim të AAPSK kanë ardhur 54 vendime gjykatash, nga të cilat 25 gjatë vitit 2016 dhe 29 gjatë pjesës tjetër të periudhës së auditimit, si dhe vetëm 1 Urdhër i Ministrisë së Financave nr.7, datë 20.01.2017, ndërkohë që sipas librit të protokollit, kanë ardhur për administrim përkatësisht 38 dhe 33 vendime gjykate, duke përbërë një diferencë prej 13 vendimesh në vitin 2016 dhe 4 vendimesh në tetëmujorin e vitit 2017, nga vendimet që janë marrë në ekzekutim. Diferenca e konstatuar flet për një rrjedhë veprimi jo të mirë përcaktuar dhe shteruese të mënyrës së administrimit apo zbatimit të vendimeve të gjykatave. Kjo agjenci prej marrjes së vendimeve i përcjell tek administratori I pasurisë, kur është i përcaktuar në vendim, por për to nuk bëhet një rakordim I mëvonshëm, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të tyre, duke rritur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.
-Nga auditimi u konstatua se Agjencia bën një inventarizim elektronik në format lehtësisht të fshishëm, të aksesueshëm, që nuk ruan gjurmë të veprimeve, të pasurive në administrim, të sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara, të pa shoqëruar nga një regjistër të mirëfilltë fizik, përmbledhës, historik të të gjitha llojeve të pasurive, sipas statusit të tyre, të marrjes apo jo në dorëzim.
-Mbajtja e listës së pasurive të marra në administrim, të sekuestruara, konfiskuara apo revokuara bëhet nga secili administrator në bazë të vendimeve gjyqësore, por dhe nga administratori kordinator në formë elektronike, përmbledhëse. Nga verifikimi i këtij regjistrimi konstatohet se nuk mbahet një rrjedhshmëri historike e vendimeve të gjykatave, që nga momenti I lindjes së detyrimit të sekuestrimit deri në tjetërsimin e tij në një formë tjetër, të konfiskimit apo revokimit, duke mos u ndjekur një gjurmë konkrete auditimi, që të cojë në vendimin final të zbatuar nga AAPSK. Në regjistrin elektronik evidentohet vetëm vendimi I fundit në lidhje me pasuritë, duke mos ripërshkruar gjithë veprimtarinë e administratorit, në lidhje me pasuritë, si dhe duke mos shfaqur një raportim të plotë dhe konciz.
-Sipas raportit mujor të administrimit të pasurive, në muajin dhjetor 2016 dhe gusht 2017, grupi I auditimit, duke iu referuar datës së marrjes në dorëzim të pasurive, përmblodhi të dhënat, nga ku rezulton se ka një diferencë midis pasurive të raportuara në raportin e aktivitetit të agjencisë

dhe raportimit mujor të administratorëve të pasurive, për pasuritë që ata administrojnë, që konfirmon problematikën në këtë mënyrë regjistrimi. Kështu u konstatua një diferencë në numrin e pasurive të administruara, prej 15 pasurish për vitin 2016 dhe 39 pasurish në tetëmujorin e vitit 2017. Diferencat e këtij lloji dhe mbartja e tyre në muaj, flasin për një mosrakordim të vazhdueshëm midis administratorëve, si dhe mosmbajtje të të njëjtit konvencion regjistrimi, pasi koordinatorët inventarin e pasurive e ndërtojnë në bazë të vendimeve të fundit dhe pasurive të marra në administrim, duke bërë një fshirje të ruajtjeve të mëparshme të pasurive për të cilat ka dalë vendimi I revokimit, si dhe të mos përfshirjes në të të pasurive të pamarra ndonjëherë në administrim. Megjithatë përsëri për këto pasuri të pa marra në administrim nuk ka një regjistër, megjithë përpjekjet e mundshme, të vazhdueshme të administratorëve të pasurive, në drejtim të zbatimit të vendimit.

-Nga AAPSK nuk është bërë një inventarizim I pajisjeve/ makinerive të sekuestruara/ konfiskuara të ndodhura në magazinat e saj, duke rritur riskun e humbjes/ tjetërsimit gjatë procesit të administrimit të tyre në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar… pjesa III,26.."*Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar*", 28… "*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi dhe ato nën administrim në formën e pjesëmarrjeve në kapital*".

-Gjatë auditimit u konstatua se AAPSK ka 9 pasuri të pamarra në administrim, të cilat mund të evidentohen vetëm në dosjet e pasurive, pa një raportim të veçantë moszbatimi. Për këto pasuri nuk ka një regjistër listues të numrit dhe problematikave që kanë sjellë në mosekzekutim të vendimit të gjykatës, duke shfaqur një risk në moszbatim të vendimeve të sekustrimit/ konfiskimit dhe revokimit. Si dhe, AAPSK ka në administrim 27 pasuri të revokuara, por të padorëzuara, nga të cilat 22 janë llogari bankare të shtetasve, që pas revokimit nuk ka informacion të destinacionit, për të cilat AAPSK ka detyrim ligjor për njoftim dhe dorëzim dhe 5 pasuri të paluajtshme. Ndër pasuritë e paluajtshme të revokuara, por të padorëzuara në vitin 2017, një pasuri "magazinë'është në përdorim të AAPSK, një "magazinë"në përdorim të Nj.M.L.F dhe nuk janë dorëzuar pasi nuk është gjetur zgjidhja për të zhvendosur makineritë dhe pajisjet që në dy ambjentet ndodhen brenda, ndërsa 3 pasuritë e tjera të paluajtshme, që I përkasin "Ringjalljes së trashëgimisë islame" në administrim të administrators E.Preça, nuk janë dorëzuar për faktin se subjekti që I ka në pronësi, nuk I ka marrë në dorëzim pas vendimit të revokimit. Këto 3 pasuri janë dhënë me qera prej AAPSK, pra janë ende në administrim të saj.

-*Nga auditimi u konstatua se ekziston një vonesë në ekzekutimin e vendimit dhe njoftimin që këto hallka kanë kundrejt AAPSK,* në kundërshtim me VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit", Kreu I,pika2…. "*Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve",* si dhe… "*Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, brenda afateve të parashikuara.".* Kështu nga auditimi I zbatimit të afateve të marrjes në dorëzim të pasurive kundrejt datës së vendimit, rezultoi se, ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kështu nga 82 pasuri të paluajtshme në administrim të AAPSK në vitin 2016, u morën në shqyrtim 64 pasuri, pra rreth 78% të tyre, nga të cilat rezultoi se 36 pasuri, apo 56% të rasteve kishin vonesë në marrjen në dorëzim nga 1-9 muaj, 9 pasuri, apo 14% e rasteve kishin vonesë nga 1-7 vjet, 16 pasuri, apo 25% e tyre kishin vonesa nga 16-30 ditë dhe vetëm 3 raste ose **5% të pasurive të paluajtshme** për sekuestrim, vendimi ishte

ekzekutuar brenda afateve ligjore. Ndërkohë që lista e shoqërive tregtare/ Bizneseve për administrim sipas vendimeve të gjykatave përbëhet nga 11 biznese, vetëm 3 shoqëri janë marrë në administrim, 2 prej të cilave pa aktivitet, duke rezultuar se AAPSK administron vetëm 1 shoqëri në aktivitet. Për 45 llogaritë bankare të marra në administrim u konstatua se **64% e llogarive bankare janë marrë në ekzekutim brenda afateve** ligjore. Në 15 makineri/ pajisje në administrim të AAPSK, nga të cilat u verifikua data e marrjes në dorëzim e 9 pasurive, rezultoi se 5 automjete janë marrë në administrim në periudhën nga 1-5 vjet dhe 4 prej tyre në një periudhë që ka zgjatur nga 2-4 muaj, duke treguar problematikën në të cilën ndeshet AAPSK për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave në lidhje me mjetet motorike,

-Duke mos marrë parasysh pasuritë e marra në dorëzim pas 31.08.2017, sipas inventarit të saj, rezulton se AAPSK ka pasur në administrim gjithsej nga 82 pasuri të paluajtshme në vitin 2016, në 78 pasuri të paluajtshme në 8-mujorin e vitit 2017, ndër të cilat 57 dhe 46 përkatësisht janë *tokë are*, ose *70 % dhe 60% e pasurive në administrim. AAPSK megjithëse i ka në administrim tokat arë, pyje, ullishte, ajo nuk siguron të ardhura prej tyre*, por u shpërndan shpenzime të administrimit, pra AAPSK në këto kushte, mund të krijonte të ardhura potencialisht prej 30% dhe 40% e pasurive të paluajtshme apartamente, zyra, magazine, garazhe, restorante, njësi biznesi, etj në administrim.
-Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2016 nga AAPSK janë dhënë me qira 10 objekte dhe janë përfituar prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën total 1,304,455 lekë, ndërsa për periudhën 01.01.2017 deri më 30.08.2017 janë dhënë me qira 22 objekte dhe janë përfituar prej tyre të ardhura në vlerën total 5,069,470 lekë. Komisionet e ngritura për vlerësimin e çmimit për dhënien me qira të objekte, kanë propozuar çmime shumë të ulta në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues të qirave të ndërtesave për qëllime tatimor".
Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirave rezultoi se përgjithësisht pagesat e qirasë janë kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, të Kontratave të Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

OPINIONI I AUDITIMIT:

Konluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë financiare (ISSAI 4100). *Nga auditimi i përputhshmërinë , për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve dhe politikave, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e dhënies me qera të pasurive që lidhen me mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerës së pasurisë që jepet me qera, procedura jo të sakta gjatë veprimtarisë së administrimit të pasurive, që lidhen me, mangësi në procedurat e ndjekura për administrimin ,inventarizimin dhe rregjistrimin e tyre. Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, i mbështetur në standardet Intosai dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin AAPSK, rezultuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të pakualifikuar të përputhshmërisë.*[1]

[1] ***Opinioni i pakualifuar***. - *Jepet në rastet kur në opinionin e audituesit veprimtaria e subjektit përputhet në çdo aspekt material me kriteret e vlerësimit, sa i takon zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari.*

Në Opinionin tonë, AASPK përveç mangësive të identifikuara më sipër dhe të trajtuara në Raportin e Auditimit (të cilat nuk janë materiale dhe jo të përhapura), menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-[*së*] *nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion i cili të jetë efektiv për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit.*

HYRJA:

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 999/1 prot, datë 06.10.2017, u krye auditim "Auditim i Përputhshmërisë", nga grupi i auditimit me përbërje:

1-M.Ll.
2-N.Ll.
3-I.I.
4-H.S.

Auditimi u krye i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit ushtron veprimtarinë AAPSK .

Qëllimi i auditimit:
Qëllimi i auditimit është vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga AAPSK gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike si dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim dhëniën e një sigurie objektive kësaj Agjencie gjatë veprimtarisë së saj.

Objektivat e auditimit:
Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga AAPSK gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi janë:
-*Opinion në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator për periudhën objekt i auditimit, sipas kritereve të vlerësimit.*

.

Identifikimi i çështjes: Veprimtaria e Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore ku funksioni ekskluziv i kësaj agjencie, *miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara*. Ky administrim ka *si qëllim shtimin e vlerës së produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nëpërmjet ruajtjes, përdorimit, huapërdorjes dhe tjetërsimit dhe si pasojë nxjerrjen e të ardhurave*.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:
Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Financave dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Financave dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie.Kompetencat e Kryeadministratorit si drejtues dhe përfaqësues i AAPSK-së janë të shumta. Ai është personi që drejton, organizon, përfaqëson, raporton për AAPSK-së,përgjigjet për AAPSK-së dhe raporton sipas dispozitave të ligjit 10192, dt. 03.12.2009 përpara Ministrit të Financave dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër financimit të terrorizmit, kontrollon punën e administratorëve nëpërmjet raportimeve periodike dhe shpjegimeve që ai kërkon,i paraqet gjykatës listën e ekspertëve për administrimin e pasurive, lidh kontratën e punës me administratorin 30 ditë pas emërimit me vendim gjykate dhe me personelin mbështetës, raporton Ministrin e Financave 1 herë në 6 muaj për mbarëvajtjen e institucionit, problematikat, një herë në 3 muaj për kontratat e lidhura, të ardhurat e realizuara, shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përgjigjet për përgatitjen e raporteve teknike-financiare të vlerësimit, të cilat i paraqiten Ministrit të Financave, është përgjegjës për përgatitjen, rezultatet e kontrollit të dokumentacionit për kërkesat e financimit të projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor dhe njëkohësisht ai ndjek zbatimin e këtyre projekteve, është personi përgjegjës që përgatit raportin vjetor të administrimit të pasurisë dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Financave, përfaqëson AAPSK-në në raport me të tretët.
Përveç Kryeadministratorit në përbërje të kësaj agjencie ka edhe specialist të fushave të ndryshme ekonomist jurist dhe administrator të pasurive. Nëpërmjet tyre realizohet funksioni ekskluziv i kësaj agjencie, *miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara të përmendura më sipër*. Ky administrim ka *si qëllim shtimin e vlerës së produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nëpërmjet ruajtjes, përdorimit, huapërdorjes dhe tjetërsimit dhe si pasojë nxjerrjen e të ardhurave*.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin Përputhshmërisë:
Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:
-Të vlerësojë nëse informacioni mbi cështjen në të gjitha aspektet materiale është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në ç'masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar . Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne si auditues t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për përputhshmërinë dhe rregullshëmrinë e veprimeve të ndjekura nga subjekti i audituar ,për faktin nëse pasqyrat financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi.
-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)
-Të vlerësojnë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse.ISSAI 1500,ISA300 .

-Të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiuderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*", Ligji nr. 10192, dt. 3.12.2009* "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", zëvendësoi ligjin e mëparshëm nr. 9284/2004.

Ligji nr.70/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime te ligjit *nr. 10192, dt. 3.12.2009*, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", te ndryshuar. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.113, viti 2017.

Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, *në zbatim të ligjit nr. 9258*, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".

VKM nr. 687, dt. 05.10.2011 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe mënyrë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" në përmirësim të *VKM nr. 314,dt 5.05.2014*" Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërblimit te personave të trete në administrimin e pasurisë"

VKM nr. 632, dt. 23.07.2010 "Për përcaktimin e kritereve te vlerësimit, te mënyrave dhe te procedurave te dhënies ne përdorim e te tjetërsimit te pasurive te konfiskuara, ne zbatim te ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009".

VKM nr. 626, dt. 07.09.2011 "Për disa ndryshime në *VKM-nënr. 563, datë 14.7.2010*, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit".

VKM nr. 469, dt. 3.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore**".**

-Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin", i ndryshuar dhe akte të tjera nënligjore në funksion të tyre.

- Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Fiancave (2010);

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".

Me Urdhrin e brendshëm nr.192, datë 25.01.2011 të Kryeadministratorit është miratuar rregullorja "Për administrimin e dokumentacionit zyrtar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara".

Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, dt. 14.02.2011 është miratuar rregullorja "Për organizimin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara". Në këtë rregullore përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë punonjësve të Agjencisë.
Më 01.06.2011 është miratuar Kodi i Etikës i Agjencisë, në të cilin përcaktohen rregullat e etikës që duhet t'u përmbahen të gjithë punonjësit e AAPSK.
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.11, dt 31.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit".
Në datë 22.12.2016 kanë dalë dy urdhrat e Ministrit të Financave nr.9/1 dhe 9/2 "Për financimin e projekteve dhe mënyrat e përdorimit te fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor.

Standardet e Auditimit:
Auditimi u bazua në:
-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",
-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAI) të IFAC.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit, janë mbështetur në ISSAI 1315:
Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit konkluduan në metodologjinë e aplikuar gjatë planifikimit në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve material që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Agjencina për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Financave dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj, administrimin e pasurive e sekuestruara dhe të konfiskuara pavarësisht llojit të tyre të cilat në tërësi konsistojnë jo vetëm në vlera monetare kesh, automjete, llogari rrjedhëse apo depozituese, kalojnë në 3 faza administrimi: a) marrja në administrim, b) menaxhimi, c) tjetërsim, dhënie në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorje.
Bazuar në ligjin Anti-mafia, pasi vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, i cili është titull ekzekutiv dhe i detyrueshëm për t'u regjistruar, pasuria kalon në favor të shtetit. Në këto kushte shteti bëhet pronar në bazë të ligjit Anti-mafia, i cili është njëkohësisht edhe një mënyrë e fitimit të pronësisë parashikuar nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Pas fitimit të titullit të pronësisë AAPSK-ja bashkëpunon me autoritetet dhe agjencitë e tjera përgjegjëse për të bërë ndryshimet përkatëse, transferimet e titujve të pronësisë dhe regjistrimin e këtyre pasurive në emër të shtetit. Marrja në dorëzim fizikisht dhe ligjërisht e pasurive realizohet nga AAPSK-ja pas vendimeve të GJSHPKR-së, për sekuestron apo konfiskimin, të cilat kanë marrë formë të prerë apo pas vendimeve të autoriteteve të tjera sekuestruese.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit

Objekt i këtij auditimi: Është auditimi i përputhshmërisë përgjatë vitit ushtrimor 2016 dhe periudhën 01.01.2017 deri në periudhën 30.09.2017.
Qëllimi i auditimit: Në AAPSK ka qënë vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me liritë dhe kufizimet në sistemin doganor, vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si dhe shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 4100, ISSAI 4000 dhe ISSAI 1315)
-është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.
Fushëveprimi i auditimit : në auditimin e zbatimit të procedurave të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, realizimi faktik dhe i planifikuar i buxhetit si pasqyrat financiare të subjektit për periudhën nën auditim 01.01.2016-30.09.2017.

DREJTIMET DHE ZBATIMI I PROGRAMIT TE AUDITIMIT

1. Drejtimi i I: Në zbatim të pikës nr.1 të Programit të Auditimit nr. 999/1 Prot, datë 06.10.2017, ***"Auditim mbi vlerësimin e bazës rregullative të funksionimit të Agjencisë ,për dhënien e opinionit të auditimit të përputhshmërisë sipas kërkesave ISSAI 4100".***

*Funksionimit të AAPSK-së bazohet në **:**Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar",Ligji nr. 10192, dt. 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", zëvendësoi ligjin e mëparshëm nr. 9284/2004.*
Ligji nr. 70/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime te ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", te ndryshuar. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr.113, viti 2017.
Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
VKM nr. 687, dt. 05.10.2011, "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe mënyrë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" në përmirësim të VKM nr. 314,dt 5.05.2014" Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërblimit te personave të trete në administrimin e pasurisë"
VKM nr. 632, dt. 23.07.2010 "Për përcaktimin e kritereve te vlerësimit, te mënyrave dhe te procedurave te dhënies ne përdorim e te tjetërsimit te pasurive te konfiskuara, ne zbatim te ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009".
VKM nr. 626, dt. 07.09.2011 "Për disa ndryshime në VKM-nënr. 563, datë 14.7.2010, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit".
*VKM nr. 469, dt. 3.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore**"***
Me Urdhrin e brendshëm nr. 192, datë 25.01.2011 të Kryeadministratorit është miratuar rregullorja "Për administrimin e dokumentacionit zyrtar të Agjencisë së Administrimit të

Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara".
Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19, dt. 14.02.2011 është miratuar rregullorja "Për organizimin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara". Në këtë rregullore përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë punonjësve të Agjencisë.
Më 01.06.2011 është miratuar Kodi i Etikës i Agjencisë, në të cilin përcaktohen rregullat e etikës që duhet t'u përmbahen të gjithë punonjësit e AAPSK.
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 11, dt 31.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për financimin e projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit".
Në datë 22.12.2016 kanë dalë dy urdhrat e Ministrit të Financave nr. 9/1 dhe 9/2 "Për financimin e projekteve dhe mënyrat e përdorimit te fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor"

1.1. Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, kompetenca kryesore e kësaj agjencie.

Në aktet ndërkombëtare si Konventa kundër Krimit të Organizuar si dhe në Konventën e KE-së "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit" parashikohet e drejta e shteteve palë për t'i disponuar këto pasuri në përputhje me të drejtën e brendshme si dhe procedurat administrative. Pra sipas këtyre akteve, u lihet një diskrecion shteteve palë të krijojnë agjencitë përkatëse për administrimin e këtyre pasurive, pa përcaktuar një formë konkrete të administrimit por duke pasur parasysh rrethanat konkrete të çdo shteti palë. Përcaktimi i një forme konkrete mund të sillte rezultate joefikase në praktikë apo dështimin e këtyre institucioneve duke pasur parasysh procesin kompleks të administrimit dhe rrethanat konkrete të çdo shteti palë. Shtetet palë duke pasur parasysh praktikat më të mira të konfiskimit dhe të administrimit e kanë më të lehtë të krijojnë institucione përgjegjëse efikase sipas rrethanave të tyre konkrete.
Bazuar në këto parashikime ndërkombëtare si dhe në ligjet e brendshme, Këshilli i Ministrave, miratoi **Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara** sipas akteve nënligjore të përmendura më sipër. Kjo agjenci është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Financave dhe drejtohet nga Kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Financave dhe përgjigjet para tij për mbarëvajtjen e punës së kësaj agjencie.Kompetencat e Kryeadministratorit si drejtues dhe përfaqësues i AAPSK-së janë të shumta. Ai është personi që drejton, organizon, përfaqëson, raporton për AAPSK-së,përgjigjet për AAPSK-së dhe raporton sipas dispozitave të ligjit 10192, dt. 03.12.2009 përpara Ministrit të Financave dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër financimit të terrorizmit, kontrollon punën e administratorëve nëpërmjet raportimeve periodike dhe shpjegimeve që ai kërkon,i paraqet gjykatës listën e ekspertëve për administrimin e pasurive, lidh kontratën e punës me administratorin 30 ditë pas emërimit me vendim gjykate dhe me personelin mbështetës, raporton Ministrin e Financave 1 herë në 6 muaj për mbarëvajtjen e institucionit, problematikat, një herë në 3 muaj për kontratat e lidhura, të ardhurat e realizuara, shpenzimet e kryera për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përgjigjet për përgatitjen e raporteve teknike-financiare të vlerësimit, të cilat i paraqiten Ministrit të Financave, është përgjegjës për përgatitjen, rezultatet e kontrollit të dokumentacionit për kërkesat e financimit të projekteve nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor dhe njëkohësisht ai ndjek zbatimin e këtyre projekteve, është personi përgjegjës që përgatit raportin

vjetor të administrimit të pasurisë dhe ia paraqet për miratim Ministrit të Financave, - përfaqëson AAPSK-në në raport me të tretët.
Përveç Kryeadministratorit në përbërje të kësaj agjencie ka edhe specialist të fushave të ndryshme ekonomist dhe jurist si dhe administratorët. Nëpërmjet kësaj structure realizohet funksioni ekskluziv i kësaj agjencie, miradministrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Ky administrim ka si qëllim shtimin e vlerës së produkteve të sekuestruara dhe të konfiskuara nëpërmjet ruajtjes, përdorimit, huapërdorjes dhe tjetërsimit dhe si pasojë nxjerrjen e të ardhurave. Administrimi i këtyre pasurive realizohet nga administratorët e emëruar me vendim gjykate, në bazë të listës që paraqet Kryeadministratori.
Administratorët nuk autorizohen as të marrin pjesë në gjykim, apo të marrin kredi, të nënshkruajnë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi apo tjetërsimi të pasurisë së sekuestruar apo të kryejë veprime juridike që i përkasin administrimit jo të zakonshëm.
Në ligj, parashikohet vetëm administrimi i pasurive të sekuestruara ndërkohë që pasuritë e konfiskuara, të luajtshme dhe të paluajtshme administrohen nga Ministri i Financave i cili vendos për mënyrën e përdorimit të tij.
Në VKM nr. 968, dt. 02.07.2008 përcaktohet se administratori merr ne dorëzim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim gjykate të cilat administrohen nga administratori. Në kreun IV të kësaj VKM-je përcaktohet se: "administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara përfshin, por pa u kufizuar në to, ruajtjen dhe përdorimin e këtyre pasurive për nxjerrjen e të ardhurave. Procedurat e mbledhjes dhe të administrimit të ardhurave përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Financave.
Ligji parashikon si kompetencë për administratorin, atë të administrimit të pasurive të sekuestruara.
Brenda 15 ditëve nga emërimi i tij administratori duhet t'i paraqesë gjykatës një raport të hollësishëm për elementët thelbësorë të ekzistencës dhe gjendjes në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar. Në vijim ai i paraqet raporte periodike gjykatës për administrimin e pasurisë. Në rast paaftësie ose mos përmbushje të detyrës, bëhet menjëherë shkarkimi i tij nga gjykata kryesisht, me kërkesë të prokurorit apo me propozim të motivuar të AAPSK-së.
Për sa i përket pasurive të konfiskuara më vendim gjykate, ato kalojnë në pronësi të kësaj agjencie vetëm pasi vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

1.2.Administrimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Në llojin e pasurive që AAPSK-ja administron përfshihen pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të tilla si: apartamente, sipërfaqe të mëdha trualli, tokë bujqësore, pyll, kullotë, livadhe apo deri laguna pasi ky është një mjet i mirë jo vetëm për të pastruar paratë por edhe për të zhvilluar më tej veprimtarinë kriminale. Por përveç pasurive të paluajtshme, këta persona posedojnë edhe pasuri të luajtshme si llogari bankare me shuma të konsiderueshme, automjete, apo sende të tjera. legjislacioni ynë për mënyrën e administrimit të këtyre lloj regjimesh pasurie, pra ato të luajtshme dhe ato të paluajtshme parashikon:
Në ligjin kundër KO-së, janë parashikuar si mënyra administrimi të pasurive të paluajtshme:
a) shitjen e pasurive të paluajtshme për dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar,
b) kalimin e këtyre pasurive në administrim të organeve të drejtësisë, të rendit publik dhe mbrojtjes civile,
c) kalimin në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, ku gjendet pasuria e paluajtshme.
Ndërsa veprimtaritë tregtare dhe pasuritë e paluajtshme të konfiskuara që janë të vendosura në veprimtarinë e personave juridikë përdoren në këtë mënyrë:

a) u jepen në përdorim me qira dhe në forma të tjera të përdorimit me shpërblim personave juridikë publikë ose private,
b) u jepen në përdorim me qira dhe në forma të tjera të përdorimit me shpërblim bashkësisë së punonjëseve të personit juridik, veprimtaria e të cilit është konfiskuar pa kushte të caktuara për përfituesin,
c) likuidimin e këtyre pasurive, kur një zgjidhje e tillë ka më shumë interes publik për dëmshpërblimin e viktimave të KO-së.
Ligji dhe aktet nënligjore ndalojnë dhënien në përdorim të personave të cilët janë të dyshuar se kanë lidhje gjaku, gjinore apo janë persona të afërm me atë që i është sekuestruar apo konfiskuar pasuria.
Mbi mënyrën e përdorimit të këtyre pasurive vendos Ministri i Financave, pas raportit të vlerësimit dhe mënyrave të përdorimit të përcaktuara nga AAPSK-ja.
Në ligjin aktual atë Anti-mafia, kemi 2 organe kompetente që merren me mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme, Këshillin e Ministrave si organ kolegjial dhe Ministrin e Financave si organ monokratik, ndryshe nga ligji kundër KO-së në të cilin parashikohej kompetenca, vetëm e Ministrit të Financave. Këshilli i Ministrave, ka kompetenca administrimi vetëm mbi pasuritë e paluajtshme dhe të atyre që shërbejnë për veprimtari ekonomike, tregtare dhe profesionale, i cili vendos mbi përdorimin e këtyre pasurive, pas propozimit të Ministrit të Financave.

1.3. Mënyra e administrimit të pasurive të luajtshme.

Këto pasuri të cilat në tërësi konsistojnë jo vetëm në vlera monetare cesh, automjete, llogari rrjedhëse apo depozituese, si në ligjin kundër KO-së dhe Anti-mafia administrohen në të njëjtën mënyrë. Të dy ligjet parashikojnë, administrimin, përdorimin dhe shitjen e këtyre pasurive, duke pasur parasysh llojin e pasurive të luajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara. Në ligjin kundër KO-së, mënyra e përdorimit të këtyre pasurive vendoset nga Ministri i Financave, në bazë të raportit të vlerësimit teknik-financiar të AAPSK-së, si dhe të mundësive të përdorimit të tyre po nga kjo agjenci.
Në ligjin aktual Anti-mafia dhe aktet e tjera nënligjore parashikohet e drejta e Ministrit të Financave për të vendosur mbi mënyrën e administrimit të pasurive të luajtshme, por me ndryshimin që të ketë marrë më parë rekomandimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër KO-së dhe raportin e vlerësimit tekniko-financiar të AAPSK-së.
Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kalon në 3 faza, duke sjellë kështu një vijueshmëri dhe transparencë në administrimin dhe përdorimin e pasurive.
a) marrja në administrim,
b) menaxhimi,
c) tjetërsim, dhënie në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorje.
Marrja në dorëzim kryhet, pasi vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, i cili është titull ekzekutiv dhe i detyrueshëm për t'u regjistruar, pasuria kalon në favor të shtetit. Në këto kushte shteti bëhet pronar në bazë të ligjit Anti-mafia, i cili është njëkohësisht edhe një mënyrë e fitimit të pronësisë parashikuar nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë. Pas fitimit të titullit të pronësisë AAPSK-ja bashkëpunon me autoritetet dhe agjencitë e tjera përgjegjëse për të bërë ndryshimet përkatëse, transferimet e titujve të pronësisë dhe regjistrimin e këtyre pasurive në emër të shtetit. Marrja në dorëzim fizikisht dhe ligjërisht e pasurive realizohet nga AAPSK-ja pas vendimeve të GJSHPKR-së, për sekuestron apo konfiskimin, të cilat kanë marrë formë të prerë apo pas vendimeve të autoriteteve të tjera sekuestruese. Kjo marrje në dorëzim realizohet nga administratori i pasurisë, në prani të administratorit që merret me koordinimet në terren. Ekzekutimi bëhet nga përmbaruesi gjyqësor në bazë të rregullave të parashikuara në K P Civile,

gjithashtu ai bën edhe inventarizimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Pas mbarimit të kësaj procedure, administratori merr në dorëzim pasurinë, njofton Kryeadministratorin dhe autoritetet e tjera kompetente. Këtu mbaron faza e marrjes në administrim dhe fillon menaxhimi.

b) Menaxhimi. Gjatë kësaj faze administratori përgatit një raport fizibiliteti për pasurinë e marrë në administrim dhe ja dorëzon Kryeadministratorit. Ai merr masa për ruajtjen dhe sigurimin e pasurisë nga agjentë apo faktorë të ndryshëm natyrorë, i paraqet për miratim Kryeadministratorit mënyrën e menaxhimit të pasurisë duke pasur parasysh llojin dhe natyrën e pasurisë si edhe shpenzimet e domosdoshme për këtë menaxhim. Në rast të revokimit të vendimeve për sekuestrim dhe konfiskim, agjencia brenda 15 ditëve përpilon proçes-verbalin e dorëzimit duke njoftuar dhe bashkëpunuar edhe me organet apo autoritetet e tjera kompetente.

c) Faza e fundit, ajo e administrimit, shitjes, dhënies në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorje. Këtu del në pah edhe roli aktiv dhe vendimtar që ka kjo agjenci si dhe KKNEMKKO, në lidhje me mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. KKNEMKKO, i rekomandon Ministrit të Financave mënyrat e përdorimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në bazë të raportit tekniko-financiar dhe të nevojave të institucioneve të zbatimit të ligjit.

Disa nga mënyrat e përdorimit të këtyre pasurive janë :

a) shitja. Sipas këtij akti nënligjor, Kryeadministratori ngre një komision vlerësimi për çmimin e shitjes së pasurisë së konfiskuar. Komisioni në vlerësim bazohet në metodat e vlerësimit të tregut, si dhe duke pasur parasysh llojin e pasurisë, të dhënat e saj, gjendjen fizike, vendndodhjen, destinacionin ekonomik etj. Kjo dosje e cila përmban dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me titullin e pronësisë, çmimin e tregut, e përgatitur nga AAPSK-ja përcillet në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Më tej kjo agjenci realizon procedurat e shitjes së pasurive të konfiskuara në ankand publik, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi për realizimin e ankandit, duke bërë publikimin e ankandit, depozitimin e ofertave, shitjen në ankand, kalimin e të drejtës së pronësisë tek ofertuesi me çmimin më të lartë dhe duke realizuar kontratën e shitjes. ***Nga auditimi rezulton se asnjë nga pasuritë nuk rezulton të jetë e shitur, për shkak të mos paraqitjes së ofertave për blerjen e tyre.***

b) dhënia në përdorim. Kjo është një mënyrë administrimi, ku AAPSK-ja nuk humbet titullin e pronësisë por ajo u jep në përdorim ligjor këto prona disa institucioneve të zbatimit të ligjit si:
njësive të qeverisjes vendore,
organizatave jo-fitimprurëse, për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të krimit të organizuar.

Format e përdorimit janë:
1) kalimi në përgjegjësi administrimi, për institucionet qendrore;
2) kalimi në pronësi, për njësitë e qeverisjes vendore;
3) dhënia në huapërdorje, për subjektet e tjera përfituese.

Për dhënien më qira apo me huapërdorje Ministri i Financave ka nxjerrë udhëzimin përkatës ku përcakton mënyrën dhe procedurat konkrete për dhënien me qira të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Dhënia me qira konsiderohet si një nga mënyrat kryesore në administrimin e pasurive të paluajtshme. Kjo për faktin se AAPSK-ja nuk humbet titullin e pronësisë dhe garanton të ardhura të vazhdueshme nga miradministrimi, duke ushtruar tagrën e gëzimit. Në dhënien me qira të këtyre pasurive AAPSK-ja, e përfaqësuar nga Kryeadministratori respekton kriteret dhe rregullat të përcaktuara në ligj. Komisioni i ngritur nga Kryeadministratori vendos çmimin duke pasur parasysh çmimet apo kërkesat e tregut. Bazuar në këtë çmim, Kryeadministratori lidh kontratën e qerasë sipas kontratës tip të miratuar nga Ministri i Financave.

Shpenzimet për administrimin e pasurisë.

Shpenzimet e përmuajshme ose të dobishme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar përballohen nga fondet e siguruara nga vetë administratori, në çdo lloj cilësie apo burimi të ligjshëm. Nëse nëpërmjet administrimit të pasurisë nuk përfitohen fonde të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve atëherë ato paguhen nga shteti nëpërmjet AAPSK-së. Në rastet e vendosjes se masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori apo AAPSK-ja, përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre. Nëse fondet e llogarive të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhen pjesërisht apo plotësisht nga buxheti i shtetit, pa të drejtë kompensimi. Gjithashtu të ardhura realizohen nga interesat e depozitave të sekuestruara dhe konfiskuara e që regjistrohen nga sejcili administrator dhe kuadrojnë çdo muaj me kordinatorin financiar të subjektit Shpenzimi për administrimin e pasurive kryhet nëpërmjet llogarisë nr.47378 të AAPSK në llogari e hapur me urdhër të ministrit të Financave, në Veneto Bank ku cdo shpenzim regjistrohet nga Specialistja e financës dhe rakordohet me kordinatorin financiar si dhe cdo administrator pasurie. Çdo shpenzim kryhet bazuar në planin e fizibilitetit që cdo administrator paraqet pranë kryeadministratorit për cdo shpenzim të nevojshëm për cdo pasuri. Për periudhën e auditimit rezultoi se gjendja e kësaj llogarie paraqitet si më poshtë :

GJENDJA E LLOGARISE NR.47378 PER VITIN 2016

Ardhurat-2016		SHPENZIMET	GJENDJA
gjendje-31.12.2015			39,151,670.60
janar	40,000	833,927.00	38,357,743.60
shkurt	40,000	1,273,006.04	37,124,737.56
mars	40,000	859,049.00	36,305,688.56
prill	40,000	1,440,426.20	34,905,262.36
maj	50,000	1,973,955.80	32,981,306.56
qershor	40,000	1,043,124.00	31,978,182.56
korrik	22,000	1,069,257.00	30,930,925.56
gusht	42,000	1,252,714.00	29,720,211.56
shtator	166,255	1,496,687.20	28,389,779.36
tetor	89,000	877,253.00	27,601,526.36
nentor	259,000	2,255,566.70	25,604,959.66
dhjetor	476,200	3,539,789.40	22,541,370.26
TOTALI	**1,304,455**	**17,914,755.34**	**22,541,370.26**

ZËRAT E SHPENZIMIT TË LLOGARISE NR.47378 PER VITIN 2016

Paga :	7,002,935.00
Sig.shoqerore	2,766,911.00
Roje	6,397,682.00
Oshe	411,970.44
Dieta	84,000.00
Karburant	561,125.00
Kancelari	258,800.00
Sig I dom.ZTE	53,432.00
Punime	141,400.00
Transport	122,000.00
Kontabel	114,500.00
Totali :	**17,914,755.44**

Si dhe vihet re për vitin 2016 raporti midis shpenzimeve dhe të ardhurave është shumë i madh, ku peshën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet e administratorëve si dhe zëri shpenzime për ruajtjen e pasurive në administrim.

E njëjta situatë paraqitet dhe për vitin 2017 ku kemi një rritje të fondeve në dispozicion në muajin prill me një shtesë fondi nga Ministri i Financave nga fondet e konfiskuara në shumën 44,999,968 lekë e shoqëruar kjo dhe me rritje shpenzimesh ku peshën më të madhe sërisht e zënë shpenzimi për roje private në shumën 17,675,565 lekë deri në muajin gusht të vitit 2017 sipas marrëveshjes kuadër.

GJENDJA E LLOGARISE NR.47378 PER VITIN 2017

Ardhurat-2017		SHPENZIMET	GJENDJA
gjendje-31.12.2016			**22,541,370.26**
janar	854,200.00	2,596,327.00	20,799,243.26
shkurt	114,200.00	6,960,457.40	13,952,985.86
mars	960,100.00	3,243,681.00	11,669,404.86
prill shtese fondi	44,999,968.20		56,669,373.06
prill	925,670.00	3,475,019.00	54,120,024.06
maj	691,500.00	3,405,268.00	51,406,256.06
qershor	1,073,000.00	3,429,292.00	49,049,964.06
korrik	247,800.00	3,144,090.00	46,153,674.06
gusht	203,000.00	3,175,738.00	43,180,936.06
shtator	281,920.00	2,797,374.00	40,665,482.06
tetor	304,300.00	2,679,114.60	38,290,667.46
nentor	-	-	
dhjetor	-	-	
TOTALI	**50,655,658.20**	**34,906,361.00**	**38,290,667.46**

Përdorimi i pasurive dhe të ardhurave të krijuara nga kjo agjenci

Të ardhurat nga administrimi i pasurive përdoren për të mbuluar shpenzimet e administrimit të pasurive që kjo agjenci ka në administrim. Ndërkohë të ardhurat që krijohen si pasojë e tjetërsimit të pasurive të konfiskuara ndahen në këtë mënyrë:

a)-buxhetin e shtetit,

b)-fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit,

c)-dhe pjesa tjetër shkon në llogarinë e kësaj agjencie për të administruar pasuritë e sekuestruara por edhe ato të konfiskuarat deri në momentin e tjetërsimit , në një llogari të vecantë në një bankë të nivelit të dytë.

Gjykata e Krimeve të Rënda shtoi kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim për shkak të lehtësirave procedurale që solli ligji Anti-mafia, kjo solli rezultate në praktikë, pasi rriti vlerat monetare dhe pasuritë e administruara nga AAPSK-ja.

Reformat ligjore të vet AAPSK-së duke shtuar objektin e veprimtarisë së saj nga një administrim vetëm i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga ligji kundër KO-së, në administrimin së fundmi të të gjithë pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara sipas ligjit Anti-mafia, ligjit kundër terrorizmit, me vendim të KM-së apo si produkte të aktiviteteve kriminale, sollën rritjen e vlerave monetare dhe të pasurisë të administruar nga kjo agjenci. **Duhet të theksojmë se të dhënat e AAPSK-ja mbi administrimin e pasurive, nuk mbahen në një sistem të informatizuar unik ku të kemi të dhëna historike lidhur me procedurat e administrimit, sekustrimet, konfiskimet, revokimet si dhe gjithë shpenzimet që kryhen gjatë administrimit të këtyre pasurive. Nga auditimi konstatohet se mbahen vetëm në tabela exel nga punonjësit e Agjencisë apo dhe administratorët gjë e cila nuk krijon një database qëndrore të gjithë procesit**.

Si konkluzion, nga auditimi konstatohet se reforma ligjore ka ndikuar pozitivisht në miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara duke miratuar një sërë aktesh nënligjore të cilët kanë parashikuar mënyrat e përdorimit të këtyre pasurive duke mundësuar një kuadër ligjor të plotë dhe dhe në përputhje me Konventat ndërkombëtare si dhe në harmonizim me legjislacionin e brendshëm. Por pavarësisht nga panorama ligjore e cila është e plotë, nga statistikat e AAPSK-së rezulton se ka pasuri të cilat nuk janë dhënë në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji. ***Kjo tregon vështirësitë që ka kjo agjenci për të arritur qëllimin kryesor të saj miradministrimin duke shtuar vlerën financiare të këtyre pasurive***, disa nga vështirësitë konsistojnë në :

-Pasaktësi (konfuzion) në vendimet e gjykatave përsa i përket përputhjes ne teren te sipërfaqeve të tokës dhe pozicionimin e objekteve, shumat e sekuestruara apo konfiskuar, të dhënat identifikuese të shoqërive etj .

-Konfiskimi i 27.342 % te dy apartamenteve(vlerësim i pamundur).
-Ekzekutimi i revokimit te llogarive bankare pa prezencën e përmbarimit dhe administratoreve të AAPSK-së, por vetëm me marrjen e vendimit te gjykatës.
-Mosparaqitja ne ekzekutim e topografëve apo e përfaqësuesve të pushtetit lokal ne rastin e mungesës së subjektit të cilit i sekuestrohet apo konfiskohet pasuria.
Pajisja me dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e procedurave nga institucione të ndryshme shtetërore si ZQRPP dhe DSHTR etj.
Agjencia është e ekspozuar më së shumti ndaj riskut të administrimit të pasurive të konfiskuara sipas nenit 36 të Kodit Penal, si produkte të rrjedhura nga vepra penale por me ndryshimin që këto pasuri konfiskohen vetëm pasi kemi një vendim penal të formës së prerë, ku personi të jetë deklaruar fajtore .
Kështu përvec shpenzimeve që mbart vetë proçesi i administrimit, është i lartë dhe risku i kthimit të këtyre pasurive shoqëruar dhe me padi gjyqësore për fitimin e munguar gjatë periudhës së administrimit nga AASPK.
Kjo agjenci mundësitë e saj për të tjetërsuar pronën apo për të mirë administruar këto pasuri i ka të kufizuara, kur nuk ka titullin e pronësisë. Detyrimi u lind autoriteteve të tjera të zbatimit të ligjit që të vendosin konfiskimin mbi pasuri të tilla, ku kryesisht rolin kryesor e luajnë vendimet e gjykatave.

2. Drejtimi i II: Në zbatim të pikës nr. 1 të Programit të Auditimit nr. 999/1 Prot, datë 06.10.2017 "***Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.***
2.1. Verifikimi i ekzekutimit të të gjitha akteve të sekuestrimit dhe konfiskimit, për të gjitha pasuritë fizike dhe monetare dhe ndjekja e procedurave nga AAPSK për të gjitha rastet në proces apo të marra në administrim. Verifikimi i gjendjes kontabël me gjendjen fizike të aseteve fizike dhe financiare.
2.2.Zbatimi i procedurave të ndjekura për administrimin e aseteve të marra në dorzim, dhe mënyra e menaxhimit të tyre nga administratorët.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet auditimi:
- Ligji nr.10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", I ndryshuar
- Ligj nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", I ndryshuar
- VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit"
- VKM nr.632, datë 23.7.2010 "Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara"
- VKM nr.687, datë 5.10.2011 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara"
- Vendim nr.968, datë 2.7.2008 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara".

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara është autoritet përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara të vendosura nga organet e drejtësisë apo me vendime dhe urdhra administrative sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

Agjencia sipas legjislacionit mbi të cilin funksionon, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
1. Merr në dorëzim pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, në zbatim të vendimeve të Gjykatës për Krimet e Rënda, vendimeve të Këshillit të Ministrave, urdhrave të Ministrit të Financave, vendimeve të gjykatave të tjera apo ligjeve të veçanta.
2. Ruan, mirëmban dhe administron pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara.
3. Rrit vlerën e pasurisë në administrim, nëse është e mundur, nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo të të tretëve.

Marrja në dorëzim e pasurisë është momenti I kalimit të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar në *administrim* të Agjencisë, gjë që nënkupton, *të gjitha veprimet dhe procedurat* që kryhen nga administratori I pasurisë ose Agjencia, për *ruajtjen, mirëmbajtjen* dhe kur është e mundur për *shtimin e vlerës* së pasurisë.
Në rregulloren e AAPSK, Neni 17, Pika 2… "*datë e fillimit të procedurës së administrimit është data e marrjes së njoftimit nga gjykata për sekuestrimin e pasurisë nga AAPSK*".
Marrja në administrim I pasurisë nga AAPSK, fillon me marrjen dijeni për aktin e nxjerrë nga autoriteti që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit ndaj pasurisë ose me marrjen dijeni, prej prokurorisë, të kërkesës për sekuestrim/konfiskim, që kjo e fundit i drejton gjykatës, konkretisht për Vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë në lidhje me vendimet e lindura rishtazi, si dhe vendimet e Gjykatave të tjera për vendimet e rigjykuara. Që prej lindjes së detyrimit të ekzekutimit, AAPSK nis mbajtjen e korrespondencës, me Gjykaten që ka lëshuar vendimin dhe Prokurorinë, nga të cilat vihet në dijeni për nisjen e procedurës së administrimit, vazhdimin, apo ndërprerjen e saj, si dhe ndjekjen e procedurave ligjore të administrimit të pasurive.
Gjatë vitit 2016 dhe 8-mujorit të vitit 2017 në drejtim të AAPSK kanë ardhur 54 vendime gjykatash, nga të cilat 25 gjatë vitit 2016 dhe 29 gjatë pjesës tjetër të periudhës së auditimit, si dhe vetëm 1 Urdhër i Ministrisë së Financave nr.7, datë 20.01.2017. Në bazë të Ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", I ndryshuar, Neni 22, Pika 2.. "*Urdhri i Ministrit të Financave i dërgohet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe institucioneve, subjekteve e organeve përgjegjëse, në të cilat janë evidentuar fonde dhe pasuri të tjera, të cilat marrin masa për ekzekutimin e menjëhershëm të këtij urdhri*".

	Viti 2016	**8-mujori 2017**
Vendime gjykate	25	29
Urdhra MF	-	1
VKM	-	-
Ligje, akte të tjera	-	-
Total	**25**	**30**

Vendimet për tu zbatuar nga AAPSK janë vendime sekuestrimi, konfiskimi, zgjatje afatit të sekuestrimit, rishqyrtimi dhe revokimi, si më poshtë:

Viti	**Vendime**	**Sekuestrimi**	**Konfiskimi**	**Revokimi**	**Zgjatje afat sek.**	**Rishqyrtim**
2016	25	6	14	2	3	-
2017	29	6	4	12	5	2

Gjatë vitit 2016 dhe tetëmujorit të vitit 2017, në AAPSK sipas librit të protokollit, kanë ardhur për administrim përkatësisht 38 dhe 33 vendime gjykate, duke përbërë një diferencë nga vendimet që janë marrë në ekzekutim sipas raportit të aktivitetit 2016 dhe 9-mujorit 2017. Diferenca e konstatuar prej 13 vendimesh në vitin 2016 dhe 4 vendimesh në tetëmujorin e vitit 2017 flet për një rrjedhë veprimi jo të mirë përcaktuar dhe shteruese të mënyrës së administrimit dhe zbatimit të vendimeve të gjykatave. Kjo agjenci prej marrjes së vendimeve I përcjell tek administratori I pasurisë, I përcaktuar në vendim, por për to nuk bëhet një rakordim I

mëvonshëm, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të tyre, duke rritur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.

Sipas VKM nr. 687, datë 5.10.2011 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", "*marrja në dorëzim e pasurisë*" përkufizohet si … *veprimet dhe procedurat ligjore të kryera nga Agjencia dhe administratori i pasurisë, për kalimin faktik të pasurive në administrim të Agjencisë me anë <u>të inventarizimit të dokumentuar</u> të pasurisë.* Nga auditimi u konstatua se Agjencia bën një inventarizim elektronik të pasurive në administrim, të sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara, të pa shoqëruar nga një regjistër të mirëfilltë fizik, përmbledhës, historik të të gjitha pasurive të marra në dorëzim.
Nga auditimi u konstatua se ekziston një vonesë në ekzekutimin e vendimit dhe njoftimin që këto hallka kanë kundrejt AAPSK, në kundërshtim me VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit", Kreu I,pika2…. "*Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve",* si dhe… "*Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, <u>brenda</u> <u>afateve</u> të parashikuara.".*

Kështu nga auditimi I zbatimit të afateve të marrjes në dorëzim të pasurive kundrejt datës së vendimit, rezultoi se, ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kështu nga 82 pasuri të paluajtshme në administrim të AAPSK në vitin 2016, u morën në shqyrtim 64 pasuri, pra rreth 78% të tyre, nga të cilat rezultoi se 36 pasuri, apo 56% të rasteve kishin vonesë në marrjen në dorëzim nga 1-9 muaj, 9 pasuri, apo 14% e rasteve kishin vonesë nga 1-7 vjet, 16 pasuri, apo 25% e tyre kishin vonesa nga 16-30 ditë dhe vetëm 3 raste ose **5% të pasurive të paluajtshme** për sekuestrim, vendimi ishte **ekzekutuar brenda afateve ligjore**, sipas tabelës së mëposhtme:

	1-7 vjet	1-9 muaj	16 -30 ditë	≤ 15 ditë
Pasuri të paluajtshme	9	36	16	3
%/ Totalit	14%	56%	25%	5%

Vonesa janë konstatuar dhe brenda ekzekutimit të të njëjtit vendim, midis pasurive të ndryshme në pronësi, për sekuestrim/ konfiskim, për shkak të vendndodhjes së ndryshme midis tyre, si gjatë ekzekutimit të Vendimit të Gj.Sh.P.K.R me nr.13, datë 27.07.2016 ku në 6 pasuri me status sekuestrimi, ka diferencë kohore midis tyre nga 5 në 16 ditë.
Për 45 llogaritë bankare të marra në administrim u konstatua një zbatim I mëposhtëm I afateve të ekzekutimit të vendimeve, ku **64% e llogarive bankare janë marrë në ekzekutim brenda afateve** ligjore:

	1-3 muaj	15-30 ditë	≤15 ditë
Llogari bankare	6	10	29
%/ Totalit	13%	22%	64%

Në 15 makineri/ pajisje në administrim të AAPSK, nga të cilat u verifikua data e marrjes në dorëzim I 9 pasurive, rezultoi se 5 automjete janë marrë në administrim në periudhën nga 1-5 vjet dhe 4 prej tyre në një periudhë që ka zgjatur nga 2-4 muaj, duke treguar problematikën në të cilën ndeshet AAPSK për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave në lidhje me mjetet motorike, si më poshtë:

	1-4 vjet	2-4 muaj
Makineri/ Pajisje	5	4
%/ Totalit	56%	44%

Gjatë marrjes në dorëzim të mjeteve motorike ka pasur problem në lidhje me pajisen me dokumentacionin përkatës të pasurive të luajtshme (mjete motorike) të konfiskuara me vendim gjykate të formës së prerë dhe dhënia në përdorim apo tjetërsimi i tyre, si në ekzekutimin e

Vendimit të Gj.Sh.P.K.R nr. 13 të datës 02.11.2012 në lidhje me konfiskimin e automjetit tip BMV X5 me targa ……, ku megjithë marrjen e tij në magazinat e AAPSK jo në gjendje pune, mungonin dokumentacioni, targat etj. Duke qenë se kjo është një problematikë që përfshin dhe haset dhe nga MPB dhe Prokuroria, në bazë të urdhrit të Ministrit të Financave është ngritur grupi i punës nr. 5 dt. 13.01.2016 me përbërjen e specialisteve të Prokurorisë, MPB, Gjykatës, MPPT dhe AAPSK-së për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por që sipas AAPSK nuk ka funksionuar.

Sipas AAPSK gjatë punës së administrimit të pasurive të vendosur nga gjykatat janë hasur me vështirësi, nga pasaktësitë apo ngatërresat në vendimet e gjykatave përsa i përket përputhjes në terren të sipërfaqeve të tokës, objekteve, shumat e sekuestruara apo të konfiskuara, të dhënat identifikuese të shoqërive. Më konkretisht:

- Për vendimin nr. 18 datë 5.08.2015 të Gjykatës së Shkalles së Parë për Krimet e Rënda, përsa i përket numrit të pasurive me nr 179/35 dhe 195/132 të pamundur për tu ekzekututar, është bërë ndreqja e pasaktësive në vendimin nr. 2, datë 8.02.2016 në ndryshimin e NIPT nga ....., në ....., .

Në Vendimin e Gjykatës nr. 37,datë 31.05.2011, trualli me sipërfaqe 500 m^2, në Durrës figuron brenda truallit ndërkohë që në bazë të topografit të marrë nga zyra e përmbarimit, ndodhet jashtë saj dhe ka hyrë në proces legalizimi.

- Mospërputhja e sipërfaqeve sipas vendimit të gjykatës dhe asaj sipas hartave kadastrale të subjektit nën sekuestrim si në **Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nr. 17, datë 30.12.2010, për sekuestrimin e pasurive të shtetasit S.G.** Zyra Përmbarimore Fier ka vendosur dhe ka njoftuar AAPSK për "*Pezullimin e Urdhërit të Ekzekutimit*" me anë të shkresës nr. 683 Prot, datë 17.06.2011, protokolluar me nr. 912 Prot, datë 22.06.2011. Arsyeja e pezullimit të Urdhërit është, "*...pasi ky shtetas nuk ka pasuri të sekuestrueshme nga ligji...*" bazuar në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, ndryshuar. Për mos ekzekutimin e këtij vendimi janë informuar Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Lidhur me kete kallzim nga prokurori eshte filluar procedimi penal nr 113, date 28.02.2011.
- Mbi problematikën e pasurisë "Tokë arë nr. 193/8, në ZK. 3866 (Yzberisht, Tiranë). Mbi të ishte ndërtuar Impianti i Pastrimit të Ujërave të Zeza, i cili zinte 915 m2 sipërfaqe nga 2400 m2 që toka kishte në total. MTI në shkresën nr.49/1 dt.17.01.2017dhe Drejtoria e Ujësjellës Kanalizimeve ka konfirmuar se kjo pasuri nuk është futur në listat e shpronësimit duke u konsideruar si pasuri shtetërore dhe sipas ligjit 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet"pasuritë shtetërore nuk shpronësohen. Në këto kushte është e pamundur ndarja e saj dhe kalimi i pjesës se sekuestruar të lirë për shitje. AAPSK aktualisht ka arritur të bejë ndarjen e pasurise, regjistrimin e saj dhe pajisjen me kartelat përkatëse.
- Konfiskimi i 27.342 % te dy apartamenteve në Vlorë, **në zbatim të vendimit nr. 12 datë 26.03.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, e cila ndër të tjera ka vendosur** *konfiskimin e apartamenteve me sip.128.2 m2 dhe 124.6m2, ndodhur në katin e gjashtë dhe të shtatë të objektit ……....., lagja "Pavarësia", Vlorë.* Pasuria është marrë në administrim me proces-verbalin e datës 13.12.2011, por realisht pasuria është problematike, pasi është e pamundur ndarja në terren e kësaj pjese. AAPSK është në pritje të zgjidhjes dhe gjetjes së mënyrës së ekzekutimit nga Zyra Përmbarimore Vlorë.
- Konfiskimi i llogarive bankare të ....., dhe diferenca në shuma prej rreth 259,152.47 USD midis vendimit të gjykatës dhe shumës reale të konfiskuar, të marrë në dorëzim nga përmbarimi. **P**se nuk janë marrë në dorëzim vlerat monetare të cituara në vendimin nr. 3 date 10.03.2014. Është kërkuar vazhdimisht informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nga Prokuroria pranë kësaj gjykate, si dhe nga Zyra e Përmbarimit Tirane, për të marrë informacion se çfarë është bërë me këto llogari.

• Nga raporti vjetor i aktivitetit të Agjencisë, si dhe nga tabelat e inventarit, grupi i auditimit përmblodhi të dhënat e mëposhtme për pasuritë, nga ku, të marra në administrim në vitin 2016 janë 44 pasuri të paluajtshme, 5 biznese dhe 29 llogari bankare, ndërsa në total të administrimit të saj ka dhe pasuritë e mbartura nga vitet e mëparshme, gjithsej 85 pasuri, duke rezultuar në fund të vitit 2016 si administruese e 163 pasurive të sekuestruara/ konfiskuara me vlerë të përafërt 1,663 milionë lekë:

•	Mbartur nga vitet e kaluara	Lindur 2016	Total 2016
Pasuri të paluajtshme	38	44	82
Shoqëri tregtare	9	5	14
Llogari bankare	25	29	54
Makineri/ Pajisje	13	-	13
Total	**85**	**78**	**163**

Të ndara sipas statusit të konfiskimit dhe sekuestrimit:

Viti 2016	Sekuestruar	Konfiskuar	Total 2016	Vlera(mln lekë)	Pa vlerësuar
Pasuri të paluajtshme	66	16	82	552	55
Shoqëri tregtare	11	3	14	-	14
Llogari bankare	30	24	54	1,111	-
Makineri/ Pajisje	-	13	13	-	13
Total	**107**	**58**	**163**	**1,663**	**82**

Në 82 pasuri të paluajtshme në administrim të AAPSK gjatë vitit 2016, 66 ishin nën statusin e sekuestrimit dhe 16 ishin nën statusin e konfiskimit. AAPSK bën një vlerësim të vlerës së përafërt të tregut për pasuritë që administron, për qëllime statistikore, e cila bazohet në metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë të cmimit të tregut. Për këtë vit nuk rezulton një raportim I vlerë e parafërt e tregut në lidhje më pasuritë e paluajtshme, pasi ato ishin në proces vlerësimi.

Gjatë 8- mujorit të vitit 2017 AAPSK ka pasur në administrim 78 pasuri të paluajtshme me vlerë të përafërt 1,875 milionë lekë, ku 45 ishin nën statusin sekuestrim, 28 në konfiskim dhe 5 pasuri të revokuara, por të padorëzuara. Për vitin 2017 janë marrë ne sekuestrim 15 pasuri të paluajtshme me një vlere të përafërt të tregut rreth 85 milionë leke dhe 9 llogari bankare me një vlerë prej 155 milionë lekë, 4 prej të cilave janë llogari bankare sekuestruar, me Urdhër të Ministrit të Financave nr.7,dt 20.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit; janë revokuar 5 pasuri të paluajtshme me vlerë 49 milion lekë, por të padorëzuara, si dhe me vendimet e gjykatës nr. 48 datë 29.3.2017, nr. 52, date 05.04.2017, nr.10, date 10.03.2017 dhe nr. 06, datë 02.03.2017, u revokuan gjithsejt 19 pasuri të paluajtshme dhe 6 llogari bankare me vlerë 328 milionë lekë. Pasuritë e revokuara të sipërcituara, janë kthyer tek pronarët legjitim me procesverbal dorëzimi në prani të përfaqësuesit të Zyrave Përmbarimore, sipas kërkesave të parashikuara në aktet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Viti 2017	Sekuestruar	Konfiskuar	Revokuara	Total 8-mujori 2017	Vlera(mln lekë)	Pa vlerësuar
Pasuri të paluajtshme	45	28	5	78	1,441	-
Shoqëri tregtare	11	-		11	-	11
Llogari bankare	34	11		45	434	-
Makineri/Pajisje	2	13		15	5.5	2
Total 2017	**102**	**52**	**5**	**159**	**1875.5**	**13**

Në tetëmujorin e vitit 2017 AAPSK ka pasur në administrim 159 pasuri, pra 4 pasuri më pak së në vitin 2016, me vlerë të përafërt tregu 1,875.5 milionë lekë. Për vitin 2017 vlera e pasurive të paluajtshme në administrim të Agjencisë sipas vlerësimit të përafërt, me qëllim statistikor, rezulton të jetë 1,441 milionë lekë, në vitin 2017 kishte një diferencë në vlerën e përafërt të pasurive në administrim me pasuritë e sekuestruara, konfiskuara, revokuara prej 2,400,000 lekësh. Ndër pasuritë e revokuara, por të padorëzuara në vitin 2017, një pasuri është në përdorim të AAPSK, një në përdorim të Nj.M.L.F dhe nuk janë dorëzuar pasi nuk është gjetur

zgjidhja për të zhvendosur makineritë dhe pajisjet që në dy ambjentet ndodhen brenda, ndërsa 3 pasuritë e tjera të paluajtshme, që I përkasin "Ringjalljes së trashëgimisë islame" në administrim të administrators E.P., nuk janë dorëzuar për faktin se subjekti që I ka në pronësi, nuk I ka marrë në dorëzim pas vendimit të revokimit. Këto pasuri janë dhënë me qera prej AAPSK, pra janë ende në administrim të saj.

Lista e shoqërive tregtare/ Bizneseve sipas vendimeve të gjykatave përbëhet nga 11 biznese, nga të cilat 8 nuk janë marrë në administrim, pasi mbi to ekziston një sekuestro preventive, jo vendim i formës së prerë, ndërsa 3 shoqëri janë marrë në administrim, 2 prej të cilave pa aktivitet. Pra aktualisht AAPSK administron vetëm 1 shoqëri në aktivitet.

Nr	Biznese	Datë vendimi	Marrja në dorëzim
1	Agon Set	15.06.2015	-
2	Energji	15.06.2015	-
3	Cable Sistem	15.06.2015	-
4	400 KË	15.06.2015	-
5	Fuqi	15.06.2015	-
6	Inv. Të rinovueshme	15.06.2015	-
7	ABA 2011	03.11.2015	23.11.2015
8	International Parking	03.11.2015	23.11.2015
9	Citadela	03.11.2015	23.11.2015
10	Agon Channel	15.06.2015	-
11	Energji	15.06.2015	-

Në shoqëritë tregtare të marra në administrim u audituan shoqëritë e sekuestruara në bazë të Vendimit të Gj.Sh.P.K.R nr. 22 datë 28.12.2015 mbi shoqërinë .....,, e cila kryen aktivitet të transportit urban me linjën Fier-Patos, ku u konstatua marrja në dorëzim, por dhe kërkesë mbyllje aktiviteti si rezultat I pamundësisë së kryerjes së pagesave drejtuar Bashkisë Fier me nr. 16/Prot, datë 01.06.2016, ndërsa shoqëritë "International Parking 2011"shpk dhe ....., shpk, janë marrë në administrim pa aktivitet, ndërsa janë sekuestruar pajisjet dhe makineritë në pronësi të tyre.

Nga AAPSK nuk është bërë një inventarizim i pajisjeve/ makinerive të sekuestruara/ konfiskuara të ndodhura në magazinat e saj, duke rritur riskun e humbjes/ tjetërsimit gjatë procesit të administrimit të tyre. Sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar… pjesa III,26.."*Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar*", 28… "*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi dhe ato nën administrim në formën e pjesëmarrjeve në kapital*".

AAPSK gjatë periudhës së auditimit ka pasur në administrim nga 82 në vitin 2016 në 78 pasuri të paluajtshme në tetëmujorin e vitit 2017 dhe nga 13 në vitin 2016 në 15 pasuri të luajtshme në tetëmujorin e vitit 2017, të cilat megjithëse në numër final mund të qëndrojnë me një diferencë të vogël, realisht nuk janë të njëjtat pasuri, pasi janë efekt I ndryshime, sekuestrimeve të reja dhe revokimeve të vazhdueshme, si rezultat I vendimeve të gjykatave. Duke mos marrë parasysh pasuritë e marra në dorëzim pas 31.08.2017, sipas inventarit të saj, rezulton se AAPSK ka pasur në administrim gjithsej nga 82 pasuri të paluajtshme në vitin 2016, në 78 pasuri të paluajtshme në 8-mujorin e vitit 2017, ndër të cilat 57 dhe 46 përkatësisht janë *tokë are*, ose *70 % dhe 60% e pasurive në administrim. AAPSK megjithëse i ka në administrim tokat arë, pyje, ullishte, ajo nuk siguron të ardhura prej tyre*, por u shpërndan shpenzime të administrimit, pra AAPSK potencialisht mund të krijojë të ardhura prej 30% dhe 40% e pasurive të paluajtshme në administrim.

Nga pasurite jo tokë are, rezulton se Agjensia ka pasur në administrim 15 njësi të mbartura para vitit 2016, që prej vitit 2008 e në vazhdim, nga të cilat 3 njësi janë apartamente, 1 bar restorant,

2 bodrume, 2 magazina, 1 ndërtesë, 2 njësi tokë, 2 njësi biznesi dhe 2 zyra. Në vitin 2016 ka marrë në administrim gjithsej 10 pasuri të paluajtshme, nga të cilat 2 apartamente, 2 bodrume, 2 ndërtesa, 4 njësi tokë. Në vitin 2017 ka marrë në administrim gjithsej 7 pasuri të paluajtshme, nga të cilat, 5 apartamente, 1 bar restorant dhe 1 njësi biznesi, të listuara në këtë tabelë përmbledhëse për fundin e vitit 2016 dhe fundin e periudhës së auditimit:

Pasuri në administrim	Në administrim viti 2016	Në administrim 8-mujori 2017
Pasuri të paluajtshme Total:	**82**	**78**
-Apartament	5	10
-Bar Restorant	1	2
-Bodrum	4	4
-Magazinë	2	2
-Ndërtesë	3	3
-Njësi truall	6	6
-Njësi biznesi	2	3
-Zyrë	2	2
-Tokë arë/ Pyll	57	46
Pasuri të Luajtshme Total:	**13**	**15**
Makineri	12	14
Pajisje	1	1

Përveç pasurive të mësipërme në inventar të AAPSK ndodhen dhe llogari bankare, shoqëri tregtare, pajisje dhe makineri, sipas tabelave të mëposhtme:

Llogari bankare	Viti 2016				
	Në administrim	Të sekuestruara	Të konfiskuara	Të revokuara	Të revokuara/të padorëzuara
Nr	54	30	24	19	22
Vlerë (mln lekë)	1,111	367	744		10

Llogari bankare	Viti 2017						
	Në admin.	Të sekues.	Të konfisk	Të revokuara	Të rev.nga terrorizmi	Të rev./të padorëzuara	Dif vlere
Nr	47	35	12	6	4	22	-
(mln lekë)	436	195	239	328	8	10	2,4

Makineritë dhe pajisjet

Makineri dhe pajisje	Viti 2016	Viti 2017
Nr	13	15
Vlerë (mln lekë)	4,3	5,5

2.2 Zbatimi i procedurave të ndjekura për administrimin e aseteve të marra në dorëzim dhe mënyra e manaxhimit të tyre nga administratorët .

Administratorët caktohen nga gjykata, duke zgjedhur një apo më shumë administrator nga lista e ekspertëve të paraqitur nga AAPSK-ja. Gjatë auditimit u konstatua se në AAPSK punojnë aktualisht 9 administratorë pasurish dhe 6 ndihmës administratorë. Administratorët emërohen nga Kryeadministratori, pas aprovimit të tyre në vendimin e gjykatës për pasurinë përkatëse, si dhe pas listës emërorë të propozuar nga Kryeadministratori, cdo fillim viti, të administratorëve të mundshëm, të trajnuar nga AAPSK, ndërsa ndihmës administratorët caktohen më vonë prej Kryeadministratorit, në varësi të sasisë së pasurive në përbërje të vendimit.

Inventarizimi dhe dorëzimi i pasurive të sekuestruara, sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 I sipërcituar bëhej nga përmbaruesi gjyqësor tek administratori, për pothuajse të gjithë periudhën e auditimit, prej 01.01.2016 deri në prill të vitit 2017, dokumentohej me procesverbal, sipas nenit 524 të Kodit të Procedurës Civile, i cili nënshkruhej nga të pranishmit, ndërsa aktualisht me ndryshimin e këtij ligji bëhet nga policia gjyqësore. Procesverbali hartohet nga policia gjyqësore në aq kopje sa janë të pranishmit në çastin e inventarizimit dhe dorëzimit të pasurive

të sekuestruara. Dorëzimi i pasurisë së sekuestruar tek administratori i pasurisë shoqërohet me dokumentacionin përkatës ligjor, nëse ka, përfshirë dhe librat e llogarisë për shoqëritë tregtare. Për qëllime administrimi, në mungesë të dokumentacionit të lartpërmendur, Agjencia mbledh të dhëna në rrugë zyrtare dhe ia vë në dispozicion ekspertit kontabël, të caktuar prej saj, i cili ia paraqet raportin përkatës kësaj Agjencie. Dokumentacioni I pasurive ndodhej në dosjet përkatëse të secilës pasuri.

Mbajtja e regjistrit të pasurive të marra në administrim, të sekuestruara, konfiskuara apo revokuara bëhet nga secili administrator në bazë të vendimeve gjyqësore, por dhe nga administrator kordinator në formë elektronike, përmbledhëse. Nga verifikimi i këtij regjistrimi konstatohet se nuk mbahet një rrjedhshmëri historike e vendimeve të gjykatave, që nga momenti I lindjes së detyrimit të sekuestrimit deri në tjetërsimin e tij në një formë tjetër, të konfiskimit apo revokimit, duke mos u ndjekur një gjurmë konkrete auditimi, që të cojë në vendimin final të zbatuar nga AAPSK. Në regjistrin elektronik evidentohet vetëm vendimi I fundit në lidhje me pasuritë, duke mos ripërshkruar gjithë veprimtarinë e administratorit, në lidhje me pasuritë, si dhe duke mos shfaqur një raportim të sintetizuar dhe konciz.

Sipas raportit mujor të administrimit të pasurive, në muajin dhjetor 2016 dhe gusht 2017, grupi I auditimit, duke iu referuar datës së marrjes në dorëzim të pasurive, përmblodhi të dhënat e mëposhtme, nga ku rezulton se ka një diferencë midis pasurive të raportuara në raportin e aktivitetitit të agjencisë dhe raportimit mujor të administratorëve të pasurive, për pasuritë që ata administrojnë, që konfirmon problematikën në këtë mënyrë regjistirmi. Diferencat e këtij lloji dhe mbartja e tyre në muaj, flasin për një mosrakordim të vazhdueshëm midis administratorëve, si dhe për shkak të mosmbajtjes të të njëjtit konvencion regjistrimi, pasi nga koordinatorët jemi informuar se inventarin e pasurive ata e ndërtojnë në bazë të vendimeve të fundit dhe pasurive të marra në administrim, duke bërë një fshirje të ruajtjeve të mëparshme të pasurive për të cilat ka dalë vendimi I revokimit, si dhe të mos përfshirjes në të të pasurive të pamarra ndonjëherë në administrim. Megjithatë përsëri këto pasuri të pa marra në administrim nuk ka një regjistër, megjithë përpjekjet e mundshme, të vazhdueshme të administratorëve të pasurive, në drejtim të zbatimit të vendimit:

Nr	Administrator	Pasuri në administrim viti 2016					Total viti 2016
		Pasuri të paluajtshme	Shoqëri tregtare	Llogari bankare	Pajisje	Automjete	
1	F.A	2	-	22	0	0	**24**
2	E.B	11	2	4	1	3	**21**
3	B.B	30	6	15		2	**53**
4	E.O.	8	-	6	0	0	**14**
5	E.P.	3	-	0			**3**
6	B.I.	4	-	20			**24**
7	R.K./E.R.	4	-	0		6	**10**
8	S.M.	17	-	3	0	0	**20**
9	A.B.	2	-	5		2	**9**
	Total	**81**	**8**	**75**	**1**	**13**	**178**

Kështu gjatë këtyre përmbledhje evidentohet një diferencë në numrin e pasurive të administruara, prej 15 pasurish për vitin 2016 dhe 39 pasurish në tetëmujorin e vitit 2017. Këto diferenca sipas AAPSK justifikohen me mënyrat e ndryshme të regjistrimit që mbahen nga admnistratorët e pasurive dhe kordinatorët, që ka qenë e tillë gjatë gjithë periudhës së auditimit, duke evidentuar dhe njëherë mosrakordimin.

Nr	Administrator	Pasuri në administrim viti 2017					Total viti 2017
		Pasuri të paluajtshme	Shoqëri tregtare	Llogari bankare	Pajisje	Automjete	
1	F.A	2	2	22	-	-	**26**
2	E.B	11	-	1	1	3	**16**

3	B.B	21	6	12	-	2	**41**
4	E.O.	17	-	4	-	-	**21**
5	E.P.	10	-	-	-	2	**12**
6	B.I.	4	-	25	-	-	**29**
7	R.K./E.R.	4	-	-	-	7	**11**
8	S.M.	14	-	4	-	-	**18**
9	A.B.	16	-	6	-	2	**24**
	Total	99	8	74	1	16	**198**

Në raportet e AAPSK nuk rezultonin raporte vjetore të pasurive, në kundërshtim me rregulloren "Për organizimin e punës në Agjencinë e administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të konfiskuara", Neni 7, 8, 9 përkatësisht pikat 16,14, 16, sipas të cilave administratori koordinator sipas llojit, financiar, terreni apo juridik… "*harton raporte periodike, mujore, 3-mujore dhe vjetore si dhe raporte të ndryshme për kryeadministratorin në lidhje me cështjet e pasurive të sekuestruara*". Në AAPSK nuk gjenden raporte të tilla përmbledhëse, vjetore, por vetëm raporte të administrimit të pasurive nga administratorët në bazë mujore.

Ndryshime me inventarin e përgjithshëm të Agjencisë:

- Në raportin e administratorit A.B. të muajit dhjetor 2016 dhe gusht 2017 kishte ndryshime për sa i përket pasurive të mbartura nga vitet e mëparshme. Kështu nuk figuronte në vitin 2016 pasuria "Garazh " e shtetasit A.V në Sarandë, e marrë në dorëzim në datën 01.02.2009 dhe që në vitin 2017 kishte statusin e konfiskuar, gjë që sjell pasaktësi në raportim. Në raportet e mësipërme figurojnë dhe pasuritë që i janë caktuar administratorit nga vendimet gjyqësore, por që për arsye të ndryshme nuk janë marrë në administrim. Këto pasuri nuk ndodhen në inventarin përmbledhës të Agjencisë. Fakti më sipër, raportimi i ndryshem i administratorëve nga njëri tjetri si dhe revokimet e bëra në vitet në vazhdim, e bëjnë të vështirë bashkërendimin e të dhënave të pasurive të mbartura, të shtuar apo pakësuar gjatë 2016 si dhe shtesat e pakësimet në vittin 2017, në një tabelë të përbashkët. Si dhe në vlerat e përafërta të tregut për pasuritë në raportin e vitit 2016 të këtij administratori për llogaritë bankare të konfiskuara, është marrë një urdhër të MF për alokimin e vlerave monetare, si rezultat në raportin e fund periudhës së auditimit vlera e përafërt e tregut figuron në ulje. Si dhe mungojnë në raportin përmbledhës vlerat e përafërta të tregut të pasurive me nr. 6/266+2-14; 17/45+1-25, Hotelit ……., ndërkohë që në raportin përmbledhës rezultojnë vlerat e pasurive me nr.7/630-G216, dhe 217, që nuk paraqiten në raportin mujor. Në raportin përmbledhës nuk rezultojnë pasuritë e pa marra në dorëzim, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet për këto pasuri janë shpërndarë nëpër 16 pasuritë e paluajtshme të marra në dorëzim si dhe mbi një llogari bankare. Në raportin e administratorit A.B. të listuar ishin emrat e gjithë pasurive që atij I ishin caktuar nga vendimet e gjykatave apo me urdhër të brendshëm, nga ku rezultonin 24 pasuri, nga të cilat *5 pasuri nuk ishin marrë në dorëzim*: pasuri e paluajtshme me nr. 152/6 e shtetasit R.F. sekuestruar/pezulluar në bazë të vendimit nr. 02, datë 16.01.2014, 2 llogari bankare dhe 2 automjete sekuestruar në bazë të vendimit nr. 07, datë 30.04.2014, në emër të shtetasit I.M dhe *4 pasuri të tjera* në këtë raport rezultojnë të sekuestruara: Hotel "……," I shtetasit G.N. sekuestruar me vendimin nr. 27, datë 05.12.2016, Apartament me nr. 6/266+2-14, pasuria me nr. 965 dhe apartament nr. 17/45+1-25 të shtetasit N J sekuestruar sipas vendimit nr. 22, datë 12.07.2017, por *nuk figurojnë* tek inventari i AAPSK, duke përbërë një diferencë në raportim. Për pasuritë që nuk janë marrë në administrim shpërndahen shpenzimet e pagës së administratorit.
- Në raportin e muajit gusht të administratorit të pasurive E.P nuk figuron vlera e përafërt e tregut e 2 automjeteve të marra në administrim, ndërsa figurojnë në inventarin e përgjithshëm, duke bërë që të ketë një diferencë në vlerat me 1,2 milion lekë.

Gjatë auditimit të raporteve mujore u konstatua se janë pa marrë në administrim 9 pasuritë e mëposhtme, për të cilat AAPSK nuk ka një regjistër apo relacion përmbledhës në lidhje me pamundësitë e ekzekutimeve:

1. Në pasuritë e paluajtshme të vendimit të konfiskimit me nr. 12 të Gj.K.R, datë 26.03.2013 konkretisht apartamente banimi me sipërfaqe 128.6 m^2 dhe 124.6m^2, ndodhur në Vlorë, nuk është kryer ekzekutimi i vendimit pasi nuk rezultojnë në pronësi të shtetasit R.D. për të cilin është dhënë ky vendimi. Nga administratori i pasurisë në raportin mujor të dhjetorit 2016 si dhe në fund të muajit gusht 2017, vazhdon të figurojë një raportim për këtë pasuri, me gjithë faktin e mësipërm, edhe pse vendimi është i vitit 2013 dhe kanë kaluar plot 3 vite dhe AAPSK nuk i ka realisht në administrim këto pasuri.

2. Për pasurinë e luajtshme automjet Daimler Chrysler me targë ……., e blerë nga shtetasi E.G sipas kontratës Nr. 2776 Rep.dhe1504 Kol, datë 05.05.2007, të konfiskuar sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda nr. 11 datë 16.11.2011, AAPSK nuk e ka marrë në administrim, pasi nuk është ekzekutuar vendimi nga Përmbaruesi me arsyen e rezultimit të vjedhur të këtij automjeti, konfirmuar me shkresen nr.912, dt 22.06.2012 nga permbarimi Fier, bashkelidhur së cilës ishte shkresa e prokurorit. I njëjti konstatim rezulton dhe në raportin e muajit gusht 2017 për këtë pasuri, duke lënë atë në listën e pasurive jo në administrim nga AAPSK.

3. Për pasurinë e paluajtshme me nr. 18/24, zona kadastrale nr. 8604, vol. 10, ndodhur në Vlorë me sipërfaqe 2250 $m^{2,}$ sekuestruar në bazë të Vendimit të Gj.Sh.P.K.R nr. 27, datë 11.12.2015 i janë dërguar shkresa Zyrës Përmbarimore Vlorë dhe ZVRRP Vlorë për detyrimin e caktimit të datës së ekzekutimit të vendimit, por ende deri në fund të periudhës së auditimit nuk është marrë përgjigje. Në funksion të administrimit të pasurive administrator duhet të bëjë korrespondencë shkresore të përsëritur ndaj hallkave përkatëse të detyrueshme dhe të nevojshme për ekzekutimin e vendimit. Në dosjen e kësaj pasurie u konstatua se është bërë zyrave të mësipërme, këto nuk kanë qenë të përsëritura, si dhe me ndryshimin ligjor prej muajit prill 2017, zbatimi I këtij vendimi kërkon shoqërimin nga policia gjyqësore, ndërkohë që është konstatuar një përpjekje e tillë gjatë administrimit të pasurisë nga administrator. I njëjti konstatim rezulton dhe në raportin e muajit gusht 2017 për këtë pasuri.

4. Pasuritë e paluajtshme "Magazina Laprakë" nr. 6 me sipërfaqe 212 m^2 dhe nr. 8 me sipërfaqe 464.85 m^2 me adresë rruga "Pandi Dardha", Laprakë, Tiranë megjithë UMF të revokimit me nr. 7 dhe 7.1, datë 01.02.2013 nuk janë dorëzuar ende, për arsyen se në magazinën nr. 6 ndodhen materiale të pasurive të tjera të sekuestruara/konfiskuara të AAPSK dhe magazine nr. 8 është në administrim nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit, e cila nuk është liruar ende nga kjo njësi, megjithë njoftimin e urdhrit të mësipërm. Për magazinën në përdorim nga AAPSK nuk ka një inventar të dokumentuar të pajisjeve, inventarit të imët, makinerive apo automjeteve, por vetëm një inventar nga administratorët mbi marrjen në administrim të pasurive tek të cilat ato kanë bërë pjesë fillimisht. Në kushtet e mosdorëzimit të këtyre ambienteve, për faktin e ekzistencës së shumtë të pajisjeve, materialeve, etj në të, si dhe, mosinventarizimit të mirëfilltë të tyre në një dokument të përbashkët, vjen natyrshëm një kontradiktë në mënyrën e administrimit të tyre nga Agjencia.

5. Shoqëria "……., shpk sekuestruar me UMF nr. 2, datë 03.12.2004 "Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit arab……., …….," nuk është marrë ende në dorëzim nga AAPSK. Nga administratorët e pasurisë në vite janë bërë shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Policise, si shkresa nr. 473, datë 01.09.2009, nr. 623, datë 26.04.2011, jo në data të mëvonshme, por nuk kanë marrë përgjigje për datën e ekzekutimit.

6. Moszbatim I Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 768, datë 05.06.2015 mbi pasuritë e paluatshme dhe të luajtshme të shtetasve L.C., M.R. dhe E.T. për sa ata zotërojnë kuota në shoqëritë "……., shpk, "…….,"shpk, "……., shpk, …….,"shpk deri në

shumën 39,001,863 euro dhe 770,423,159 Lekë. AAPSK nuk e ka vënë në zbatim këtë vendim për shkak se nuk janë përcaktuar saktë kuotat e këtyre personave fizik në shoqëritë më sipër dhe administrator I këtyre pasurive nuk ka kuotat e duhura për të vendosur në këto pasuri. Në lidhje me këto I është bërë shkresë me nr.554, datë 29.09.2015 Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Prokurorisë Tiranë, por nuk është marrë një përgjigje e qartë, shteruese.

7. Nuk rezultojnë të marra në administrim 3 llogari bankare pranë ……., në emër të shtetasve R.R., M.G. dhe R.G. në shumat 310,000 euro, 500 euro dhe 2,000 euro për shkak të endosjes së masës së sekuestros preventive mbi këto llogari dhe nga administrator I kësaj pasurie Znj. B.I, pasi është pritur dalja e një vendimi final të revokimit apo shuarjes së masës së sekuestros preventive të vendosur nga Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Durrës. Këto pasuri kanë qene në administrim të një administratori K.Xh. sipas Vendimit nr. 3, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, por me urdhrin e Brendshëm nr. 470, datë 21.06.2016 është emëruar administratore Znj. B.I. Prej muajit mars 2014 deri në qershor 2016 vendimi gjyqësor nuk është ekzekututar dhe ka vazhduar I tillë deri në fund të periudhës së auditimit. Është bërë shkresa nr. 180/2, datë 24.02.2017 drejtuar Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda për tu informuar në lidhje me pezullimin apo vazhdimin e ekzekutimit të vendimit nr.3, datë 10.03.2014, por nuk është marrë përgjigje.

8. Llogaritë bankare nr. 2014730712 në lekë dhe nr. 2021930701 në euro, në emër të shtetasve H.R. dhe I.M., në shumat 501,500 lekë dhe 11,150 euro, sekuestruar sipas Vendimit nr.07, datë 30.04.2014 nga Gj.Sh.P.K.R, nuk janë marrë në administrim nga AAPSK pasi, sipas korrespondencës që ka pasur midis administratorit të pasurisë Z. A.B dhe bankës ISP, është informuar se llogaria me nr. 2014730712 I përket llogarisë së Degës së Thesarit Tiranë, si rrjedhim fondet janë derdhur në buxhetin e shtetit, ndërsa llogaria me nr. 2021930701 në ISP Bank, rezulton llogari shtetërore e hapur nga Prokuroria e Përgjithshme, ku kjo e fundit, depoziton vlerat monetare të sekuestruara.

9. Automjetet e tipit BMW X6 me targa ……., dhe Renault Clio me targa ……..,, sekuestruar sipas Vendimit nr. 07, datë 30.04.2014 nga Gj.Sh.P.K.R, në emër të shtetasve H.R. dhe I.M, nuk janë marrë në administrim nga administratori, pasi nuk është marrë përgjigje në lidhje më vendosjen e datës së ekzekutimit nga Zyra Përmbarimore Tiranë. I është dërguar me shkresën nr. 759, datë 16.08.2017 Drejtorisë së Policisë në lidhje me këtë ekzekutim. Në dosjen e pasurisë është konstatuar një informim i gjykatës dhe prokurorisë në lidhje me mosekzekutimin e vendimit. Në automjetet në administrim të AAPSK, vetëm 1 rezulton të jetë në gjendje pune.

Në pasuritë e audituara, kur AAPSK i është dashur të ekzekutojë vendime konfiskimi në lidhje me pasuritë, administratorët kanë regjistruar pasuritë e konfiskuara në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Dorëzimi i pasurisë së sekuestruar tek administratori i pasurisë shoqërohet me dokumentacionin përkatës ligjor, nëse ka përfshirë dhe librat e llogarisë për shoqëritë tregtare, të cilat përmbaruesi gjyqësor ia kërkon personit zotërues të pasurisë. Marrja në administrim bëhet nga administratori i pasurisë i caktuar në vendim, në prani të Koordinatorit në terren ose, në mungesë të këtij të fundit, të një administratori/ administratori të pasurisë, të caktuar nga kryeadministratori. *Në dosjet e pasurive u konstatua formulimi i procesverbalit përkatës të marrjes në dorëzim, i firmosur nga* të pranishmit.

Sipas dispozitës ligjore administratori i pasurisë, pas marrjes në dorëzim të pasurive, *dërgon informacion si dhe harton raportin përkatës*, njofton kryeadministratorin dhe autoritetin që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë. Pas marrjes në administrim të pasurisë, administratori e manaxhon atë, si dhe sipas rregullores së agjencisë, Neni 17, Pika 8… "*Brenda 3 ditëve nga data e përfundimit të marrjes në administrim të pasurisë, administrator I pasurisë*

harton raportin përkatës dhe njofton ...dhe prokurorin dhe gjykatësin e çështjes, në lidhje me zbatimin e vendimit të gjykatës". Gjatë procedurave të administrimit të pasurive, administratori i pasurisë, ka raportuar tek Kryeadministratori mbi konstatimin fizik të pasurive sipas vendimeve në ekzekutim, në prani të kordinatorit të terrenit. Ky raport kryesisht është dërguar në formën e një informacioni pas një kontrolli fizik të kryer në objektet përkatëse. Pas këtij informacioni, administratori i pasurisë përgatit një relacion, kur e gjykon të nevojshëm, mbi llogaritjen e shpenzimeve të sigurimit të domosdoshëm të pasurive të paluajtshme duke iu përmbajtur UMF nr.4, datë 30.09.2015 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar".
Në dosjet e pasurive nuk rezultojnë analiza fizibiliteti dhe analiza tekniko-financiare të plota drejtuar për informacion Kryeadministratorit. Për ekzekutimin e vendimit mbahet korrespondencë me Zyrat Përmbarimore, me Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, njoftime gjykate, apo prokurorie mbi ekzekutimin apo jo të vendimeve, si dhe në lidhje me paqartësitë në lidhje me ekzekutimet.
Pasuritë e tundshme/luajtshme transportohen dhe ruhen në mjediset e caktuara nga Agjencia, përveç rasteve kur këto pasuri janë pjesë e veprimtarisë së një biznesi apo kur ato shërbejnë për dhënien e pasurisë me qira. Pasuritë e tundshme/luajtshme në formë të mjeteve monetare, depozitohen në depozita me afat në llogaritë bankare ekzistuese, apo për vlerat e konfiskuara në llogari bankare të caktuar, që pas një studimi të tregut nga administrator mbi interesat e depozitave bankare, vendos kryeadministratori. Administratori i pasurisë i paraqet për miratim kryeadministratorit planveprimin për zbatimin e mënyrës së menaxhimit, në të cilin përfshihen edhe të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara.
Në rast të revokimit të vendimit të sekuestrimit, Agjencia, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit, bën njoftimin e personit që i është sekuestruar pasuria për datën e kthimit dhe përpilon procesverbalin e dorëzimit të pasurisë, duke kryer raportin përfundimtar për mbylljen e dosjes dhe të kartelës përkatëse. Agjencia, gjithashtu, njofton të gjitha institucionet përkatëse për revokimin e pasurisë. Megjithatë në administrim të AAPSK ndodhen ende 22 llogari bankare të revokuara dhe 2 magazina të revokuara, por të padorëzuara, sipas trajtimit të mësipërm.

2.3. Zbatimi i procedurave të dhënies në përdorim të aseteve, dhënia me qera të objekteve si dhe administrimi i vlerave monetare nëpërmjet bankave.

Për vitin 2016 referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga AASPK u konstatua se Llogari bankare të sekuestruara nën administrim në numër në total është 30 me vlerë 367,228,656 lekë si dhe Llogari bankare të Konfiskuara nën administrim ne lekë në numër total 24 me vlerë 744,104,298 lekë.
Gjatë auditimit u konstatua se nga Administratori financiar pregatitej evidenca dhe gjendja e çdo llogarie në banka.
Në zbatim të ligjit nr. 10190, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", Vendimit nr. 687, datë 05.10.2011 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", sipas dokumentacionit të paraqitur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi zbatimin e procedurave të dhënies në përdorim të aseteve dhe dhënies me qira të objekteve, për periudhën 01.01.2016-31.08.2017 rezulton:
Tabela: Objektet e dhëna me qira për periudhën 01.01.2016-31.08.2017 *Në lekë*

Periudha	Nr. i objekteve	Vlera në total
01.01.2016-31.12.2016	10	1,304,455

01.01.2017-31.08.2017	22	5,069,470

Gjatë vitit 2016 nga AAPSK janë dhënë me qira 10 objekte dhe janë përfituar prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën total 1,304,455 lekë. Ndërsa për periudhën 01.01.2017 deri më 30.08.2017 janë dhënë me qira 22 objekte dhe janë përfituar prej tyre të ardhura në vlerën total 5,069,470 lekë.

Nga auditimi i dosjeve rezultoi:

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 22, datë 28.10.2015 ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme nr. 7/248, Zona Kadastrale 8533, vol. 19, faqe 105, truall me sipërfaqe 4500 m^2 në Fier, në pronësi të shtetases M.C.

Kryeadministarori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 478/2, datë 05.05.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nuk ka numër dhe datë. Komisioni ka propozuar që çmimi për truallin me sipërfaqe 4500 m^2, të jetë 15,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2, të VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015"Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave". Për 1m^2 sipërfaqe parkimi të hapur, vlera minimale e qirasë mujore është 30% e vlerës minimale të qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamentit të banimit.

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte: 4500 m^2 * (0.3%*53,100 lekë)* 0.3 = 215,055 lekë/muaj.

2. Ministri i Financave sipas Urdhrit nr. 8, datë 10.03.2005, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë "Zyra O5", në Laprakë, me sipërfaqe 70 m^2, në pronësi të fondacionit "..... ....,". Edhe pse ka dalë masa e revokimit objekti vazhdon të jepet me qira nga AAPSK. Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira rezultoi se:

Sipas kontratave të qirave nr. 355, datë 29.05.2015, nr. 404, datë 31.05.2016, nr. 404, datë 31.05.2016, të lidhur ndërmjet AAPSK dhe qiramarrësit "R.D.", çmimi i qirasë është 1,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatime "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave". Në pikëm 3,a, të VKM-së. 469, datë 03.06.2015 përcaktohet se, për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1m^2 sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, është 2 (dy) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit.

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte: ....., **Laprakë zona 11/3; 70 m^2 * (0.3%*70,000 lekë) *2 = 29,400 lekë/muaj.**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë nr. 335, datë 29.05.2015 rezultoi se nuk është paguar muaji qershor 2015, tetor 2015, nëntor 2015, dhjetor 2015, janar 2016, shkurt 2016, mars 2016, prill 2016 në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë nr. 340/2, datë 31.03.2017 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. Edhe pse nuk janë paguar detyrimet, nga AAPSK jo vetëm që nuk është zgjidhur kontrata si parashikohet në pikën 10.1.1 të kontratës, por është rilidhur kontrata nr. 404, datë 31.05.2016 me të njëjtin qiramarrës. Sipas ekstrakteve të Bankës "V" rezulton së për pagesën e qirasë së Zyrës Z05, kompleksi "....., Laprakë më datën 11.08.2016 janë derdhur

10,000 lekë, më datën 11.09.2016, 20,000 lekë, më datën 07.10.2016, 30,000 lekë, më datën 14.10.2016, 10,000 lekë, më datën 11.11.2016, 130,000 lekë, më datë 28.02.2017, 20,000 lekë dhe më datë 31.03.2017 janë derdhur 10,000 lekë nga z. S.M., i cili ushtron funksionin e administratorit të pasurive pranë AAPSK.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr. 13, datë 27.06.2016, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të llojit dyqan me sipërfaqe 175m^2, të shtetasit M.F.

Procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nuk ka numër dhe datë. Komisioni ka propozuar që çmimi për objektin me sipërfaqe 175 m^2, të jetë 25,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave". Në pikëm 3,a, të Vendimit nr. 469, datë 03.06.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatime përcaktohet se, për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1m^2 sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, është 2 (dy) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit.

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:

Rr. "Kavajës", ish Parku i Autobuzave zona 7/3; 175 m^2 * (0.3%*85,000 lekë) *2 = 89,250 lekë/muaj.

Sipas ekstrakti të Bankës "V" rezulton së për pagesën e qirasë së kontratës nr. 445, datë 28.04.2017, më datën 05.09.2017 është derdhur shuma 50,000 lekë nga z. S.M., i cili ushtron funksionin e administratorit të pasurive pranë AAPSK.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 17, datë 02.08.2017, ka vendosur sekuestrimin e apartamentit me nr. pasurie 1052, datë 27.10.2008 dhe apartamentit me nr. pasurie 1056, datë 27.10.2008, në Shëngjin, të shtetasit Astrit Naumi.

Kryeadministarori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 616, datë 28.06.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nuk ka numër dhe datë. Komisioni ka propozuar që çmimi për apartamentin me sipërfaqe 87.425 m^2, të jetë 8,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2, të VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015"Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave".

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:

87.425m^2 * (0.3%*56,000 lekë) = 14,687 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë ka rezultuar se qiramarrësi ka paguar më datë 20.07.2017 shumën 16,000 lekë (qira mujore + garanci) dhe më datë 31.08.2017 shumën 8,000 lekë, në kundërshtim me pikat 5.3, 5.4, 5.5 të Kontratës së Qirasë nr. 627, datë 30.06.2017 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

5. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 13, datë 27.06.2016, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të llojit dyqan me sipërfaqe 133 m^2, të shtetasit M.F.

Procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nuk ka numër dhe datë. Komisioni ka propozuar që çmimi për objektin me sipërfaqe 133 m^2, të jetë 16,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM-së 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave". Në pikëm 3,a, të Vendimit nr. 469, datë 03.06.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatime përcaktohet se, për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1m^2 sipërfaqe për dyqan mallrash apo shërbimesh, është 2 (dy) herë më e lartë se vlera minimale e qirasë mujore për 1m^2 sipërfaqe të apartamenteve të banimit.

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:

Rr. "Jordan Misja" zona 9/3 = 133m^2 * (0.3%*77,000 lekë) *2 = 61,446 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë deri më datë 31.08.2017, ka rezultuar se qiramarrësi ka paguar më datë 14.04.2017 shumën 16,000 lekë (garanci), më datë 31.03.2017, 15.05.2017,07.06.2017,17.07.2017 shumën 13,600 lekë/muaj, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, 5.6 të Kontratës së Qirasë nr. 340/2, datë 31.03.2017 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

6. Ministri i Financave sipas Urdhrit nr. 8, datë 10.03.2005, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë "Apartament A12", në Laprakë, me sipërfaqe 72 m^2, në pronësi të fondacionit ... .,. Edhe pse ka dalë masa e revokimit objekti vazhdon të jepet me qira nga AAPSK. Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira rezultoi se: Sipas kontratës së qirasë nr. 732/1, datë 14.09.2016, të lidhur ndërmjet AAPSK dhe qiramarrësit "H.S", çmimi i qirasë është 12,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave".

Çmimi i llogaritur sipas VKM- së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:

Kompleksi ....., **Laprakë zona 11/3; 72 m^2 * (0.3%*70,000 lekë) = 15,120 lekë/muaj.** Në kontratën e rilidhur nr. 842, datë 13.09.2017 është aplikuar çmimi 17,500 lekë/muaj, i cili është llogaritur nga komisioni i vlerësimit të tregut dhe caktimit të çmimit të qerasë në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore".

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë rezultoi se pagesat e qerasë ishin kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, të Kontratës së Qirasë nr. 732/1, datë 14.09.2016 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

7. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, sipas vendimit nr. 17, datë 02.08.2016, ka vendosur sekuestrimin e apartamentit me nr. pasurive 1056, datë 27.10.2008, ZK 3126, me sipërfaqe 87.425 m^2, në pronësi të ....., shpk, Shëngjin, Lezhë.

Me kërkesë të administratorit të pasurisë, Kryeadministarori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr.616, datë 28.06.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Procesverbali i mbajtur nga komisioni për vlerësimit e çmimit të tregut nuk ka numër dhe datë. Komisioni ka propozuar që çmimi për objektin me sipërfaqe 87.425 m^2,

të jetë 8,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM nr. 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave".

Çmimi i llogaritur sipas VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:
Shëngjin; 87.425 m^2 * (0.3%*56,000 lekë) = 14,657 lekë/muaj.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë deri më datë 31.08.2017, ka rezultuar se qiramarrësi ka paguar më datë 20.07.2017 shumën 16,000 lekë (garanci) dhe më datë 31.08.2017 shumën 8,000 lekë/muaj, në kundërshtim me pikat 5.3 5.5, 55 të Kontratës së Qirasë nr. 628/2, datë 30.06.2017 ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr. 13, datë 27.06.2016, ka vendosur sekuestrimin e apartamentit me nr. pasuri 5/56+1-64 me sipërfaqe 69.6 m^2 dhe apartamentit me nr. pasurie 5/56+1-64 me sipërfaqe 49.3 m^2, në pronësi të shtetasit M.F., në Shëngjin.

Kryeadministarori ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 1075/1, datë 28.12.2016 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Sipas procesverbalit nr. 102/1, datë 19.01.2017 komisioni ka propozuar që çmimi për objektin me sipërfaqe 69.6 m^2, të jetë 8,000 lekë/muaj dhe çmimi objektin me sipërfaqe 49.3 m^2, të jetë 7,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave". **Çmimi i llogaritur sipas VKM nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:**
Shëngjin; 69.6 m^2 * (0.3%*59,000 lekë) = 12,319 lekë/muaj.
49.3 m^2 * (0.3%*59,000 lekë) = 8,726 lekë/muaj

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qirasë deri më datë 31.08.2017, ka rezultuar se qiramarrësi ka paguar më datat 11.04.2017 shumën 840 lekë, 04.05.2017 shumën 2,250 lekë, 26.05.2017, shumën 9,650, 28.06.2017 shumën 15,000 lekë në kundërshtim me pikat 5.1, 5.3 5.5, 55 të Kontratës së Qirasë nr. 283/3, datë 20.03.2017, ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë.

9. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Tiranë, sipas vendimit nr.. 37, datë 31.07.2011, ka vendosur konfiskimin e pasurisë "Bar Restorant" 130 m^2 së bashku me pasurinë "truall" me sipërfaqe 500 m^2 , me adresë fshati Rinia, Bisht-Pallë, Durrës.

Kryeadministarori pas kërkesës nr. 103, datë 19.01.2017, të administratorit të pasurisë z. E.B., ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 103/3, datë 30.01.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të çmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Sipas procesverbalit komisioni ka propozuar që çmimi për dhënien e objektin me qira të jetë 10,000 lekë/muaj në kundërshtim me pikën 2 dhe 3,a, të VKM-së nr 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", ku citohet se vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira, është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, të përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave".

Çmimi i llogaritur sipas VKM nr. 469, datë 03.06.2015 duhet të ishte:

Bisht Pallë, Durrës; 130 m^2 * (0.3%*67,500 lekë) *1.5 = 39,487 lekë/muaj.

Në dy tabelat e mëposhtme, është llogaritur shuma minimale e çmimit të qirasë për çdo pasuri të dhënë me qira për vitet 2016 dhe 2017, në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore.

Tabela – Objekte të dhëna me qira, viti 2016

Nr	Objekti	Qiramarrësi	Shuma e qirasë në muaj	Shuma e qirasë minimale sipas VKM nr. 469, datë 03.06.2015	Administrator Pasurie
1	Pasuri e paluajtshme me nr. 412/89/ND-N3 me sip. 78.66 m^2, Orikum Vlorë	D.R	10,200	14,158	S.M
2	"Bar Restorant", lagja nr. 15, Durrës	E.S	10,000	39,487	E.B
3	Zyra A13, Laprakë, Kompleksi Karavan	J.B	10,000	24,360	E.P
4	Apartament banimi Laprakë, Kompleksi Karavan	H.S	12,000	15,960	E.P
5	Objekt shërbimi, "Bar-Restorant-Hotel"	K.N	370,000	Mbi çmimin minimal	E.B
6	Ap. Banimi, Lgj "Kongresi i Elbasanit", Pall. Nr. 35, Elbasan, sip 97.67	L.C	20,000	Mbi çmimin minimal	E.B
7	Objekt 3 katësh në fashatin Rreth, Shijak me sip 453 m^2	A.K	12,000	55,719	E.O
8	Zyrë Z.05 Laprakë, Kompleksi Karavan	R.D	10,000	29,400	E.P
9	"Bar-Kafe", Pall. Nr. 35, Elbasan	E.D	35,000	Mbi çmimin minimal	E.B
10	"Bar Restorant", 130 m^2, fshati Rinia Durrës	J.L	10,000	39,487	E.B

Tabela – Objekte të dhëna me qira, viti 2017

Nr	Objekti	Qiramarrësi	Shuma e qirasë në muaj	Shuma e qirasë minimale sipas VKM nr. 469, datë 03.06.2015	Administrator Pasurie
1	Hotel "President", Sarandë	A.A	400,000	Mbi çmimin minimal	A.B
2	Dyqan 133m^2 , Rrg. Jordan Misja	A.A	13,600	61,446	S.M
3	Pasuri e paluajtshme me nr. 412/89/ND-N3 me sip. 78.66 m^2, Orikum Vlorë	D.R	10,200	14,159	S.M
4	Apart. lagja nr. 13, me sip. 78.66 m^2 me nr. 412/89/ND-N3	E.B	10,000	15,187	E.P
5	"Bar Restorant", lagja nr. 15, Durrës	E.S	10,000	39,487	E.B
6	"Bar-Kafe", Pall. Nr. 35, Elbasan	E.D	35,000	Mbi çmimin minimal	E.B
7	Apart 2+1, Elbasan	E.A	10,000	Mbi çmimin minimal	E.O
8	Zyra A13 , Laprakë, Kompleksi Karavan	J.B	10,000	24,360	E.P
9	Apartament banimi Laprakë, Kompleksi Karavan	H.S	12,000,	15,960	E.P
10	Apart me sip 121 m^2 në lagjen 13, Plazh, Durrës	H.M	20,000	24,502	B.I
11	Njësi biznesi me nr. 368/14+1-N3 me sip 61m^2, Yzberisht, Tiranë	I.R.	20,000	Mbi çmimin minimal	E.O
12	Njësi biznesi me nr. 368/14+1-N3 me sip 61m^2, Yzberisht, Tiranë	K.Z.	25,000	98,250	S.M
13	Apart. nr. 2/343+5-27 dhe Aprt nr. 2/343+6-38 në Rr. "Muhamet Gjollesha", Tiranë	E.B.	51,000	Mbi çmimin minimal	E.O
14	Apart me sip 87.425 m^2, Shëngjin, Lezhë	S. A.	8,000	14,687	S.M
15	Objket shërbimi "Bar-Restorant-Hotel"	K.N.	370,000	Mbi çmimin minimal	E.B
16	Apart, Pallati nr.35, Elbasan	L.C	20,000	Mbi çmimin minimal	E.B
17	Objekt 3 katësh, me sip 453 m^2, Rreth, Shijak	A.K	12,000	55,719	E.O
18	Apart. me sip 69.6m^2 me nr. pasurie 5/56+1-64, dhe Aprt. Me sip 49.03 m^2 me nr. pasurie 5/56+1-64, Shëngjin, Lezhë	P.T	15,000	19,972	S.M

19	Apart me sip 35m^2, Plazh, Durrës	A.M	8,000	Mbi çmimin minimal i	E.P
20	Apart me sip 87.425 m^2, Shëngjin, Lezhë	T.P	8,000	14,687	S.M
21	Pikë riparimi-parkimi në Fier	R.S.	15,000	215,055	B.B
22	Zyrë Z.05 Laprakë, Kompleksi Karavan	R.D	10,000	29,400	E.P

Për Projektraportin, janë paraqitur nga APPSK dhe administratorët e pasurive observacionet nr. datë 20.11.2017 protokolluar në KlSh me nr. 999/4, datë 20.11.2017 ku pretendohet se: Për pronat e dhëna me qira zbatimi i përcaktimeve të VKM nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore" nga ana e Komisioneve të ngritura për këtë qellim për vendosjen e çmimit të qerasë, në disa raste ka qenë i pamundur, pasi Komisioni i përcaktimit të çmimit të qiradhënies ngrihet dhe vepron bazuar në Udhëzimin nr. 27, dt. 23.09.2008, të Ministrit të Financave, në të cilin përcaktohet qartë procedura që duhet ndjekur, por edhe kriteret ku bazohet vendosja e çmimit të qirasë. (Kreu III, pika 2.1.1). Gjithashtu këto prona nuk janë në kushte normale në qarkullimin civil, pasi përveç statusit ligjor (të sekuestruara / konfiskuara), kane edhe problematika specifike. Për rrjedhim, çmimi i qirasë nuk mund të përcaktohet "në mënyrë mekanike" duke u mbështetur vetëm në VKM nr. 469, dt. 03.06.2015, për me tepër që kjo e fundit përcakton vlerën referuese vetëm për qëllime tatimore. AAPSK gjejmë të vështirë zbatimin e këtij rekomandimi për të gjitha rastet e qiradhënies, por duke mbajtur parasysh përcaktimet e VKM nr. 469/2015 dhe duke vlerësuar rast pas rasti çdo pronë specifike. Administratorët e pasurive pretendojnë se për paruritë që kanë në administrim, për përcaktimin e çmimit të qirave janë bazuar në VKM nr. 687/2011.
Adminisratori B. pretendon se nuk është dhënë me qira trualli me sipërfaqe 4500 m^2 por vëndriparimi i mjetve i cili ndodhet në këtë truall.
Grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionin dhe dokumentacionin bashkëlidhur arsyeton se pavarësiht vështirësisë dhe problematikave që shoqërojë këto pasuri, Komisionet e vlerësimit duhet të kishin respektuar kërkesat e VKM nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", pasi kjo VKM është për të gjitha pasuritë që jepen me qira dhe nuk ka të parashikuarnë të asnjë rast përjashtimi. Gjithashtu në Udhëzimin nr. 27, datë 23.09.2008 të ministrit të Financave, kreu III, pika 2.1.1 citohet se komisioni bën vlerësimin e tregut duke u bazuar në çmimet zyrtare. Në rastet kur është e pamundur dhënia e objektit e objektit me qira me çmim tregu, kryeadministratori mund të negociojë çmimin e kontratës por pasi të jetë ezauruar procedura me çmim tregu.
Përsa i përket pretendimit të administatorit të pasurisë z. B. nuk ka dokumetacion bashkëlidhur për të vërtetuar pretendimet, pasi edhe Komisioni i vlerësimit të pasurisë nuk ka vlerësuar çmimin e vendriparimit por ka vlerësuar truallin me sipërfaqe 4500m^2.

2.4. Zbatimi i procedurave të tjetërsimit/shitjes së pasurive të konfiskuara me vendim gjykate, përgatitja e dokumentacionit, respektimi i procedurave të vlerësimit dhe verifikimi i arkëtimit të vlerave nga shitja.

Në zbatim të ligjit nr. 10190, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", Vendimit nr. 632, datë 23.07.2010 "Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009", Vendimit nr. 687, datë 05.10.2011 "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", sipas dokumentacionit të paraqitur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi

zbatimin e tjetërsimit/shitjes së pasurive të konfiskuara me vendim gjykate, përgatitja e dokumentacionit, respektimi i procedurave të vlerësimit dhe verifikimi i arkëtimit të vlerave nga shitja., për periudhën 01.01.2016-31.08.2017 rezulton:
Përgjatë periudhës 2016-2017 nuk është shitur asnjë pasuri e konfiskuar, pavarësisht ankandeve të zhvilluara. Gjatë vitit 2016 nga AAPSK janë dërguar në Drejtorinë e Pronës Publike 7 pasuri për shitje së bashku me dokumentacionin përkatës, pasi shitja e pasurive të konfiskuara bëhet në ankand publik nga Ministria e Financave.
Nga auditimi i dosjeve të dërguara për shitje u konstatua se nga AAPSK është vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM nr. 632, datë 23.07.2010 "Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009".
1. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Truall" me sipërfaqe 470 m^2 dhe ndërtesë (magazinë) me sipërfaqe 48 m^2, me nr. pasurie 4/32, zona kadastrale 8571, me vendndodhje lagjja "Çlirim", Lushnjë, rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2017. Sipas shkresës nr. 908, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 12, datë 03.06.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar për vlerën e përgjithshme të pasurisë është 11,850,000 lekë.
2. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Garazh nr. 1" me sipërfaqe 48.5 m^2, me nr. pasurie 8/122+1-1, faqe 14, indeksi nr. 65, kati nëntokë, me vendndodhje, Sarandë rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 912, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 1, datë 15.03.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar është 2,400,000 lekë.
3. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Ullishte" me sipërfaqe 9000 m^2, me nr. pasurie 145/33, vol. 6, faqe 226, zona kadastrale 1574, me vendndodhje Durrës rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 912, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin

nr. 4, datë 17.02.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar është 111,780,000 lekë.

4. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Arë" me sipërfaqe 4000 m^2, me nr. pasurie 154/48, vol. 6, faqe 248, zona kadastrale 1574, me vendndodhje Durrës rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 910, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 4, datë 17.02.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar është 44,800,000 lekë.

5. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Arë" me sipërfaqe 6000 m^2, me nr. pasurie 154/28, vol. 6, faqe 233, zona kadastrale 1574, me vendndodhje Durrës rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 910, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 4, datë 17.02.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar është 74,520,000 lekë.

6. Për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Ullishte" me sipërfaqe 1500 m^2, me nr. pasurie 156/1, vol. 15, faqe 44, zona kadastrale 3385, me vendndodhje Durrës rezulton se është hartuar nga administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 910, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 4, datë 17.02.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar është 26,910,000 lekë.

7. Për shitjen e pasurisë së luajtshme "Mitsubishi-Pajero", ngjyrë gri e errët, viti i prodhimit 1987, me nr. Shasie JMBL0436VFY406528 me targë ..... rezulton se është hartuar nga

administratori i pasurisë raporti i vlerësimit tekniko-financiar. Komisioni për vlerësimin e çmimit të shitjes i përberë nga një përfaqësues i AAPSK, një përfaqësues i Ministrisë së Financave si dhe nga një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pasurisë ka mbajtur procesverbal për gjendjen fizike të pasurisë, ka vlerësuar çmimin e shitjes, i cili është i shoqëruar edhe me Raportin Teknik të hartuar nga grup ekspertësh të jashtëm për vlerësimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Sipas shkresës nr. 914, datë 07.11.2016 dosja e pasurisë e dërguar për shitje përmban Vendimin nr. 10, datë 23.11.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Raportin tekniko-financiar, dokumentin e pronësisë së bashku me lejen e qarkullimit, aktin e vlerësimit të shitjes së pasurisë si dhe procesverbalin mbi gjendjen e pasurisë në përputhje me kërkesat e Kreut III, pika 3 të VKM-së nr. 632, datë 23.07.2010. Çmimi fillestar i propozuar për pasurisë është 115,000 lekë.

III. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe ligjor të fondeve buxhetore të përdorura nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (APSK).

Baza ligjore e përdorur në auditim.

-*Ligjet:* nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.57, datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008"; nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; nr.147/2015, datë 17.12.2015"Për buxhetin e vitit 2016" dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; nr.130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017" dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit, nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit ndërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

-*Vendimet e Këshillit të Ministrave* "Për miratimin e projekt dokumentit të programin buxhetor afat mesëm 2016-2018 dhe 2017-2019"; nr.432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore"; nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze, apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"; nr.870, datë 14.02.2011 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" dhe VKM nr.632, datë 23.07.2010 "Për përcaktimin e kriterevetë vlerësimit, të mënyrave dhe procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr.10192, datë 03.012.2009".

-*Udhëzimet e Ministrisë së Financave:* Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe 2017-2019, si dhe tabelat e tavaneve për këto PBA. "Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit"; për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit; "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit" dhe udhëzimet vjetore të zbatimit të tij; nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"; etj.

Në udhëzimin "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit", pika 38, Nëpunësi Autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, nëndarja "b", citohet *"Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që nuk janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, nëpunës autorizues është punonjësi i nivelit më të lartë menaxhues në vartësi direkte të titullarit. Në njësitë ku nuk ekzistojnë nivele menaxhimi të mesëm apo të lartë, nëpunës autorizues është titullari i njësisë".*

Në pikën 40 të këtij udhëzimi citohet: "Në çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme ndarja e detyrave kryhet duke patur parasysh që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".
Në pikën 62 të këtij udhëzimi citohet: "Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij proçesi".
Në pikën 126 të këtij udhëzimi citohet: "Sistemi i thesarit është tërësia e rregullave, proçedurave, si dhe struktura organizative përkatëse, e ngarkuar për ekzekutimin e buxhetit, administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive dhe raportimin financiar të qeverisjes së përgjithshme".

1. Përputhshmëria ligjore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, pagat dhe shpërblimet, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit për vitin 2016 dhe deri në 31.08.2017.

a.Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe zbatimin e tij.

Viti 2016. Në zbatim të legjislacionit të mësipërm dhe udhëzimit nr.7, datë 28.02.2015 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018", të dërguar nga MoF me shkresën nr.2964/15, datë 14.04.2015, janë dërguar tavanet buxhetore për PBA 2016-2018. Tavanet e vitit 2016 për këtë institucion janë miratuar:
Paga e sigurime (600-601) për 10,000 mijë lekë;
Shpenzime korente (602-606) për 5,000 mijë lekë;
Shpenzime për investime (230-231) për 1,000 mijë lekë.
Programimi në fazën e **I-rë** të PBA 2016-2018 është bërë me shkresën nr.255/1, datë 21.04.2015, pra brenda afatit dhe duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga Ministria e Financës me shkresën nr.2964/15, datë 14.04.2015, për përcjelljen e kërkesave buxhetore, të cilat përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2016-2018, si misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve me artikuj buxhetorë. Planifikimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 16,000 mijë lekë, dhe kërkesat e institucionit janë po në këtë vlerë.
Programimi në fazën e **II-të** të PBA 2016-2018 dhe **projekt buxheti i vitit 2016,** është bërë në mbështetje të VKM nr.696, datë 31.07.2015 "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018", MoF me shkresën "Dërgohen tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2016-2018" ka përcjellë tavanet e shpenzimeve buxhetore për këtë institucion. Programimi në këtë fazë është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën "Dërgohen kërkesat për PBA 2016-2018", si misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve dhe produkteve me artikuj buxhetorë. Programimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 16,000 mijë lekë, ndërsa kërkesa AAPSK është në këtë fazë të programimit, po në këtë vlerë. Struktura buxhetore edhe për këtë fazë të Programit buxhetor Afatmesëm 2016-2018, paraqitet me **një** program dhe është e njëjtë me fazën e parë të programimit.
Zërat e **shpenzimeve buxhetore** për PBA 2016-2018, në të dy fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2016, paraqitet si në tabelën e mëposhtme: *Në mijë lekë*

Art.	Struktura buxhetore	Realizimi i 2015	PBA Faza e parë 2016	PBA Faza e dytë PBuxheti 2016	Aprovimi i projekt buxhetit
600	Paga e Shtesa	6,116	8,330	8,330	8,330
601	Sig. shoqërore e shëndetsore	940	1,670	1,670	1,670
602	Blerje mallra e shërbime	1,892	5,000	5,000	5,000

231	Shpenz. për investimeve	727	1,000	1,000	1,000
	TOTALI	**9,675**	**16,000**	**16,000**	**16,000**

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit është në vlerë 16,000 mijë lekë, nga 9,675 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 6,375 mijë lekë, ose 65% më shumë se realizimi i një viti më parë.

Me artikuj buxhetorë, miratimi i shpenzimeve për vitin 2016, ka rezultuar:

Paga e shtesa (600) për 8,330 mijë lekë;
Sigurime shoqërore (601) për 1,670 mijë lekë;
Blerje mallra e shërbime (602) për 5,000 mijë lekë;
Investim i brendshëm (231) për 1,000 mijë lekë.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2016, në vlerë 16,000 mijë lekë, është bërë për:

a.Shpenzimet korrente (600-606), me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17761/245, datë 22.01.2016 "Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2016", në vlerë 15,000 mijë lekë, janë miratuar shpenzimet korrente, të ndara me artikuj:

-Paga e shtesa (artikulli 600), për 8,330 mijë lekë;
-Sigurime shoqërore (artikulli 601), për 1,670 mijë lekë;
-Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), për 5,000 mijë lekë.

b.Shpenzimet për investime (artikujt 230-231), me shkresën nr.761/2, datë 08.02.2016 "Mbi detajimin dhe miratimin e investimeve për vitin 2016", në vlerë 1,000 mijë lekë, është çelur për blerje autoveture.

Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime) gjatë vitit 2016, kanë rezultuar në ulje për **1,200 mijë lekë,** pra plani përfundimtar ka rezultuar për 14,800 mijë lëkë, ose me 7.5% më pak se plani fillestar, ndryshime të ndodhura në këto zëra të buxhetit:

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), janë pakësuar gjatë vitit në vlerë 200 mijë lekë, me aktin normativ nr.1.

-Investimi i brendshëm (artikulli 231), janë pakësuar gjatë vitit për 1,000 mijë lekë, sepse me shkresën 4007/1, datë 23.03.2016 "Mbi ngurtësimin e shpenzimeve kapitale", në vlerë 1,000 mijë lekë u ngurtësuan dhe nuk u çelën më gjatë vitit 2016.

Zbatimi i buxhetit gjatë vitit 2016 dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar.

Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij gjatë vitit dhe realizimi i tyre për vitet 2015-**2016**, paraqiten si në tabelën e mëposhtme: *Në mijë lekë*

Art.	Struktura buxhetore	Fakti i 2015	Plani 2016	Ndryshimet gjatë vitit	Plani i rishikuar	Realizimi 2016	diferenca	Në %
600	Paga e Shtesa	6,116	8,330		8,330	7,746	584	93
601	Sig. shoqë e shendetsore	940	1,670	-200	1,470	1,191	279	81
602	Blerje mallra e sherbime	1,892	5,000		5,000	4,991	9	100
231	Shpenz. për investimeve	727	1,000	-1,000	0	0	0	0
	TOTALI	**9,675**	**16,000**	**-1,200**	**14,800**	**13,928**	**872**	**94**

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

Pra shpenzimet për paga e shtesa **(600)** janë çelur në vlerë 8,330 mijë lekë, nga 6,117 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 27% më shumë;

Janë realizuar në vlerë 7,746 mijë lekë, pra 7% më pak se plani dhe 27% më shumë se një vit më parë.

Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetsore **(601)** janë çelur në vlerë 1,670 mijë lekë, nga 940 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 78% më shumë;

Janë pakësuar për 200 mijë lekë gjatë vitit 2016, ose 12% të totalit të tyre;

Janë realizuar në vlerë 1,191 mijë lekë, pra 19% më pak se plani i ndryshuar, apo 29% më pak se plani fillestar dhe 27% më shumë se një vit më parë.
Shpenzimet për blerje mallra e shërbime **(602**), janë çelur në vlerë 5,000 mijë lekë, nga 1,892 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo 2.6 herë më shumë;
Janë realizuar në vlerë 4,991 mijë lekë, afersisht 100% e tyre dhe 2.6 herë më shumë se një vit më parë
Shpenzimet për investime **(231),** janë çelur në vlerë 1,000 mijë lekë, nga 727 mijë lekë realizuar një vit më parë, apo çelur 37% më shumë më shumë se realizimi i një viti më parë;
Janë pakësuar gjatë vitit me shkresën e ministrisë së financave për ngurtësimin e investimeve e gjithë vlera e çelur.

Raportet e monitorimit të Buxhetit për vitin 2016.
Paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e këtij institucioni për vitin 2016, nuk janë raporte monitorimi sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në anekset përkatëse. Raporti i monitorimit të këtij viti ka të plotësuara vetëm disa nga tabelat e raportimit dhe **jo relacionin e tij**, ku mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit.
Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arritjet edhe problematikat. Pjesë e raportit të monitorimit duhet të jenë edhe shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, si edhe treguesit e performancës së realizimit të tyre.
Viti 2017.
Në zbatim të legjislacionit të mësipërm dhe udhëzimit nr.4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019" të dërguar nga MoF me shkresën nr.2985/4, datë 04.03.2016. Me shkresën nr. 3470/34, datë 15.04.2016, faza e parë duhet të dërgohet në MOF brenda datës 30.04.2016, duke respektuar **tavanet** e miratuara me VKM nr.230, datë 30.03.2016. Tavanet e vitit 2017 për këtë institucion janë miratuar:
Paga e sigurime (600-601) për 10,000 mijë lekë;
Shpenzime korente (602-606) për 5,000 mijë lekë;
Shpenzime për investime (230-231) për 1,000 mijë lekë.

- Programimi në fazën e **I-rë** të PBA 2017-2019 është bërë me shkresën nr.300/1, datë 21.04.2016, brenda afatit ligjor dhe duke mbajtur parasysh limitin e përcaktuar nga Ministria e Financës me shkresën nr.3470, datë 15.04.2016, për përcjelljen e kërkesave buxhetore, të cilat përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2017-2019, si misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve me artikuj buxhetorë dhe VKM nr. 230, datë 30.03.2016. Planifikimi në këtë fazë është bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 16,000 mijë lekë, kërkesat e institucionit janë në të njëjtat vlera, po ashtu e njëjtë me një vit më parë.
- Programimi në fazën e **II-të** të PBA 2017-2019 dhe **projekt buxheti i vitit 2017,** është bërë në mbështetje të VKM "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019". MoF me shkresën "Dërgohen tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2017-2019" ka përcjellë tavanet e shpenzimeve buxhetore për këtë institucion. Programimi në këtë fazë është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën "Dërgohen kërkesat për PBA 2017-2019", si misionin deklaratat, shpenzimet sipas projekteve dhe produkteve me artikuj buxhetorë. Programimi në këtë fazë është

bërë brenda limitit të përcaktuara nga Ministria e Financës, në vlerë 16,000 mijë lekë, e njëjtë me kërkesat AAPSK. Struktura buxhetore edhe për këtë fazë të Programit buxhetor Afatmesëm 2017-2019, paraqitet me një program.

Shpenzimeve buxhetore për PBA 2017-2019, në të dy fazat e saj, miratimi i projekt buxhetit 2017, paraqitet si në tabelën e mëposhtme: *Në mijë lekë*

	Struktura buxhetore	Realizimi i 2016	PBA Faza e pare 2017	PBA Faza e dytë PBuxheti 2017	Aprovimi i projekt buxhetit 2017
600	Paga e Shtesa	7,746	8,330	8,330	8,330
601	Sig. shoqërore e shendetsore	1,191	1,670	1,670	1,670
602	Blerje mallra e sherbime	4,991	5,000	5,000	5,000
231	Shpenz. për investimeve	0	1,000	1,000	1,000
	TOTALI	**13,928**	**16,000**	**16,000**	**16,000**

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

Të dyja fazat e programimit dhe miratimi i projekt buxhetit është në vlerë 16,000 mijë lekë, nga 13,928 mijë lekë të realizuara një vit më parë, pra është programuar më shumë për 3,072 mijë lekë, ose 15% më shumë se realizimi i një viti më parë.

Me artikuj buxhetorë, miratimi i shpenzimeve për vitin 2016 ka rezultuar:

Paga e shtesa (artikulli 600) për 8,330 mijë lekë;
Sigurime shoqërore (artikulli 601), për 1,670 mijë lekë;
Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), për 5,000 mijë lekë;
Investim i brendshëm (artikulli 231), për 1,000 mijë lekë.

Çelja e buxhetit dhe detajimi i tij për vitin 2017. Shuma e shpenzime korrente dhe shpenzime për investime, janë çelur këtë vit në vlerë **16,000 mijë lekë**, të ndara për:

a.Shpenzimet korrente **(artikujt 600-606),** me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17911/218, datë 24.01.2017 "Mbi detajimin e buxhetit të vitit 2017 dhe limiti mujor i tij", në vlerë 15,000 mijë lekë, pra janë miratuar shpenzimet korrente, njësoj si një vit më parë, të ndara me artikuj:

Paga e e shtesa (artikulli 600), gjithësej në vlerë 8,330 mijë lekë;
Sigurime shoqërore (artikulli 601), në vlerë 1,670mijë lekë;
Blerje mallra e shërbime (artikulli 602), në vlerë 5,000 mijë lekë;

b.Shpenzimet për investime **(artikulli 231)**, me shkresën nr. 17911/343, datë 08.02.2017 "Mbi detajimin dhe miratimin e investimeve kapitale për vitin 2017", në vlerë 1,000 mijë lekë, janë çelur për blerje pajisje informatike.

Ndryshimet e buxhetit (shtime e pakësime) gjatë 8/mujorit të vitit 2017, kanë rezultuar me ndryshime të ndodhura në këto zëra të buxhetit:

-Paga e shtesa (artikulli 600), shtuar për 1,197 mijë lekë me shkresën e Miminstrisë së Financave nr. 6089, datë 13.06.2017, në zbatim të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nr.202, datë 15.03.2017 "Mbi vlerat e reja të pagave të administratës publike".

-Sigurime shoqërore (artikulli 601), shtuar për 690 mijë lekë me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 6089, datë 13.06.2017, në zbatim të VKM nr.187, datë 08.03.2017 dhe nr.202, datë 15.03.2017 "Mbi vlerat e reja të pagave të administratës publike".

Gjithashtu jashtë programimit dhe për herë të parë këtë vit janë shtuar me shkresën nr.17928/2, datë 18.01.2016 "dërgohet urdhërv nr.9, datë 18.01.2016, per destinimin e fondit të posacëm në mbështetje të urdhërit të ministrit të financave nr.84, datë 08.10.2014", pra janë shtuar në artikullin 604 vlera prej 25,000,000 lekë, e cila do të përdorej për disa likujdime të trajtuara më poshtë:

Zbatimi i buxhetit të 8/mujorit të vitit 2017. Për këtë vit janë kryer rakordimet me Drejtorinë e Thesarit dhe Drejtorinë e Buxhetit, brenda afateve dhe formateve të miratuara nga Ministria e Financës. Të përmbledhura, në grupet kryesore të shpenzimeve, plani fillestar ndryshimet e tij

gjatë kësaj periudhe dhe realizimi i tyre për 8/mujorin e vitit 2016 dhe **8/mujori i vitit 2017**, paraqiten si në tabelën e mëposhtme: *Në mijë lekë*

Art.	Struktura buxhetore	Fakti i 8/mujor 2016	Plani 8/ mujor 2017	Ndryshimet gjatë periudhës	Plani i rishik.8/m	Realizimi 8/muj 2017	diferenca	Në %
600	Paga e Shtesa	4,861	5,876	87	5,963	5,949	-14	99.8
601	Sig. shoqër e shendetsore	750	890	37	927	906	-21	97.7
602	Blerje mallra e shërbime	2,600	4,298	0	4,298	2,433	-1,865	56.6
231	Shpenz. për investimeve	0	1,000	-1,000	0	0	0	0
	TOTALI	**8,211**	**11,962**	**-774**	**11,188**	**9,288**	**-1,900**	**83**
604	Transferta të brendëshme			25,000	25,000	14,380	-10,620	-42.5

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

-Pra shpenzimet për paga e shtesa **(artikulli 600)** janë çelur për 8 mujorin 2017, në vlerë 5,876 mijë lekë, nga 4,861 mijë lekë realizuar një vit më parë për këtë periudhë, apo 21% më shumë;
Janë shtuar gjatë periudhës në vlerë 87 mijë lekë, ose 1.5% më shumë;
Janë realizuar shpenzimet për pagat në vlerë 5,949 mijë lekë, pra 0.2% më pak se plani me ndryshime dhe 22% më shumë se e njëjta periudhe e një vit më parë.
-Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetsore **(artikulli 601)** janë çelur për 8 mujorin në vlerë 890 mijë lekë, nga 750 mijë lekë realizuar një vit më parë për këtë periudhë, apo 19% më shumë;
Janë shtuar gjatë kësaj periudhe për 37 mijë lekë, ose 4% më shumë.
Janë realizuar në vlerë 906 mijë lekë, pra 21 mijë lekë më pak se plani i ndryshuar dhe 21% më shumë se realizimi i kësaj periudhe një vit më parë.
-Shpenzimet për blerje mallra e shërbime **(artikulli 602**), janë çelur për këtë periudhë në vlerë 4,298 mijë lekë, nga 2,600 mijë lekë realizuar në të njëjtën periudhe një vit më parë, apo 65 % më shumë;
Janë realizuar për këtë periudhë në vlerë 2,433 mijë lekë, ose 43% më pak se plani i ndryshuar dhe 6% më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë.
-Shpenzimet për investime **(artikulli 231),** janë çelur në vlerë 1,000 mijë lekë, shumë e cila është pakësuar gjatë periudhës me ngrirjen e fondit të investimeve.
-Janë përdorur dhe kaluar nga llogaria e **thesarit**, (**në artikullin 604)"**Trasferta të brendëshme", shuma prej **14,380,000 lekë** me 6 urdhër shpenzimi për 4 subjekte përfituese, si më poshtë: *Në lekë*

Nr.	Subjekti përfitues	Kontrata		Likujduar		Diferenca pa likujd	
		Nr. Datë	Shuma	Nr. Datë e u.shp.	Shuma	Në vlerë	Në %
1	Shoqëria "A"	1093, datë 30.12.2016	2,500,000	*31, datë 02.03.2017*	*1,000,000*		
				51, datë12.04.2017	*1,250,000*		
				93,datë 13.07.2017	*250,000*		
					2,500,000	0	0
2	QK Pritëse e Viktimave të Traf.	9, datë 04.01.2017	2,200,000	29, datë 02.03.2017	880,000	-1,320,000	-60
3	Shoqëria "T.	1094, datë 30.12.2016	2,500,000	30,datë 02.03.2017	1,000,000	-1,500,000	-60
4	DPP Hetimin e Krimit të Organiz.	56, datë 10.01.2017	10,000,000	32, datë 02.03.2017	10,000,000	0	0
	Shuma		**17,200,000**		**14,380,000**	**-2,820,000**	**-16.4**

Këto kalime fondesh janë realizuar nga sektori i brendshëm i këtij institucioni-zyra e financës, ndërsa dokumentacioni shoqërues rezulton në dosjet e kordinatorit të terenit, si më poshtë:
a. Shkresën e Ministrisë së Financave nr.17928/2, datë 18.01.2016, dërgohet urdhëri nr.9, datë 18.01.2016 i Ministrit të Financave "Për destinacionin e posaçëm, në mbështetje të urdhërit të Ministrit të Financave nr.84, datë 08.10.2014", pika 1, fondi i posaçëm prej **25,000,000 lekë** të

përdoret 20,000,000 lekë të përdoret nga institucionet shtetërore të luftës kundër krimit të organizuar dhe 5,000,000 lekë të përdoret nga organizata jo fitim prurëse për mbrojtjen dhe reabilitimin e viktimave të krimit të organizuar (çdo projekt i këtyre oganizatave të mos e kalojë shumën 2,500,000 lekë);
a/1.Shkresën e Ministrisë së Financave nr.17664, datë 22.12.2016, pra urdhëri nr.9/1, datë 22.12.2016 i ministrit të Financave "Për financimin e projekteve dhe mënyrat e përdorimit të fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor", pika 1, fondi i posaçëm prej **5,000,000 lekë** të përdoret për:
Shoqërisë ..... i alokohet shuma prej 2,500,000 lekë;
Shoqërisë .....i alokohet shuma prej 2,500,000 lekë.
Pika 2 e këtij urdhëriciton se fondi i akorduar përdoret prej tyrenë përputhje me projektin e miratuar, sipas regullave të përdorimit të fondeve buxhetore dhe klasifikohen si e ardhur jashtë limitit (kapitulli 06). Ngarkohet AAPSK për zbatimin e këtij urdhëri.
a/2.Shkresën e Ministrisë së Financave nr.17664/2, datë 22.12.2016, pra urdhëri nr.9/2, datë 22.12.2016 i ministrit të Financave "Për financimin e projekteve dhe mënyrat e përdorimit të fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor", pika 1, fondi i posaçëm prej **20,000,000 lekë** të përdoret për:
Drejtorinë e policisë së shtetit i alokohet shuma prej 10,000,000 lekë;
Prokurorisë së përgjithëshme i alokohet shuma prej 7,800,000 lekë;
Qendres Kombëtare Pritëse të viktimave të trafikimit, në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, i alokohet shuma prej 2,200,000 lekë.
Pika 2 e këtij urdhëri citon se fondi i akorduar përdoret prej tyre në përputhje me projektin e miratuar, sipas regullave të përdorimit të fondeve buxhetore dhe klasifikohen si e ardhur jashtë limitit(kapitulli 06). Ngarkohet AAPSK për zbatimin e këtij urdhëri.
b.Dokumentat e aplikimit të projekteve.
c. Me urdhërin e kryeadministratorit të AAPSK nr.362, datë 30.06.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të projekteve që do të miratohen nga AAPSK-ja", pika 1 të ngrihet komisioni me Q.Th., kryetar, M.H dhe E.D antarë. Pika 2 e urdhërit: komisioni do monitorojë, pagesën e tyre sipas kontratës dhe përgatitjen e raporteveperiodike në lidhje me ecurinë e projekteve.
d.Kontratat midis AAPSK dhe subjekteve përfituese:
-Me subjektin .....kontrata me nr.1093, datë 30.12.2016, neni 4, fondi që do të mbështesë AAPSK –ja, në vlerë 2,500,000 lekë, ose 22% të projektit total.
-Me subjektin "....., kontrata me nr.1094, datë 30.12.2016, neni 4, fondi qe do të mbështesë AAPSK-ja 2,500,000 lekë, ose 100% të projektit total.
-Me subjektin "....."., kontrata me nr.9, datë 04.01.2017, neni 4, fondi qe do të mbështesë AAPSK-ja 2,200,000 lekë, ose 100% të projektit total.
-Me subjektin "Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda", kontrata me nr.56, datë 10.01.2017, neni 4, fondi qe do të mbështesë AAPSK-ja 10,000,000 lekë, ose 100% të projektit total.
e. Dokumentat justifikues, situacione, fatura etj.
f. Raportet e grupit të monitorimit të projektit nga komisioni i vlerësimit të projekteve.

b. Mbi organizimim dhe mbajtja e kontabilitetit për vitet 2016 dhe 8/mujorin e vitit 2017 (fondeve buxhetore të kaluara nëpërmjet thesarit).
Në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar citohet: "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave

financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar, ose në bartës informatikë. Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese.
Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente: bilancin kontabël; pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve; pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta; pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash floë); anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.

b/1.Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve e vlerave materiale, inventarizimi i tyre, dokumentimi i veprimeve ekonomike dhe regjistrimet në kontabilitet. Në këtë institucion, kontabiliteti dhe pasqyrat financiare janë organizuar dhe funksionojnë në përputhje me ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar. Pra rregjistrimi në kontabilitet i veprimeve të lëvizjes së aseteve, aktiveve qarkulluese dhe cashit mbahet me formatin e ditarëve dhe librave të kontabilitetit në ekxsel, në ditarët e shpenzimeve, e veprimeve me bankën, kontabilizimit të pagave, të të ardhurave, e hyrje daljeve të magazinës dhe ditarin e veprimeve të ndryshme. Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve për vitin **2016 dhe 8/ mujorin e vitit 2017** rezultoi:
a.Nga kontrolli i dokumentacionit të ditarit të **shpenzimeve** rezultoi se në përgjithësi urdhër-shpenzimet janë plotësuar konform formatit të miratuar në të gjitha ekstremet dhe fushat, me të gjitha firmat me specimentet e depozituara dhe saktësinë e vulës së njësisë publike. Nga kontrolli dokumentacionit rezultoi se shpenzimet e shënuara në urdhër shpenzimet kanë bashkëlidhur dokumenta origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit.
Nga kontrolli i destinacionit dhe shumës së fondeve në dispozicion rezultoi se shpenzimet janë kryer sipas dokumentave bashkangjitur urdhër-shpenzimit, janë shpenzime të së njëjtës natyrë me fondet e aprovuara për këtë qëllim dhe për secilën kategori shpenzimesh.
Pra për vitin 2016 kanë kaluar dhe janë kontabilizuar në ditarin e shpenzimeve me **159** urdhër shpenzimesh, ku kontabilizimi i shpenzimeve është kryer në llogaritë përkatëse dhe me dokumentacionin e domosdoshëm ligjor.
Megjithatë gjatë rregjistrimit të tyre, u konstatuan: Katër numra urdhër-shpenzimesh janë përsëritur 2 herë, e pikërisht numrat 18, 55, 69 dhe 88. Gjithashtu për këtë periudhë mungojnë tre numra urdhër shpenzimesh, e pikërisht numrat e urdhër shpenzimeve 19, 21 dhe 130.
Për 8/ mujorin e vitit 2017, kanë kaluar dhe kontabilizuar në ditarin e shpenzimeve me 110 urdhër shpenzimesh, ku kontabilizimi i shpenzimeve është kryer në llogaritë përkatëse dhe me dokumentacionin e domosdoshëm ligjor. Megjithatë gjatë rregjistrimitv të tyre, u konstatuan: Katër numra urdhër-shpenzimesh janë përsëritur 2 herë, e pikërisht numrat 19, 32, 51 dhe 81. Gjithashtu për këtë periudhë mungon një numër urdhër shpenzimi, e pikërisht numri 14.
b.Nga auditimi i ditarit për **hyrje-daljet** e magazinës, rezultoi se :
Për vitin 2016, në ditarin e hyrjeve të kancelarisë dhe karburantit, gjithsej për këtë vit janë rregjistruar **6** fletë hyrje, (nga të cilat 3 hyrje janë hyrje karburanti, në vlerë 601,335 lekë dhe 3 hyrje kancelari e tonera në vlerë 562,615 lekë), e gjithë shuma në llogarinë 31 "materiale" në vlerë 1,163,970 lekë dhe në kredi të llogarisë 63 "ndryshimit të gjendjes". Fletë hyrjet kishin të bashkëlidhur faturën e shitësit dhe aktin e marjes në dorrëzim. (mungon një numër fletë hyrjeje).

-Në ditarin e **daljeve** nga magazina janë kontabilizuar **88** fletë dalje, në vlerë 7,135,362 lekë, duke debituar llogarinë 63 "ndryshimin e gjendjes", në vlerë 7,081,582 lekë dhe duke kredituar llogarinë 31 "materiale" për 7,135,362 lekë & llogarinë 327 "inventarin e imët" për 53,780 lekë. Fletë Daljet e karburantit priten nga magazinieri për çdo rast furnizimi. Fletë daljet kishin të bashkëlidhur autorizimin e përgjegjsit të Sektorit administrativ, të miratuar nga administratori i Agjencisë, për furnizimin me materiale, kancelari apo me karburant.
Për 8/mujorin 2017, në ditarin e **hyrjeve** të kancelarisë dhe karburantit, gjithsej janë rregjistruar 3 fletë hyrje, (nga të cilat 2 hyrje janë hyrje karburanti, në vlerë 766,890 lekë dhe 1 hyrje kancelari në vlerë 4,680 lekë), e gjithë shuma në llogarinë 31 materiale në vlerë 771,570 lekë dhe në kredi të llogarisë 63 ndryshimit të gjendjes po me këtë vlerë. Fletë hyrjet kishin të bashkëlidhur faturën e shitësit dhe aktin e marjes në dorrëzim të mallit.
-Në ditarin e **daljeve** nga magazina janë kontabilizuar 44 fletë dalje, në vlerë 326,291 lekë, duke debituar llogarisë 63 ndryshimin e gjendjes po në këtë vlerë dhe duke kredituar llogarinë 31 materiale kancelari për 43,425 lekë & karburant për 282,919 lekë. Fletë Daljet e karburantit priten nga magazinierja për çdo rast furnizimi. Fletë daljet kishin të bashkëlidhur autorizimin e përgjegjsit të Sektorit administrativ, të miratuar nga administratori i Agjencisë, për furnizimin me materiale, kancelari apo me karburant.

c. Auditimi i **inventarizimit të pronës** shtetërore për vitin 2016, u krye në përputhje me legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ku përcaktohen qartë:
Menaxhimi i aktiveve është një pjesë themelore e menaxhimit financiar, prandaj është një prej përgjegjësive të Nëpunësit Autorizues në njësitë e sektorit publik. Çdo njësi duhet të vendosë procedura për pranimin, përdorimin efektiv, efiçent për ruajtjen, qarkullimin dhe asgjësimin e aktiveve nën kontrollin e tyre.
Regjistrat e aktiveve: Është një praktikë e mirë pune për çdo njësi që të hartojë, të mbajë dhe të rifreskojë një regjistër të të gjitha aktiveve që ajo ka në pronësi dhe që përdor. Ky regjistër do të jetë i vlefshëm në përgatitjen e llogarive të saj. Është gjithashtu një praktikë e mirë, që të verifikohet gjendja e aktiveve aktuale të njësisë dhe të planifikohen ndryshime. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet e luajtshme dhe ato të paluajtshme si dhe të specifikojë aktivet, të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën kontrollin e tij ligjor.
Kategori kryesore të aktiveve afatgjata të sektorit publik janë*:*
Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara: Toka, ndërtesat, aktivet të trupëzuara të dhëna me lizing, magazinat dhe dyqane, fabrikat dhe makineritë, pajisjet, automjetet, mobilie dhe montimet, aktivet në ndërtim, aktivet fizike të dhuruara, aktivet e infrastrukturës, aktivet të trashëguara, punimet e artit dhe antikuariatet, soft-ëare që zhvillohet nga vetë njësia.
Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuara dhe Financiare: E drejta e autorit, markat, franchises, patentat, të drejtat e pronësisë intelektuale, emri i mirë, të dhënat dhe informacioni, njohuritë dhe knoë-hoë, liçencat e përdorimit të soft-ëare-ve, aksionet dhe obligacionet, kapitali i dividendit publik, huatë dhe depozitat dhe investime të tjera.
Në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", në Kapitullin IV "Sistemi i kontrollit periodik të Aktiveve": përcaktohet: "Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të Titullarit të njësisë publike, ose Nëpunësit Autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për

inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi. Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë publike, jep llogari tek Titullari për mënyrën e funksionimit të tyre dhe ka detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve.

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve *mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale* për moskryerjen me saktësi të inventarit.

Sektori i Financës të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.20, datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", citohet: "Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike. Komisioni i inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak lidhur me cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet, lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues".

Nga auditimi i dokumentacionit, të inventarizimit rezultoi:

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të titullarit nr.1038, datë 16.12.2016 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK" është përcaktuar: Komisionit të inventarizimeve, dhe data e përfundimit të tij më 31.12.2016, në zbatim të ligjit nr.9228, datë 29.04.7.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 7 dhe VKM nr.70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", i ndryshuar me VKM nr.445, datë 20.12.1990", pra kjo bazë ligjore e cituar në urdhër është shumë e prapambetur, kur duhet të ishte cituar ligji nr, 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me nr.20, datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Megjithatë është plotësuar me të dhënat **"**Rregjistri i aktiveve" që ka në zotërim institucioni. Aktivet sipas llogarive përkatëse afatgjata janë të evidentuara sipas llogarive në mënyrë analitike edhe me përmbledhëse për çdo llogari, të cilat janë të barabarta me kartelat e punonjësve për asetet që u janë shpërndarë atyre, dhe me gjendjen e tyre në magazinë.
Gjatë verifikimit listës së objekteve të inventarizuar dhe të regjistrit të aktiveve të qendrueshme konstatohet se:
-Janë kaluar në aktive të qendrueshme (llogaria 218 inventar ekonomik) edhe një sasi e aktiveve qarkulluese, (pra llogaria 327 "objekte inventari"), për objekte të cilat nuk e kanë as rolin dhe vlerën si:
Makina kapse dokumentash copë 5, me cmim 200 lekë; Makina kapse dokumentash të mëdha copë 1, me cmim 2,500 lekë; Kosh plerash copë 5 me cmim 900 lekë; Tabela dyersh copë 6, me çmim 500 lekë; e kështu me radhë kyce, dryna, shirita,kosha letre, foto presidenti, zgjatuesa dhe usb etj.
-Nuk është bërë inventarizimi në fund të vitit i llogarive inventariale 311 "Materiale" dhe 327 "Objekte inventari, gjendje në magazinë, si për sasinë e magazines së institucionit dhe për gjendjen e magazinës së Administratorëve.
Sektori i Financës i ka dorrëzuar komisionit përkatës, llogaritë analitike të të gjitha llogarive të aseteve, sipas kontabilitetit, si më poshtë:
Llogaria 205 0100 "koncesione patenta", në vlerë 548,748 lekë;
Llogaria 214 0170 "Instalime teknike, makineri e paisje", në vlerë 755,800 lekë;
Llogari 215 1120 "Mjete transporti", në vlerë 4,389,348 lekë;
Llogaria 218 1100 "Inventar ekonomik", në vlerë 2,158,353 lekë;
Llogaria 218 5100 "Inventar ekonomik, në vlerë 15,000 lekë;
Llogaria 218 6100 "Inventar ekonomik, në vlerë 2,674,334 lekë;
Llogaria 218 7100 "Inventar ekonomik, në vlerë 393,281 lekë.
Sipas **proces verbalit të komisionit të inventarizimit** asetet e qendrueshme të trupëzuara, janë të ndara:
-*Gjendja në magazinë e paisjeve:*
Llogari 215 1120 "Mjete transporti", në vlerë 3,389,348 lekë ;
Llogaria 218 1100 "Inventar ekonomik", në vlerë 409,330 lekë ;
Llogaria 218 5100 "Inventar ekonomik, në vlerë 15,000 lekë.
Llogaria 218 6100 "Inventar ekonomik, në vlerë 774,310 lekë ;
Llogaria 218 7100 "Inventar ekonomik, në vlerë 174,457 lekë.
-*Gjendja e objekteve dhe paisjeve në përdorim:*
Llogaria 205 0100 "koncesione patenta", në vlerë 548,748 lekë;
Llogaria 214 0170 "Instalime teknike, makineri e paisje", në vlerë 755,800 lekë;
Llogari 215 1120 "Mjete transporti", në vlerë 1,000,000 lekë ;
Llogaria 218 1100 "Inventar ekonomik", në vlerë 1,749,023 lekë ;
Llogaria 218 6100 "Inventar ekonomik, në vlerë 1,900,084 lekë ;
Llogaria 218 7100 "Inventar ekonomik, në vlerë 218,824 lekë.

Në përfundim të invetarizimit, janë **përgatitur listat për çdo llogari** dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe antarët e komisionit të inventarizimit, por pa hartuar një raport nga komisioni i inventarizimit lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak të cilësisë dhe kushtet e_ruajtjes së tyre, gjendjen fizike për titullarin e institucionit.
Nga auditimi rezultoi se, gjendja fizike e mallrave dhe paisjeve ishte e barabartë me gjendjen kontabël, e pasqyruar në listat përmbledhëse e krahasuese të cikluara nga komisioni i

inventarizimit për rezutatet e këtyre inventarëve. Gjendja e këtyre listave ishte e barabartë edhe me gjendjet e këtyre llogarive në bilancin e vitit 2016.

Në oservacionin e ardhur nga subjekti citohet: *"Nga AAPSK nuk është bere inventarizimi i pajisjeve / makinerive te sekuestruara / konfiskuara të ndodhura në magazine..." Sa me sipër sqarojmë se: Të gjitha pasuritë e luajtshme të depozituara në magazinën e AAPSK-së, janë të pasqyruara në kartelat përkatëse që mbahen nga administratoret e pasurive, të cilët i kanë nën administrim*". Pra ky observacion nuk e mënjanon kryerjen e inventarizimit të aseteve të institucionit para mbylljes së pasqyrave financiare.

d.Nxjerrja e **bilancit kontabël i viti 2016:** Auditimi i plotësimit të pasqyrave financiare është bërë në përputhje me UMF nr.14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me udhëzimin nr.26, datë 27.12.2007**.**

Llogaria vjetore e këtij viti është plotësuar sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës, është përfunduar dhe dërguar në Ministrinë e Financave më 14.02.2017, e konfirmuar nga dega e Thesarit Tiranë. Pra bilanci kontabël i vitit 2016 është përgatitur dhe dorrëzuar në afatin e përcaktuar në këtë udhëzim dhe përmban:

-Aktivin dhe Pasivin, sipas formateve nr.1&2; Pasqyrën e shpenzimeve dhe të ardhurave (Formatet nr.3/1 & 3/2); Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet (Formati nr.4); Pasqyrën mbi lëvizjen "CASH" (Formati nr.5); Pasqyrën mbi gjëndjen dhe ndryshimet në Aktivet e Qëndrueshme, si dhe Amortizimin e tyre (Formati nr.6 & nr.7); Pasqyrën e lëvizjes së fondeve (Formati nr.8); Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave (Pasqyra nr.9); Pyetesorin mbi të dhënat e shënimet shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare (Formati nr.10), por pa relacionin shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit. Gjithashtu ky bilanc shoqërohej dhe me formatin 11*"Pasqyrë e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimet e funksionimit" dhe Formati nr.12 "Pyetsor dhe shënime shpjeguese për hartimin llogarivetë administrimit financiar".*

Gjendja e llogarive **aktive** për vitin 2015, e një viti më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2015-2014), rezultojnë si në tabelën e mëposhtme: *Në lekë*

Llog.	Emërtimi i llogarive të aktivit	Viti 2015	Viti 2016	Dif.2016-2015
A	**AKTIVE TE QENDRUESHME**	**22,034,951**	**21,453,357**	**-581,594**
20, 230	**Aktive të Qendrueshme të pa trupëzuara**	**157,051**	**117,788**	**-39,263**
205	Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme	548,748	548,748	0
209	Amortizimi i aktiveve qënd të pa trupëz "	-391,697	-430,960	**-39,263**
21,23,24,28	**Aktive të Qendrueshme të Trupëzuara**	**21,877,900**	**21,335,569**	**-542,331**
212	Ndërtime e Konstruksione	16,926,300	16,926,300	0
214	Instalime, teknike, makineri paisje vegla	755,800	755,800	0
215	Mjete transporti	4,389,348	4,389,348	0
218	Inventar ekonomik	5,240,966	5,240,966	0
219	Amortizimi aktivive të qendr.të trupëzuara(-)	-5,434,514	5,976,845	-542,331
B	**AKTIVE QARKULLUESE**	**1,005,169**	**1,671,399**	**666,230**
Klasa 3	**Gjendja e Inventarit**	**480,577**	**933,949**	**453,372**
31	Materiale	480,577	933,949	453,372
Klasa 4	**Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët**	**624,592**	**737,450**	**112,858**
4342	Të tjera operacione me shtetin(debitor)	624,592	737,450	112,858
	TOTALI I AKTIVIT (A + B)	**23,140,120**	**23,124,756**	**-15,364**

Duke analizuar aktivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë aktive janë më pak se një vit më parë për 15,364 lekë,ndërsa me klasa dhe llogari, rezultojnë si më poshtë:

*Llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (*20-230), janë më pak se një vit më parë për 39,263 lekë, ose --% më pak, ndërsa me klasa dhe llogari, rezultojnë si më poshtë:

Llogaria 205"Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme", në vlerë të njëjtë prej 548,748 lekë.
Llogaria 209"Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara", në vlerë më shumë se një vit më parë prej 39,263 lekë, vlerë e cila tregon vlerën e amortizimit e këtij viti.
Llogaritë e aktiveve të qëndrueshme *<u>të trupëzuara</u>* (21, 23, 24, 28), në vlerë më pak se një vit më parë për 542,331 lekë, shtesë e cila përbëhen nga:
Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione", sa vlera e një viti më parë për 16,926,300 lekë.
Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisje vegla", sa vlera e një viti më parë për 755,800 lekë.
Llogaria 215 "Mjete transporti", sa vlera e një viti më parë për 4,389,348 lekë.
Llogaria 218 "Inventar ekonomik", sa vlera e një viti më parë për 5,240,966 lekë.
Llogaria 219 "Amortizimi aktivive të qëndrueshme të trupëzuara (-)", është llogaritur për këtë vit më shumë se një vit më parë, në vlerë 542,331 lekë, sa tabela e llogaritjes së tij që shoqëron bilancin e këtij viti.
Llogaritë e aktiveve të qarkulluese (klasa 3&klasa 4), në vlerë më shumë se një vit më parë për 666,230 lekë, si më poshtë:
Llogaria 311"Materiale", është më shumë se një vit më parë, në vlerë 453,372 lekë.
Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin(debitor)", është më shumë se një vit më parë, në vlerë112,858 lekë.

<u>Gjendja e llogarive **pasive** në fund të vitit 2015,</u> gjendja e tyre një vit më parë, por edhe diferenca midis dy periudhave (2014-2013), rezultuan si në tabelën e mëposhtme: *Në lekë*

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	Viti 2015	Viti 2016	Dif. 2016-2015
A	**FONDE TË VETA**	**22,515,528**	**22,387,306**	**-128,222**
I0	**Fonde të veta**	**22,515,528**	**22,387,306**	**-128,222**
101	Fonde bazë	3,274,339	2,204,212	-1,070,127
105	Grande të brendëshme kapitale	1,903,800	2,619,694	715,894
106	Grande të huaja kapitale	637,100	637,100	0
107	Vlera e AQ të caktuara në përdorim	16,926,300	16,926,300	0
B	**DETYRIME**	**624,592**	**737,450**	**112,858**
424-425	Personeli e llogari të lidhura me to	439,299	514,179	74,880
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	45,191	55,643	10,452
435	Sigurime shoqërore	121,415	145,187	23,772
436	Sigurime shëndetsore	18,687	22,441	3,754
X	**T O T A L I I P A S I V I T (A+B)**	**23,140,120**	**23,124,756**	**-15,364**

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më pak se një vit më parë për 15,364 lekë, ndërsa me grupe e klasa, janë si më poshtë:
Llogaritë e fondeve të veta janë pakësuar për këtë vit për 128,222 lekë, dhe është rezultante e:
Llogaritë e fondeve bazë janë pakësuar për këtë vit për 1,070,127 lekë;
Llogaritë e grandeve të brendëshme kapitale janë shtuar për këtë vit për 715,894 lekë;
Llogaritë e f grandeve të huaja kapitale nuk kanë ndryshuar për këtë vit;
Llogaritë Vlera e AQ të caktuara në përdorim, nuk kanë ndryshuar për këtë vit.
Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, janë shtuar në vlerë 112,858 lekë, si më poshtë:
Llogaria 424,425"Personeli e llogari të lidhura me to", është shtuar këtë vit në vlerë 74,880 lekë;
Llogaria 431"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", është shtuar këtë vit në vlerë 10,452 lekë;
Llogaria 435"Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore", është shtuar këtë vit në vlerë 23,772 lekë.
Llogaria 436"Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetsore", është shtuar këtë vit, në vlerë 3,754 lekë.

Bilanci i AAPSK për vitin 2016, përveç aktivit dhe pasivit ka të plotësuara edhe të gjitha **formatet shoqëruese**, si më poshtë:
-*Formati 3/1"Shpenzimet e ushtrimit", në vlerë 14,494,381lekë*, nga 8,547,371 lekë një vit më parë. Ky format është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, në vlerë 7,831,025lekë, 601/sigurimet shoqërore e shëndetsore, në vlerë 1,218,672 lekë, 602/mallra e shërbime, në vlerë 4,991,312 lekë. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor 2016. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve që kanë qenë më 1 janar 2016 në bilanc dhe i janë shtuar detyrimet, të cilat kanë ngelur si detyrim për vitin e ardhshëm. Është evidentuar në këtë format edhe ndryshimi i gjendje së inventarit në vlerë 453,372 lekë, pra totali i shpenzimeve ka rezultuar në vlerë *14,494,381* lekë.
-*Formati 3/2"Të ardhurat e ushtrimit", në vlerë 457,924,914 lekë,* nga 8,950,242 lekë një vit më parë. Ky format është plotësuar duke përfshirë të ardhurat nga i njëjti nivel qeverisje në vlerë 13,305,559 lekë, dhe nga të ardhura financuar nga buxheti për 737,450 lekë. Pra kuadratura e llogarisë 7206 në këtë format është e barabarte me llogarinë 4342 në aktiv të bilancit dhe si përfundim, pasqyra 3/1 është e barabartë me pasqyrën 3/2 që shoqërojnë llogarinë vjetore të viti 2016.
-*Formati 5"Pasqyra e levizjes "Cash" për vitin 2016",* është plotësuar sipas situacionit faktik të shpenzimeve, ku janë të rregjistruar fondet buxhetore korente dhe kapitale (plani me ndryshimet), pagesat për shpenzime korente dhe kapitale faktike dhe gjendja në fund e autorizimeve buxhetore të papërdorura. Këto shifra për çdo zë janë të konfirmuara dhe të kuadruara nga dega e thesarit Tiranë.
-*Formati nr.6"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qendrueshme (vlera bruto) 2016",* është plotësuarsipas gjendjes dhe lëvizjes së bërë sipas klasave dhe hyrjeve faktike dhe burimeve të financimit dhe është njesoj dhe nuk ka lëvizje nga fillimi i vitit për 27,861,162 lekë.
-*Formati nr.7"Pasqyra e amortizimit vjetor"*, është plotësuar sipas normave sipas legjislacionit. Amortizimi është llogaritur për çdo grup veç e veç sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas normave të paraqitura. Si gjendjet në fillim, hyrjet daljet dhe gjendja në fund të këtyre 2 pasqyrave, janë të barabarta me llogaritë në aktiv të bilancit.
-*Formati nr. 8 "Pasqyra e lëvizjes se fondeve",* është plotësuar si në çelje, ashtu edhe lëvizjet debi e kredive dhe gjendja në fund, është e barabarte me pasivin e bilancit, e kuadruar me fondin në total.
-*Formati nr.9"Numri i punonjësve dhe fondi i pagave*", është plotësuar për gjendjen, lëvizjet dhe gjendjen në fund e numrit të punonjësve nga burimet njerëzore prej 9 punonjes për gjithe vitin 2016, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësur sipas të dhënave nga pasyra e shpenzimeve.
-*Formati nr.10 "Pasqyrë e konsoliduar e gjendjes financiare".*
-*Formati nr.11 "Pasqyrë e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimet e funksionimit".*
-*Formati nr.12 "Pyetsor dhe shënime shpjeguese për hartimin llogarivetë administrimit financiar" është e plotësuar.*
Pasqyra e llogarive vjetore të vitit 2016 ka të bashkëlidhur dhe Pasqyrën e amorizimit analitik të aseteve dhe regjistrin analitik të tyre.

Nga analiza e **debi- kredive** rezultoi se, në këtë institucion ka të evidentuar debitorët dhe kreditorët e krijuar në dhjetor të vitit 2016 e të pa likujduar, si në tabelën e mëposhtme: *Në lekë*

Llogaritë	Emërtimi	Debitore	Kreditore
421	Personeli e llogari të lidhura me to		514,179
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa		55,643
435	Sigurime shoqërore		145,187
436	Sigurime shëndetsore		22,441

4342/1	Të tjera operacione me shtetin debitor-kreditor	737,450	0
	Shuma	**737,450**	**737,450**

Siç vërehet nga tabela e mësipërme, ky institucion ka gjendje debitore e kreditore në vlerë 737,450 lekë, pra janë gjendje vetëm detyrimet për paga e shtesa, tatime e sigurimet e muajit dhjetor 2016 dhe asnjë detyrim tjetër.

c. Mbi organizimim dhe mbajtja e kontabilitetit për vitet 2016 dhe 8/mujorin e vitit 2017 (jashtë fondeve buxhetore të kaluara nëpërmjet thesarit).

Organizimi i dokumentimit të veprimeve kontabël të aktivitetit të administratorëve dhe pronat që kanë ata në administrim nga ana financiare, rakordojnë për shpenzimet dhe të ardhurat analitike me Kordinatorin Financiar të institucionit, i cili i kontrollon dhe regjistron ato në partitarë të veçantë për çdo pronë dhe administrator. Gjithashtu për të ardhurat dhe shpenzimet për këtë aktivitet ky institucion ka të hapur një llogari në bankën e nivelit të dytë Veneto Bank dhe veprimet për të gjitha lëvizjet e saj (të ardhurat dhe shpenzimet) i kontabilizon financierja e institucionit. Në regulloren e brendëshme nuk është përcaktuar qartë se kujt i takon mbajtja, regjistrimi dhe nxjerrja e rezultatit nga ky aktivitet. Në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar citohet: "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar, ose në bartës informatikë. Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese. *Pra regjistrimi behej ne sektorin e administrimit të brendshëm dhe dokumentacioni mbahej nga kordinatori financiar*. Gjithashtu për këtë aktivitet nuk kishte nxjerje të pasqyrave financiare, por vetëm raporte për Komitetin Këshillimor Ndëristitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar për të ardhurat e shpenzimet dhe problematikat e hasura.

c/1. Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve e vlerave materiale, inventarizimi i tyre, dokumentimi i veprimeve ekonomike dhe regjistrimet në kontabilitet (jashtë fondeve të miratuara të buxhetit). Pra rregjistrimi në kontabilitet i veprimeve të lëvizjes së aseteve, aktiveve qarkulluese dhe cashit mbahet me formatin e ditarëve dhe librave të kontabilitetit në ekxsel, në ditarët e veprimeve me bankën për të ardhurat, kontabilizimit të veprimeve me bankën për shpenzimet dhe në ditarin e hyrje daljeve të magazinës. dhe ditarin e veprimeve të ndryshme. Nga auditimi i regjistrimit të veprimeve për vitin **2016 dhe 8/ mujorin e vitit 2017** rezultoi:

a.Rregjistrimi i ditarit të **hyrje daljeve** të magazinës:

Për vitin 2016, në ditarie magazinës janë regjistruar 4 hyrje gjithsej në vlerë 759,305 lekë, nga të cilat 2 hyrje karburanti për 3970 litra në vlerë 590,985 lekë dhe 2 hyrje kancelarie në vlerë 168,320 lekë, të gjitha në debi të llogarisë 31 "materiale" dhe kredi të llogarisë 63 "ndryshimi i gjendjes".

Ditari i daljeve të magazinës për këtë vit është e përbërë nga 130 dalje gjithsej në vlerë 640,288 lekë nga të cilat 121 dalje karburanti, në vlerë 590,985 lekë dhe 9 dalje kancelarie në vlerë 49,300 lekë.

Për 8/ mujorin e vitit 2017, në ditari i hyrjeve të magazinës janë regjistruar 2 hyrje në vlerë 803,220 lekë, një hyrje karburanti për 4500 litra në vlerë 688,500 lekë dhe një hyrje kancelarie

në vlerë 114,720 lekë të gjitha në debi të llogarisë 31 "materiale" dhe kredi të llogarisë 63 "ndryshimi i gjendjes".
Ditari i daljeve të magazinës për këtë periudhë është regjistruar për 117 dalje në vlerë 707,322 lekë, i përbërë nga 109 dalje karburanti, në vlerë 595,590 lekë dhe 8 dalje kancelarie, në vlerë 112,732 lekë.
Fletë hyrjet kishin të bashkëlidhur faturën e shitësit dhe aktin e marjes në dorrëzim të mallit. Fletë daljet kishin të bashkëlidhur kërkesën e administratoreve, autorizimin e përgjegjsit të Sektorit administrativ, të miratuar nga administratori i Agjencisë, për furnizimin me materiale, kancelari apo me karburant.
b. Regjistrimi i **shpenzimeve** në administrim të objekteve në ruajtje e administrim të administratorëve janë kryesisht shpenzime page, sigurimi shoqëror, shpenzime për rojet dhe shpenzime të tjera, të barabarta me daljen e llogarisë së periudhes së caktuar.
Për vitin 2016 shpenzimet e kryera e të regjistruara në ditar janë **17,914,755 lekë** të ndara :
-Paga e shtesa për administratorët e ndihmësit e tyre për 7,002,935 lekë, ose 39.1% të totalit;
-Sigurime shoqërore për për administratorët e ndihmësit e tyre për 2,766,911 lekë, ose 15.4% të totalit;
-Shpenzime sigurimi objektesh për 6,397,682 lekë, ose 35.7% të totalit;
-Shpenzime të tjera (drita, ujë, karburant, kancelari, etj.) për 1,747,227 lekë, ose 9.8 % të totalit.
Për 8/mujorin e vitit 2017 shpenzimet e kryera e të regjistruara në ditar janë **29,429,872 lekë** të ndara:
-Paga e shtesa për 5,031,054 lekë, ose 17.1% të totalit;
-Sigurime Shoqërore për 2,388,574 lekë, ose 8.1% të totalit;
-Tatimi në burim për 99,450 lekë, ose 0.3% të totalit;
-Shpenzime sigurimi objektesh për për 17,675,565 lekë, ose 60.1% të totalit;
-Shpenzime për vendime gjyqësore për 2,847,820 lekë, ose 9.7% të totalit
-Shpenzime të tjera (drita, ujë, karburant, kancelari, etj.) për 1,387,409 lekë, ose 4.7% të totalit.
c.Regjistrimi i të **ardhurave** nga aktiviteti i institucionit. Të ardhurat nga aktiviteti i institucionit janë në funksion të shpenzimeve që kryhen për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e objekteve të sekuestruara dhe konfiskuara. Të ardhurat e derdhura për llogari të këtij institucioni realizohen kryesisht nga qeratë e objekteve të konfiskuara dhe derdhje në llogari me urdhër të ministrit të Financave, të cilat funksionojnë në një llogari të Veneto Bank dhe regjistrohet nga Specialistja e financës. Gjithashtu të ardhura realizohen nga interesat e depozitave të sekuestruara dhe konfiskuara e që regjistrohen nga sejcili administrator dhe kuadrojnë çdo muaj me kordinatorin financiar të subjektit. Më analitikisht të ardhurat e realizuara janë:
-Qeratë e objekteve të konfiskuara për periudhen 01.01.2016 deri më 31.08.2017, në vlerë **5,373,925 lekë,** janë të **r**regjistruara në ditarin e të ardhurave nga specialistja e Financës me striocon e nxjerjes së llogarisë çdo muaj dhe për çdo derdhje të bërë në këtë llogari nga personat e subjektet që kanë objektett me qera. Rakordimin analitik me rakordimin mujor me financieren e bën kordinatori financiar i këtij subjekti.
Për vitin 2016 janë regjistruar në ditar cdo muaj për 11 objekte qeraje, vlera prej 1,304,455 lekë;
Për 8/mujorin e vitit 2017 janë regjistruar në ditar cdo muaj për 25 objekte qeraje vlera prej 5,069,470 lekë.
-Derdhje në llogari me urdhër të ministrit të Financave për vitin 2017, në vlerë **44,999,968.20 lekë,** me urdhërin e ministrit të financave nr.25, datë 21.03.2017 "Mënyrën e përdorimit të pasurive vlera monetare të konfiskuara", pika 2 kalimin e fondit prej 45 milion lekë në llogarinë e AAPSK, për të mbulimin e shpenzime të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, protokolluare në këtë subjekt me nr.332, datë 21.03.2017, (shoqëruar me tabelën e llogarive bankare të konfiskuara me vendim të formës sëv prerë).

AAPSK me shkresën nr.369, datë 05.04.2017, i është drejtuar V Bank "Kërkesë për transferim fondesh", kërkojnë transferimin e vlerës prej 332,594 euro, të ndodhura në depozitë në emër të agjencisë, në llogarinë e AAPSK.

Të përmbledhura dhe analitike të ardhurat nga qeratë për vitet 2015, 2016 dhe për 8/mujorin e vitit 2017 nga aktiviteti i AAPSK dhe shpenzimet e përmbledhura për këtë periudhë, janë si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

	Emërtimi	Gjendja e llog. 01.01.15	2015		2016		8/mujori 2017	
			të ardhurat	shpenzimet	të ardhurat	shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet
1	.....		36,000		0		0	
2	.....		112,000		90,000		0	
3	.....		134,400		144,000		96,000	
4	.....		76,000		210,000		90,000	
5	.....		61,300		100,000		0	
6	.....		120,000		0		0	
7	.....		34,000		48,000		24,000	
8	.....		0		175,000		210,000	
9	.....		0		85,255		119,000	
10	.....		0		30,000		80,000	
11	.....		0		30,000		50,000	
12	.....		0		22,200		81,600	
13	.....		0		370,000		1,850,000	
14	.....		0		0		30,000	
15	.....		0		0		57,740	
16	.....		0		0		70,400	
17	.....		0		0		84,800	
18	.....		0		0		100,000	
19	.....		0		0		60,000	
20	.....		0		0		800,000	
21	.....		0		0		32,000	
22	.....		0		0		20,000	
23	.....		0		0		10,000	
24	.....		0		0		30,000	
25	.....		0		0		24,000	
26	.....		0		0		24,000	
27	.....		0		0		49,300	
28	.....		0		0		336,600	
29	.....		0		0		740,000	
I	**Shuma nga qeratë**		**573,700**		**1,304,455**		**5,069,440**	
II	**Të derdhura në llogari**		**40,000,000**				**44,999,968**	
III	**gjendja nga viti mëpars**		**8,299,188**		**39,175,593**		**22,565,293**	
A	**Shuma e hyrjeve**		**48,872,888**		**40,480,048**		**72,634,701**	
B	**Shuma e shpenzimeve**			**9,697,295**		**17,914,755**		**29,429,872**
Gjendja llog në fund të vitit (A-B)		**8,299,188**	**39,175,593**		**22,565,293**		**43,204,829**	

Shënim: Tabela e përpunuar nga grupin i kontrollit me të dhënat e subjektit.

Pjesë e të ardhurave nga ky aktivitet, por jashtë llogarisë të të ardhurave dhe shpenzimeve janë dhe "Depozitat dhe Interesat e depozitave të sekuestruara dhe konfiskuara", të cilat janë të ardhura që kapitalizohen me urdhër të ministrit të financave dhe mbas vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Interesat e këtyre depozitave rikapitalizohen në kapitalin themeltar të depozitës dhe janë në administrim të administratorëve përkatës, të cilët i pasqyrojnë në kartela përkatëse për çdo depozitë dhe kuadrojnë si për çdo pasuri me kordinatorin financiar.

Specialistja e financës disponon të dhëna vetëm për llogarinë likujduese të Veneto Bank, llogari e cila përdoret për të paguar shpenzimet që duhen për administrimin e pasurive dhe për derdhur të ardhurat e realizuara nga objektet e dhëna me qera, apo nga derdhjet në këtë llogari me urdhër të Ministrit të Financave.

c/2. Inventarizimi i aktiveve dhe nxjerrja e bilancit kontabël për vitin 2016.

Nuk është kryer inventarizimi i aseteve të këtij aktiviteti, si në magazinë (Llogaria 311 "Materiale dhe 327 "objekte inventari"), ashtu edhe i aseteve të trupëzuara që ka në administrim.

Edhe pasqyrat financiare për këtë aktivitet nuk janë nxjerrë për vitin 2016, por nuk ka pasur përvojë të tillë dhe vitet e mëparshme.

Në oservacionin e ardhur nga subjekti citohet: "*Sa i përket rekomandimit nr. 1.4 (faqe 71), mbi administrimin e Fondit të posaçëm (Art. 604 "Transferta të brendshme", Ju sqarojmë se ndarja e këtij fondi sipas institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile përfituese, behet nga Ministri i Financave. Disbursimi i shumave përkatëse si dhe monitorimi i zbatimit të projekteve të financuar nga këto fonde, kryhet nga strukturat e AAPSK-se. Konkretisht, monitorimi kryhet nga një Grup pune i cili drejtohet nga Koordinatori i Terrenit, ndërsa pagesat në degën e Thesarit kryhen nga sektori Administrativ me ane të Urdhër Shpenzimeve të firmosura rregullisht nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues bazuar në dokumentacionin justifikues të dosjeve.*

Pagesat nga dega e thesarit nuk kalohen pa paraqitur dokumentacionin shoqërues, i cili pasi vuloset nga specialistja e degës së thesarit, rikthehet në dosjen projektit deri në përfundimin e plote të tij. Theksojmë se, projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm kanë një shtrirje kohore 6 deri në 12 muaj dhe pagesat kryhen të pjesshme, sipas fazave të zbatimi të projektit. Me realizimin e plote të projektit dhe disbursimin total të shumës së akorduar, dosja kalon në sektorin e financës.

Në lidhje me rekomandimin nr. 1.5 (faqe 73) mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, na duhet t'Ju sqarojmë se mbajtja e kontabilitetit dhe nxjerrja e bilancit nga ana jonë është kryer në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 27, dt. 23.9.2008, të Ministrit të Financave, Kreu IV[2]*. Por, sa i përket propozimit tuaj për të përcaktuar mënyrën për mbajtjen e kontabiliteti dhe nxjerrjen e bilancit për aktivitetin e administrimit të pasurive, nga ana jonë do të kërkohet mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë".* Të gjitha shpjegimet e mësipërme nuk justifikojnë mos kontabilizimin në mënyrë analitike dhe mbajtjen e dokumentacionit bazë dhe orgjinal aty ku janë kontabilizuar.

2. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti për periudhen 01.01.2016 deri 31.08.2017.

a. Përputhshmëria në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të shpenzimeve korente me fondet e thesarit.

Gjatë periudhës së auditimit me fondet buxhetore nuk është bërë asnjë procedurë tenderimi, por të gjitha shpenzimet janë kryer me procedurën e "blerjeve të vogla" për shpenzimet korente, sepse nuk janë realizuar fonde për investime këtë periudhë.

[2] 4. Agjencia mban në bilancin e saj shifrat e miratuara në planin e buxhetit të miratuar nga Ministri i Financave.
6. Të ardhurat dhe shpenzimet për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara evidentohen dhe mbahen jashtë bilancit të Agjencisë dhe raportohen sipas planit të raportimit të miratuar në planin vjetor të punës dhe buxhetit.
7. Vlerat monetare të sekuestruara/konfiskuara *cash* ose në numra llogarie të subjekteve do të mbahen dhe evidentohen jashtë bilancit të Agjencisë.

Kështu për vitin **2016,** shpenzimet korrente **(602)** janë planifikuar në projekt buxhet, në regjistrin e prokurimit dhe janë realizuar me zëra si në tabelën e mëposhtme: *Në lekë*

Nr.	Objekti i prokurimit	Projekt buxheti (1)	Vlera me tvsh regjistri i prokur(2)	Dif. regjister proj buxhet	Realizimi faktik (3)	Dif. realizim proj buxhet 3-1
1	Blerje kancelari& tonera	480,000	975,000	495,000	526,180	46,180
2	Ruajtje fizike e zyrave		100,000	100,000	106,320	106,320
3	Blerje karburant	740,000	625,000	-115,000	552,000	-188,000
4	Të tjera materiale	10,000				-10,000
5	Riparim automjeti	50,000	375,000	325,000	294,480	244,480
6	Inst. e riparime të ndryshme		37,500	37,500	36,000	36,000
7	Shërbime interneti		100,000	100,000	92,900	92,900
8	Blerje materiale pastrimi	60,000	75,000	15,000	55,722	-4,278
10	shpenzime për ujë	60,000			50,460	-9,540
11	" energji	500,000			212,542	-287,458
12	" telefonike	350,000			57,303	-292,697
13	Shpenzime postare	50,000			43,632	-6,368
14	Dieta brenda vendit	100,000			6,000	-94,000
15	Dieta jashtë vendit	200,000				-200,000
16	Sigurim automjetesh	20,000			249,932	229,932
17	vendime gjyqësore	1,300,000			2,707,841	1,407,841
18	Shërbim për ngroje	150,000				-150,000
19	Blerje pjesë këmbimi ,goma	400,000				-400,000
20	Shpenz. mirëmb ndërtimore	130,000				-130,000
21	Mirëmb paisje zyrash	400,000				-400,000
	shuma	**5,000,000**	**2,287,500**	**957,500**	**4,991,312**	**-8,688**

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

Nga auditimi i detajimit të projekt buxhetit dhe regjistrit të prokurimeve për zërat e shpenzimeve operative në vitin 2016, konstatojmë:

Nuk **janë futur në regjistrin** e prokurimeve blerje e shërbime si:

-Shpenzime për ngrohje në vlerë 150 mijë lekë, një zë me vlerë të tillë që nuk ka pse të planifikohet;

-Mirëmbajtje paisje zyrash në vlerë 400 mijë lekë, apo blerje goma e pjesë këmbimi në vlerë 400 mijë lekë etj.

Kanë **diferenca** të konsiderueshme regjistri me projekt buxhetin si:

-Riparim automjeti, planifikuar për 50 mijë lekë në projekt buxhet dhe në regjister është për 375 mijë lekë, apo 7.5 herë më shumë;

-Blerje kancelari dhe tonera, planifikuar për 480 mijë lekë dhe hedhur në regjistrin e prokurimit për 975 mijë lekë, apo mbi 2 herë më shumë, etj.

Megjithese realizimi i 602 në krahasim me projekt buxhetin dhe aprovimin e tij është në masën 100%, **ka ndryshime të mëdha** midis realizimit, apo tejkalimit të zërave që e përbëjnë atë:

-Nuk janë realizuar fare disa zëra të programuar si në vlerë 1,300 mijë lekë, dieta jashtë vendit në vlerë 200 mijë lekë, shërbime ngrohje në vlerë 150 mijë lekë, bleje pjesë këmbimi e goma në vlerë 400 mijë lekë, shërbime për mirëmbajtje ndërtimore në vlerë 130 mijë lekë, apo mirëmajtje zyrash në vlerë 400 mijë lekë;

-Janë realizuar disa zëra të pa programuar si: ruajtje fizike e zyrave në vlerë 1065 mijë lekë, instalime e riparime të ndryshme në vlerë 36 mijë lekë dhe shërbime interneti 93 mijë lekë.

-Ka ndryshime të mëdha vlerash midis realizimit dhe programimit si Riparim automjeti realizuar më shumë për 244 mijë më shumë, apo 5 herë më shumë se programimi, sigurim automjetesh realizuar më shumë për 230 mijë më shumë, apo 12.5 herë më shumë se programimie tj. Po ashtu si ka zëra që janë realizuar shumë më pak nga programimi si blerje karburanti me një urdhër shpenzimi nr.15, datë 16.02.2016, në vlerë 552,000 lekë, energji, telefona, dieta brenda vendit dhe V**endime gjyqësore,** realizuar në vlerë **2,708 mijë lekë, ose sa 54% e të gjithë 602,** është programuar në vlerë 1,300 mijë lekë, pra është realizuar më

shumë se dyfishin e vlerës së programuar. Në udhëzimin standart të zbatimit të buxhetit citohet: *Ministrisë së Financave çdo vit i planifikohet një fond i caktuar për zbatim të vendimeve gjyqësore që lidhen me detyrimet të buxhetit të shtetit. Ky fond përdoret rast pas rasti nga struktura përkatëse e Ministrisë së Financave me miratim të Nëpunësit të Parë Autorizues".* Ky institucion i ka përdorur për 4 vendime gjyqësore të formës së prerë me urdhër shpenzimet e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i përfituesit	Nr.datë urdhër shpenzimit	Vlera në lekë
a.		76, datë 24.06.16=814,370	
b.		157, datë 30.12.16=550,000	
1	**A.B (a+b)**		**1,364,370**
a.		88, datë 22.07.16=297,775	
b.		115, datë 05.10.16=304,266	
2	**A.H. (a+b)**		**602,041**
3	**Xh.Ç.**	116, datë 12.10.16	**601,030**
4	**S.H.**	136, datë 15.11.16	**140,400**
	Shuma		**2,707,841**

Shënim:Tabela e plotësuar nga grupi i auditimit me të dhënat e institucionit.

Të gjitha sa thamë më lart, programimi i zërave të buxhetit bëhet formal dhe i pa studjuar nga struktura menaxhuese e këtij institucioni.

Në oservacionin e ardhur nga subjekti citohet: *"Planifikimi për shpenzimet buxhetore (llog. 600, 601, 602) ka qenë i bazuar në strukturën organike të miratuar si dhe në nevojat për shpenzime të kushtëzuara nga vendndodhja e zyrave të AAPSK-së (në qendrën e biznesit "Tëin Toërs", bul. Dëshmorët e Kombit), për rrjedhoje disa shpenzime si: Ngrohja e zyrave; Mirëmbajtja e ambienteve te përbashkëta, etj. ishin të paracaktuara nga bordi i bashkëpronarëve te qendrës së biznesit dhe nuk mund të prokuroheshin. Shërbimi i Internetit furnizohej nga Ministria e Financave pa pagese. Shërbimi i ruajtjes së zyrave i përfshirë në çmimin e mirëmbajtjes. Me ndryshimin e ambienteve të zyrave të AAPSK-së, në adresën aktuale, shpenzimet e ngrohjes dhe mirëmbajtjes nuk ishin më të nevojshme, por nevojiteshin ato për ruajtjen e zyrave si dhe shërbimin e internetit.*

Mos plotësimi i vendeve vakante në strukturën e miratuar, nga ana e Departamentit të Administratës Publike gjate vitit 2016, ka sjellë në mosrealizimin faktik të zërave të planifikuar për Paga dhe Sigurime shoqërore (600, 601).

Sa i përket tejkalimit të shpenzimeve gjyqësore në vitin 2016, sqarojmë se kjo ka ardhur si pasojë e bllokimit të vendimeve nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit përgjatë gjithë vitit 2015, duke rezultuar në pagesën gjatë vitit 2016 edhe të atyre vendimeve gjyqësore, të cilat ishin planifikuar për tu paguar për vitin 2015. Sa më lart, jemi të mendimit se nga ana jone programimi i zërave të buxhetit është bërë ***real*** *(jo formal), por ndryshimi i rrethanave objektive (të sqaruara më sipër), ka sjellë edhe ndryshmet në zbatimin faktik të programit buxhetor, të pasqyruar në gjetjet e grupit te auditimit. Sidoqoftë, rekomandimi do të mbahet në vëmendje për planifikimin e periudhave të ardhshme".* Megjithë sqarimin e mësipërm në shumë zera të buxhetit nuk kishte analiza per sasitë e planifikuara të tyre, kështu që planifikimi i tyre duhet të fillojë nga srrukturat bazë e për shpenzime të domosdoshme, brenda kufirit të përcaktuar nga Ministria e Financës.

b. Përputhshmëria ligjore në realizimin e prokurimit të fondeve nga llogaria e Autoritetit për periudhen 01.01.2016 deri 31.08.2017.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vazhdim AK), AASPK, për vitin **2016** janë kryer 8 procedura prokurimi, me vlerë 1 636 042 lekë me tvsh, nga të cilat te gjitha Blerje me vlere te vogel. Nuk ka kerkesa nga Agjencia të tenderuara nga Ministria e Brendshme.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2016 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2016 AAPSK
Prokurime gjithsej	8
Vlera totale (me TVSH)	1 636 042
Procedura të hapura	0
Procedura kërkesë për propozim	0
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	57
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	49
Vlera e ofertave të fituara	1363368
Diferenca nga fondi limit	212 600
% e diferencës nga fondi limit	14.5

Të dhënat: AASPK

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2016 Administratoret
Prokurime gjithsej	14
Vlera totale (me TVSH)	28 397 372
Procedura të hapura	1
Procedura kërkesë për propozim	0
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	51
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	36
Vlera e ofertave të fituara	23 664 477
Diferenca nga fondi limit	7 387 677
% e diferencës nga fondi limit	24

Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit të kryera nga ky AK, u ushtrua bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik si dhe në aktet ligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, si dhe sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit nr. 999/1 datë 06.10.2017, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së.

- *Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar.*
- *Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime.*
- *Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës.*
- *Auditimi mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.*

Mbi hartimin e nevojave, hartimi dhe dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike:

a. Përllogaritja e nevojave:

MF me shkresën nr. 17761/13, datë 29.12.2015 "Miratim i detajimit të fondeve për vitin 2016" ka dërguar planin e buxhetit për Agjencinë, të cilat në total janë:

- Shpenzime korente në shumën **15.000** mijë lekë
- Shpenzime kapitale në shumën **1.500** mijë lekë

Planifikimi i nevojave është kryer mbështetur në realizimin e 8-mujorit 2015 dhe kërkesat e bëra nga adminiostratorët.

Kjo agjenci disponon dhe përdor fonde nëpërmjet llogarisë nr. 47378. Nëpërmjet këtyre fondeve kryhen proceduara prokurimi për plotësimin e nevojave të kërkuara nga Administratorët për pasuritë që ata kanë në administrim.

b. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike.

Nga ana e AK, me shkresën nr. 75 prot, dt. 01.02.2016 është dërguar në APP, brenda afateve ligjore (30 janar), të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

Ndryshimet gjatë vitit në regjistrin e parashikimeve publike janë kryer me shkresat përkatëse si më poshtë:
Regjistri mbi realizimin e prokurimeve publike është dërguar në APP me shkresën nr. 104 datë 19.01.2017, brenda afatit të përcaktuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Kreu I, neni 7, pika 2.
Por AK nuk ka hartuar rregjistra për fondet që përdor nga llogaria nr. 47378 nga e cila kryhen shpenzimet për pasuritë që administron,pavarsisht se këto prpcedura kryhen nëpërmjët prokurimit elektronik, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" Kreu I, neni 7, pika 4. *Autoriteti kontraktor, për fondet e krijuara apo të shtuara, harton regjistra shtesë dhe ia dërgon APP-së, Drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit në Ministrinë e Financave, ose institucionit qendror, në rast se ka një të tillë. Autoriteti kontraktor ose institucioni qendror njofton APP-në dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Thesarit në Ministrinë e Financave për të reflektuar ndryshimet në regjistrat përkatës.* Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve publikohen në faqen elektronike të APP-së.
Tabela-Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.

	Emërtimi	Regjistri i parashiki pa tvsh	Regjistri i realizimit me tvsh
I	Sipas procedurave		
1	Procedura të kryera	8	8
2	Shtesa kontratash	0	
3	Blerje të vogla	1 830 000	1 636 042
4	Procedura të kryera (MB)	0	
	Totali	1 830 000	1 636 042
II	Sipas zërave të shpenzimeve		
5	Shpenzime operative	1 830 000	1 636 042
6	Shpenzime kapitale	1.500.000	0
7	**Totali**		

Të dhënat: AASPK

Gjatë vitit 2016, Agjencia ka realizuar kontratat shtesë si më poshtë:

Kontrata shtesë të realizuara gjatë vitit 2016

Nr	Objekti prokurimit	Lloji procedurës	Vlera e kontratës 2015	Shtesa e kontratës 2016	OE fitues	Kontrata
1	0	0	**0**	**0**	0	0
	Totali					

Të dhënat: AASPK

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt kontrolli **viti 2017** rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2017 AAPSK
Prokurime gjithsej	6
Vlera totale	1 138 896
Procedura të hapura	0
Procedura kërkesë për propozim	0
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	43
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	37
Vlera e ofertave të fituara	949 080
Diferenca nga fondi limit	465 270
% e diferencës nga fondi limit	33

Të dhënat: AASPK

Të dhëna mbi procedurën e prokurimit	Viti 2017 Administratoret
Prokurime gjithsej	13
Vlera totale	1 076 713
Procedura të hapura	0
Procedura kërkesë për propozim	0
Negocim	0
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë	42
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë	29
Vlera e ofertave të fituara	992 660

Diferenca nga fondi limit	95 399
% e diferencës nga fondi limit	10

Të dhënat: AASPK

Prokurimet e zhvilluara nga AASPK janë kryesisht të formës "Procedura me blerje të vogël nën limit prej 1 milion lekë. Pergjithsisht nuk u konstatuan shkleje të procedurave, por duhet të theksojmë se për të gjitha dosjet e procedurave të zhvilluara mungonte arkivimi i tyre sipas procedurave të parashikuara si në Ligjin per Prokurimin Publik ashtu dhe në ligjin për Arkivat dhe ruajtjen e dokumentacionit .

3. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe konrollit, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar me ligjin nr.110, datë 15.10.2015.

Auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u realizua në mbështetje të:

1.Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ndryshuar me ligjin nr.110, datë 15.10.2015.

Në bazë të këtij ligji do të bëhet vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Agjensinë Kombëtare Shoqërisë së Informacionit (AAPSK). Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

-Në nenin 4 të ligjit, pika 9 *"Përgjegjshmëria menaxheriale"* cilësohet: "Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera.

-Në nenin 8*"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit"*, pika 4 citohet: Në rast moscaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, i takojnë titullarit të njësisë publike.

-Në nenin 10, pika 1, citohet: *Koordinator risku* është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, ai mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e riskut një menaxheri tjetër të njësisë publike, në varësi të drejtpërdrejtë prej tij.

Në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.8980, datë 15.07.2010, në mështetje të ligjit, neni 8, pika 8, është përcaktuar:

Titullari i njësisë, ose Nëpunësi Autorizues (edhe sipas nenit 8 të ligjit"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 4), mban përgjegjësi për monitorimin dhe vlerësimin në kohën e duhur të sistemit të MFK-së, në përputhje me dispozitat ligjore për të. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për: Hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Në funksion të menaxhimit të riskut, titullaret miratojnë një strategji, e cila duhet rishikuar çdo tre vjet, ose sa herë që mjedisi i kontrollit pëson ndryshime të rëndësishme; Ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik të njësisë publike; Miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit që garantojnë qarkullimin efiçent të informacionit përgjatë gjithë strukturës së njësisë publike dhe shkëmbimin efektiv të informacionit me institucionet e jashtme; Miratimin e sistemit të rregullave e të proçedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave; Miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre; Rrregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe

garantimin e pavarësisë funksionale të tij; Futjen e proçedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi, e cila përfshin proçedurën e regjistrimit dhe raportimit tek strukturat kompetente mbi masat që janë marrë për parandalimin e mashtrimeve dhe të parregullsive; Sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm; Miratimin e aktiviteteve të kontrollit, duke përfshirë dhe proçedura të *politikave të shkruara*, të cilat garantojnë në një masë të arsyeshme, se risqet që janë identifikuar gjatë proçesit të menaxhimit të riskut, janë pakësuar në një nivel të pranueshëm; Miratimin e proçedurave dhe mënyrës për ushtrimin e kontrolleve ex-ante dhe ex-post në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave; Ngritjen dhe zbatimin e një sistemi për monitorimin e MFK-së, me qëllim vlerësimin e funksionimit të tij në mënyrën e duhur, si dhe rifreskimin e tij në kohën e duhur kur ndryshojnë rrethanat.
Koordinatori i Riskut, kryen aktivitetet e mëposhtme: Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij; Këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në bashkëpunim me njësinë qendrore të harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek titullari i njësisë publike dhe grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike.
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) **është krijuar** me VKM nr.687, datë 05.10.2011 "Për organizimin, kopetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara"
Objekti i veprimtarisë së AAPSK-t është:
1. Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafiqeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".
2. Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
3. Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit të Financave.
-Për periudhën e audituar, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 -"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 4, germa "a" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli IV "Zbatimi i MFK", pika, 4.2.10 "Roli i nëpunësit të njësisë", gërma a, ky institucion ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi i parë autorizues i njësisë publike planin strategjik, i cili përmban objektivat strategjikë, prioritetitet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë së tij.
-Gjithashtu, ky institucion ka hartuar një rregullore për funksionimin e tij dhe me Urdhrin e brendshëm nr.192, datë 25.01.2011 të Kryeadministratorit është miratuar rregullorja "Për administrimin e dokumentacionit zyrtar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", e cila është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 14.02.2011 rregullorja "Për organizimin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", në të cilën janë përcaktuar dispozitat e përgjithshme, strukturat dhe funksionet e Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe rregullat proceduriale për funksionimin e tij.
-Për vitet 2016-2017, institucioni në bazë të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ka hartuar projektbuxhet e këtyre viteve, **por**

duke mos marrë në konsideratë si duhet risqet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave. Një kopje e projekt buxhetit të këtij viti, i është dërguar Ministrisë së Financës.
-AAPSK nuk ka dërguar me shkresë "Përcjellim pyetsorin e plotësuar të vetvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2016", drejtuar Njësisë Qëndrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financës, Raportin për funksionimin e e sistemeve të kontrollit të brendshëm për vitin 2016;
Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për vitin 2016, nënshkruar nga kryeadministratori, në bazë të përgjegjësive të shprehura në kreun III, pika 3.3 e Manualit dhe në nenin 18 të ligjit, ku përcaktohet se: "Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues, një deklaratë dhe raportin përkatës, për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual".
-Për vitin 2016, janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Rrisqeve**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr.10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2011. Ndërsa për vitin 2016 ky regjistër nuk është krijuar.
-Mos hartimi i **Strategjisë për Menaxhimin e Rrisqeve**, detyrim sipas nenit 8/a, 10, 11 dhe 21, të këtij ligji, i cili në mënyrë të detajuar, përcakton përgjegjshmërinë e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, si të titullarit të institucionit, i cili ka këto kompetenca për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji. Pra si rrjedhojë dhe në kundërshtim me nenin 21, pika 2: "Menaxhimi i riskut": ku citohet: "Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit", nuk ka një strategji të riskut dhe për rjedhojë, as është përditësuar ajo.
Në kreun III "Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit", neni 19, citohet: "Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit, është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve. Komponentët e mjedisit të kontrollit janë realizuar si më poshtë:
a.Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.
Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e këtij institucioni është miratuar **kodi etikës** së Agjencisë më 01.06.2011, ku

përcaktohen normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjelltë midis tyre.

b.Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

AAPSK funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Kryeministri ″Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së AAPSK" dhe Rregullores së Brendshme e miratuar me Urdhër. Struktura dhe organika e miratuar me 8 punonjës plus një punonjës me kontratë provizore**.** AAPSK ka bërë ndarjen e detyrave funksionale, hierarkinë dhe rregullat përkatëse për të drejtat, përgjegjësitë, shmangien e konfliktit, linjat e raportimit, por në disa raste nuk del e qartë se kush do të regjistrojë veprimet me bankat për të ardhurat e realizuara nga sekuestrimet e qeratë e ndryshme, apo shpenzimet për to në mënyrë kronologjike.

Njësia ka një program buxhetor me qëllim përdorimin me eficent dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit. Nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësive, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithashtu në funksionet e tij, Përgjegjësi Sektorit të Financës duhet të mbulojë funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

c.Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e AAPSKT i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin me Kodin e Punës deri në shkurt të vitit 2017, me ndryshimin me VKM nr. 83, datë 08.02.2017 "Për disa ndryshime në VKM nr.687, datë 05.10.2011 "Për organizimin, kopetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara".

Në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, ligjit për statusin e nëpunësit civil, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj., Titullari i i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore, apo të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, por në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", si dhe Kapitulli III "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, **njësia ka disa pasaktësi** në përcaktimin e rregullave të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Pra strukturat dhe procedurat e brendshme nuk garantojnë plotësisht që të gjithë punonjësit të mbikëqyren në kryrjen e detyrave të tyre nga drejtuesi.

d.Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj., por përshkrimet e punës nuk i nënshtrohen verifikimeve apo, rishikimeve periodike të kryera nga eprorët e linjës, si dhe është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, por nuk i është bashkëlidhur dosjes së gjithsejcilit punonjës.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2016-2017, në Agjensi janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, vetëm një herë. Ky institucion nuk ka program specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 "Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë", paragrafet "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njërezore" dhe "Profesionalizmi i stafit".

2. Menaxhimi i riskut.
Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 "Menaxhimi i Riskut", ky institucion ka përcaktuar menaxherin e riskut dhe ka miratuar regjistrin e riskut, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve, të cilat venë në rrezik arritjen e objektivave dhe për pasojë, drejtuesit janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Megjithatë në raportin dhe pyetsorin e dorrëzuar në Ministrinë e Financës ky institucion është përgjigjur: "AAPSK ka analizuar situatën e përgjithshme dhe vlerësuar riskun në plotësimin e aktiviteteve të ndryshme të saj. Risqet nuk janë kategorizuar në të brendshme dhe të jashtme:

3. Aktivitetet e kontrollit.
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Ky institucion, ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e standardeve në këtë fushë. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave, për çdo transaksion zbatohej gjithmonë rregulli i firmës së dyfishtë.
Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së, ku kompjuterët janë të lidhur me serverin në brendësi të tij. Kontrolli i sistemit realizohet kryesisht për të siguruar mirëfunksionimin e këtyre elementeve kryesor dhe të gjithë elementeve të tjerë që lidhem me to. Për regjistrimin dhe sigurimin e të dhënave kontabël, njësia nuk ka instaluar program kontabiliteti.

4.Informim komunikimi.
Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryrjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive. Menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe se, institucioni nuk ka kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit.
Titullari dhe nëpunësi autorizues informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryeshme. Sektori i Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, por nuk hartoken raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtëpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme. Punonjësit brenda instiucionit komunikojnë me shkrim dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet

kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.
Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë instutucion, pasi nuk lihen gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të saj. Agjensia ka faqen e saj zyrtare dhe nëpërmjet këtij ëebsite të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të AAPSK-^{së}, ky institucion nuk është audituar asnjëherë më parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

5. Monitorimi.
Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Në këtë institucion (AAPSK), Titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e mesëm dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve, informacioneve apo, raporteve të ndryshme. Agjensia nuk ka strukurë të Auditimit të Brendshëm.
Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke moskryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, megjithse në Rregulloren e AAPSK-^{së} janë përcaktuar edhe rregullat dhe përgjegjësitë për strukturat e ndryshme. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune.
AAPSK në raportin e vet për këtë qëllim ka cituar se në Rregulloren e AAPSK-^{së} janë përcaktuar edhe rregullat dhe përgjegjësitë për strukturat e ndryshme. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm te aktivitetit për çdo proces e pozicion pune. Pra nga auditimi rezultoi:
-Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-^{së} nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.
-Për vitin 2016-2017, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të AAPSK-^{së}, por nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.
*- Megjithëse janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave, nuk ka miratim nga Ministria e Financës dhe arkivim të kësaj gjurme.*
*- Për vitin 2016 është hartuar rregjistri i riskut, dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i është ngarkuar kryeadministratorit, por pa e përditësuar në vazhdimësi. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III "Identifikimi i risqeve" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.*
*-Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, është hartuar **Kodin e Etikës**, dhe janë përcaktuar mirë ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve.*

Në oservacionin e ardhur nga subjekti citohet: *"Sa i përket rekomandimit nr. 2, në piken 3 citohet : "Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore..." ju sqarojmë se nga ana jonë është hartuar gjurma e auditimit dhe se bashku me projekt urdhrin për miratimin e saj i është dërguar Ministrit të Financave me shkresën nr. 849 prot, dt. 14.10.2016. (bashkëlidhur kopje). Deri në momentin aktual nuk kemi një përgjigje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Sa i përket hartimit të regjistrit të Risqeve për vitin 2017 jemi dakord dhe do të realizohet menjëherë".*Këtë obsevacion e morëm parasysh.

Konkluzion:
Nga auditimi i ushtruar në AAPSK gjatë periudhës së auditimit për vitin 2016-30.09.2017, konstatohet se reforma ligjore ka ndikuar pozitivisht në miradministrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara duke miratuar një sërë aktesh nënligjore të cilët kanë parashikuar mënyrat e përdorimit të këtyre pasurive duke mundësuar një kuadër ligjor të plotë dhe dhe në përputhje me Konventat ndërkombëtare si dhe në harmonizim me legjislacionin e brendshëm. Por pavarësisht nga panorama ligjore e cila është e plotë, nga statistikat e AAPSK-së rezulton se ka pasuri të cilat nuk janë dhënë në asnjë nga mënyrat e parashikuara nga ligji. ***Kjo tregon vështirësitë që ka kjo agjenci e cila nuk ja ka arritur qëllimit kryesor të saj miradministrimin duke shtuar vlerën financiare të këtyre pasurive***, disa nga këto vështirësi konsistojnë në :
-Pasaktësi (konfuzion) në vendimet e gjykatave përsa i përket përputhjes ne teren te sipërfaqeve të tokës dhe pozicionimin e objekteve, shumat e sekuestruara apo konfiskuar, të dhënat identifikuese të shoqërive etj .
-Konfiskimi i 27.342 % te dy apartamenteve(vlerësim i pamundur).
-Ekzekutimi i revokimit te llogarive bankare pa prezencën e përmbarimit dhe administratoreve të AAPSK-së, por vetëm me marrjen e vendimit te gjykatës.
-Mosparaqitja ne ekzekutim e topografëve apo e përfaqësuesve të pushtetit lokal ne rastin e mungesës së subjektit të cilit i sekuestrohet apo konfiskohet pasuria.
Pajisja me dokumentacionin e nevojshëm për vazhdimin e procedurave nga institucione të ndryshme shtetërore si ZQRPP dhe DSHTR etj.
Agjencia është e ekspozuar më së shumti ndaj riskut të administrimit të pasurive të konfiskuara sipas nenit 36 të Kodit Penal, si produkte të rrjedhura nga vepra penale por me ndryshimin që këto pasuri konfiskohen vetëm pasi kemi një vendim penal të formës së prerë, ku personi të jetë deklaruar fajtore .
Kështu përvec shpenzimeve që mbart vetë proçesi i administrimit, është i lartë dhe risku i kthimit të këtyre pasurive shoqëruar dhe me padi gjyqësore për fitimin e munguar gjatë periudhës së administrimit nga AASPK.
Kjo agjenci mundësitë e saj për të tjetërsuar pronën apo për të mirë administruar këto pasuri i ka të kufizuara, kur nuk ka titullin e pronësisë. Detyrimi u lind autoriteteve të tjera të zbatimit të ligjit që të vendosin konfiskimin mbi pasuri të tilla, ku kryesisht rolin kryesor e luajnë vendimet e gjykatave.

III GJETJET DHE REKOMANDIMET

Drejtimi nr. 1 ***"Auditim mbi vlerësimin e bazës rregullative të funksionimit të Agjencisë".***

Situata: Nga auditimi i vlersimit të bazës rregullative konstatohet se Agjencia nuk funksionon nëpërmjet një sistemi të informatizuar në lidhje me pasuritë e mara nën administrim: nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim

të procesit**,** mungesa e një sistemi Informatik e bën të pamundur mbikqyrjen e procesve, shton volumin shkresor, ndërkohë që nuk mundëson kryerjen e veprimeve on-line nga ana e administratoreve, ul nivelin e bashkërendimit me institucione të tjera, zeron mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e te dhënave me institucioneve që bashkëpunojmë me Agjencinë si dhe pengon dhëninen në kohë reale të informacioneve të kërkuar nga institucionet vendase dhe të huaja në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

Kriteri : *VKM nr. 687, dt. 05.10.2011*, "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe mënyrë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" në përmirësim të *VKM nr. 314,dt 5.05.2014*" Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërblimit te personave të trete në administrimin e pasurisë"

Ndikimi/Efekti: Të dhënat e AAPSK-ja mbi administrimin e pasurive, nuk mbahen në një sistem të informatizuar unik ku të kemi të dhëna historike lidhur me procedurat e administrimit, sekustrimet, konfiskimet, revokimet si dhe gjithë shpenzimet që kryhen gjatë administrimit të këtyre pasurive. Nga auditimi konstatohet se mbahen vetëm në tabela exell nga punonjësit e Agjencisë apo dhe administratorët gjë e cila nuk krijon një database qëndrore të gjithë procesit.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: AAPSK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të planifikojnë mundësinë e ngritjes së një sistemi informatik, i cili do të ndihmojë në ngritjen e një database me të dhëna historike mbi cdo të dhënë të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara që administrohen nga kjo Agjenci.

Menjëherë

Drejtimi nr. 2 "*Auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit"* **.**

Situata :

Nga auditimi konstatohet se Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-^{së} nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.

2.Për vitin 2016-2017, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të AAPSK-^{së}, por nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

3. Nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësive, nuk janë identifikuar me emërtimin "Lista e proceseve të punës", nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme.

- Për vitin 2016 është hartuar rregjistri i riskut, dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i është ngarkuar kryeadministratorit, por pa e përditësuar në vazhdimësi. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III "Identifikimi i risqeve" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Kriteri :

Ligjin Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Fiancave (2010);

Ndikimi/Efekti: Konstatohet se mospërmbushja e detyrimit në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, vendos në rrezik arritjen e objektivave, të Agjencisë.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Për sa më sipër rekomandojmë, të kryhet identifikimi dhe **krijimi i Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, të bëhet monitorimi i kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra të hartohet një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III "Identifikimi i risqeve" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Menjëherë

Drejtimi nr.3 : *"Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në fushën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara".*

Situata :

1. Gjatë vitit 2016 dhe 8-mujorit të vitit 2017 sipas raportit të aktivitetit 2016 dhe 9-mujorit 2017, në drejtim të AAPSK kanë ardhur 54 vendime gjykatash, nga të cilat 25 gjatë vitit 2016 dhe 29 gjatë pjesës tjetër të periudhës së auditimit, si dhe vetëm 1 Urdhër i Ministrisë së Financave nr.7, datë 20.01.2017, ndërkohë që sipas librit të protokollit, kanë ardhur për administrim përkatësisht 38 dhe 33 vendime gjykate, duke përbërë një diferencë prej 13 vendimesh në vitin 2016 dhe 4 vendimesh në tetëmujorin e vitit 2017, nga vendimet që janë marrë në ekzekutim. Diferenca e konstatuar flet për një rrjedhë veprimi

jo të mirë përcaktuar dhe shteruese të mënyrës së administrimit apo zbatimit të vendimeve të gjykatave. Kjo agjenci prej marrjes së vendimeve i përcjell tek administratori I pasurisë, kur është i përcaktuar në vendim, por për to nuk bëhet një rakordim I mëvonshëm, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të tyre, duke rritur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.

2. Nga auditimi u konstatua se Agjencia bën një inventarizim elektronik në format lehtësisht të ekspozuar ndaj rrisqeve, të aksesueshëm, që nuk ruan gjurmë të veprimeve, të pasurive në administrim, të sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara, të pa shoqëruar nga një regjistër të mirëfilltë fizik, përmbledhës, historik të të gjitha llojeve të pasurive, sipas statusit të tyre, të marrjes apo jo në dorëzim.

-Mbajtja e listës së pasurive të marra në administrim, të sekuestruara, konfiskuara apo revokuara bëhet nga secili administrator në bazë të vendimeve gjyqësore, por dhe nga administratori kordinator në formë elektronike, përmbledhëse. Nga verifikimi i këtij regjistrimi konstatohet se nuk mbahet një rrjedhshmëri historike e vendimeve të gjykatave, që nga momenti I lindjes së detyrimit të sekuestrimit deri në tjetërsimin e tij në një formë tjetër, të konfiskimit apo revokimit, duke mos u ndjekur një gjurmë konkrete auditimi, që të cojë në vendimin final të zbatuar nga AAPSK. Në regjistrin elektronik evidentohet vetëm vendimi I fundit në lidhje me pasuritë, duke mos ripërshkruar gjithë veprimtarinë e administratorit, në lidhje me pasuritë, si dhe duke mos shfaqur një raportim të plotë dhe konciz.

-Sipas raportit mujor të administrimit të pasurive, në muajin dhjetor 2016 dhe gusht 2017, grupi I auditimit, duke iu referuar datës së marrjes në dorëzim të pasurive, përmblodhi të dhënat, nga ku rezulton se ka një diferencë midis pasurive të raportuara në raportin e aktivitetit të agjencisë dhe raportimit mujor të administratorëve të pasurive, për pasuritë që ata administrojnë, që konfirmon problematikën në këtë mënyrë regjistrimi. Kështu u konstatua një diferencë në numrin e pasurive të administruara, prej 15 pasurish për vitin 2016 dhe 39 pasurish në tetëmujorin e vitit 2017. Diferencat e këtij lloji dhe mbartja e tyre në muaj, flasin për një mosrakordim të vazhdueshëm midis administratorëve, si dhe mosmbajtje të të njëjtit konvencion regjistrimi, pasi koordinatorët inventarin e pasurive e ndërtojnë në bazë të vendimeve të fundit dhe pasurive të marra në administrim, duke bërë një fshirje të ruajtjeve të mëparshme të pasurive për të cilat ka dalë vendimi I revokimit, si dhe të mos përfshirjes në të të pasurive të pamarra ndonjëherë në administrim. Megjithatë përsëri për këto pasuri të pa marra në administrim nuk ka një regjistër, megjithë përpjekjet e mundshme, të vazhdueshme të administratorëve të pasurive, në drejtim të zbatimit të vendimit.

-Nga AAPSK nuk është bërë një inventarizim I pajisjeve/ makinerive të sekuestruara/ konfiskuara të ndodhura në magazinat e saj, duke rritur riskun e humbjes/ tjetërsimit gjatë procesit të administrimit të tyre në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e

aktiveve", i ndryshuar… pjesa III,26.."*Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar*", 28… "*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi dhe ato nën administrim në formën e pjesëmarrjeve në kapital*".

3. Gjatë auditimit u konstatua se AAPSK ka 9 pasuri të pamarra në administrim, të cilat mund të evidentohen vetëm në dosjet e pasurive, pa një raportim të veçantë moszbatimi. Për këto pasuri nuk ka një regjistër listues të numrit dhe problematikave që kanë sjellë në mosekzekutim të vendimit të gjykatës, duke shfaqur një risk në moszbatim të vendimeve të sekustrimit/ konfiskimit dhe revokimit. Si dhe, AAPSK ka në administrim 27 pasuri të revokuara, por të padorëzuara, nga të cilat 22 janë llogari bankare të shtetasve, që pas revokimit nuk ka informacion të destinacionit, për të cilat AAPSK ka detyrim ligjor për njoftim dhe dorëzim dhe 5 pasuri të paluajtshme. Ndër pasuritë e paluajtshme të revokuara, por të padorëzuara në vitin 2017, një pasuri "magazinë'është në përdorim të AAPSK, një "magazinë"në përdorim të Nj.M.L.F dhe nuk janë dorëzuar pasi nuk është gjetur zgjidhja për të zhvendosur makineritë dhe pajisjet që në dy ambjentet ndodhen brenda, ndërsa 3 pasuritë e tjera të paluajtshme, që I përkasin "Ringjalljes së trashëgimisë islame" në administrim të administrators E.P, nuk janë dorëzuar për faktin se subjekti që I ka në pronësi, nuk I ka marrë në dorëzim pas vendimit të revokimit. Këto 3 pasuri janë dhënë me qera prej AAPSK, pra janë ende në administrim të saj.

4. *Nga auditimi u konstatua se ekziston një vonesë në ekzekutimin e vendimit dhe njoftimin që këto hallka kanë kundrejt AAPSK,* në kundërshtim me VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit", Kreu I,pika2…. "*Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve",* si dhe… "*Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, brenda afateve të parashikuara.".* Kështu nga auditimi I zbatimit të afateve të marrjes në dorëzim të pasurive kundrejt datës së vendimit, rezultoi se, ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kështu nga 82 pasuri të paluajtshme në administrim të AAPSK në vitin 2016, u morën në shqyrtim 64 pasuri, pra rreth 78% të tyre, nga të cilat rezultoi se 36 pasuri, apo 56% të rasteve kishin vonesë në marrjen në dorëzim nga 1-9 muaj, 9 pasuri, apo 14% e rasteve kishin vonesë nga 1-7 vjet, 16 pasuri, apo 25% e tyre kishin vonesa nga 16-30 ditë dhe vetëm 3 raste ose **5% të pasurive të paluajtshme** për sekuestrim, vendimi ishte **ekzekutuar brenda afateve ligjore.** Ndërkohë që lista e shoqërive tregtare/ Bizneseve për administrim sipas vendimeve të

gjykatave përbëhet nga 11 biznese, vetëm 3 shoqëri janë marrë në administrim, 2 prej të cilave pa aktivitet, duke rezultuar se AAPSK administron vetëm 1 shoqëri në aktivitet. Për 45 llogaritë bankare të marra në administrim u konstatua se **64% e llogarive bankare janë marrë në ekzekutim brenda afateve** ligjore. Në 15 makineri/ pajisje në administrim të AAPSK, nga të cilat u verifikua data e marrjes në dorëzim I 9 pasurive, rezultoi se 5 automjete janë marrë në administrim në periudhën nga 1-5 vjet dhe 4 prej tyre në një periudhë që ka zgjatur nga 2-4 muaj, duke treguar problematikën në të cilën ndeshet AAPSK për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave në lidhje me mjetet motorike,

5. Duke mos marrë parasysh pasuritë e marra në dorëzim pas 31.08.2017, sipas inventarit të saj, rezulton se AAPSK ka pasur në administrim gjithsej nga 82 pasuri të paluajtshme në vitin 2016, në 78 pasuri të paluajtshme në 8-mujorin e vitit 2017, ndër të cilat 57 dhe 46 përkatësisht janë *tokë are*, ose *70 % dhe 60% e pasurive në administrim. AAPSK megjithëse i ka në administrim tokat arë, pyje, ullishte, ajo nuk siguron të ardhura prej tyre*, por u shpërndan shpenzime të administrimit, pra AAPSK në këto kushte, mund të krijonte të ardhura potencialisht prej 30% dhe 40% e pasurive të paluajtshme apartamente, zyra, magazine, garazhe, restorante, njësi biznesi, etj në administrim.

Kriteri :

VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit", Kreu I,pika2. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar… pjesa III,26.."

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Për sa më sipër rekomandojmë që :
-AASPK duhet të kryej rakordime të mëvonshëm, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të vendimeve,nga momenti i marrjes së këtyre vendimeve nga Administratori i pasurisë, deri në ekzekutimin e tij, duke ulur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.

Menjëherë

Drejtimi nr.4 : *"Auditimi i procedurave të dhënies me qira të objekteve."*

Situata : Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2016 nga AAPSK janë dhënë me qira 10 objekte dhe janë përfituar prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën total 1,304,455 lekë. Ndërsa për periudhën 01.01.2017 deri më 30.08.2017 janë dhënë me qira 22 objekte dhe janë përfituar prej tyre të ardhura në vlerën total 5,069,470 lekë. Komisionet e ngritura për vlerësimin e çmimit për dhënien me qira të objekte, kanë propozuar çmime shumë të ulta në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr.469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues

të qirave të ndërtesave për qëllime tatimor".

Kriteri : VKM nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues të qirave të ndërtesave për qëllime tatimor".

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: AAPSK pavarsisht vështirësisë që u jep statusi specifik këtyre pasurive duhet të marri masa të menjëhershme për zbatimin me korrektësi të procedurave të miratuara për vendosjen e çmimeve të qerave, me qëllim maximizimin e të ardhurat që përfitohen prej tyre.

Në vijimësi

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:
a. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-^{së} nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.
b. Për vitin 2016-2017, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të AAPSK-^{së}, por nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.
c. Megjithëse janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emërtuara nga Ministria e Financave, nuk ka miratim të tyre nga Ministria e Financës dhe arkivim të kësaj gjurme.
d. Për vitin 2016 është hartuar rregjistri i riskut, dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i është ngarkuar kryeadministratorit, por pa e përditësuar në vazhdimësi dhe pa i ndarë risqet e përgjegjësitë. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe **krijimin e Regjistrit të Risqeve për vitin 2017**, monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III "Identifikimi i risqeve" të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
e. Nuk ekziston një protokoll i brendshëm për korespondencat midis strukturave lart-poshtë e paralel, apo raportimet e kryera në nivelin e lartë të strukturave. Mos kryerja e këtyre veprimeve përbëjnë risk në këtë instutucion, pasi nuk lihen gjurmë për auditimin e veprimtarisë të nëpunësve të saj.

f. Në këtë institucion është miratuar Rregullorja e Brendshme, e cila në përgjithësi parashikon raportet punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve, është hartuar **Kodin e Etikës**, por ka mangësi në ndarjen e detyrave të punëdhënës-punëmarrës dhe midis vetë punëmarrësve. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të vendosen prioritete për njohjen dhe zbatimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke përmirësuar përcaktimin e objektivave strategjikë, regulloren e brendëshme, kodin e etikës, përcaktimin e risqeve të mundëshme dhe të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detajimit të projekt buxhetit dhe regjistrit të prokurimeve për zërat e shpenzimeve operative buxhetore për vitin 2016, konstatojmë:
-Nuk **janë futur në regjistrin** e prokurimeve blerje e shërbime si:Shpenzime për ngrohje, në vlerë 150 mijë lekë, një zë me vlerë të tillë që nuk ka pse të planifikohet; Mirëmbajtje paisje zyrash në vlerë 400 mijë lekë, apo blerje goma e pjesë këmbimi në vlerë 400 mijë lekë etj.
-Kanë **diferenca** të konsiderueshme regjistri i prokurimeve me projekt buxhetin si:Riparim automjeti, planifikuar për 50 mijë lekë në projekt buxhet dhe në regjister është për 375 mijë lekë, apo 7.5 herë më shumë; Blerje kancelari dhe tonera, planifikuar për 480 mijë lekë dhe hedhur në regjistrin e prokurimit për 975 mijë lekë, apo mbi 2 herë më shumë, etj.
Megjithese realizimi i artikullit 602 në krahasim me projekt buxhetin dhe aprovimin e tij është në masën 100%, **ka ndryshime të mëdha** midis realizimit, apo tejkalimit të zërave që e përbëjnë atë, pra:
a.Nuk janë realizuar fare disa zëra të programuar, në vlerë 1,300 mijë lekë, pra s'janë realizuar "dieta jashtë vendit", në vlerë 200 mijë lekë, "shërbime ngrohje", në vlerë 150 mijë lekë, "bleje pjesë këmbimi e goma", në vlerë 400 mijë lekë, "shërbime për mirëmbajtje ndërtimore" në vlerë 130 mijë lekë, apo "mirëmajtje zyrash" në vlerë 400 mijë lekë.
b.Janë realizuar disa zëra të pa programuar në buxhet si: "ruajtje fizike e zyrave" në vlerë 1,065 mijë lekë, "instalime e riparime të ndryshme" në vlerë 36 mijë lekë dhe "shërbime interneti" në vlerë 93 mijë lekë.
c.Ka ndryshime të mëdha vlerash midis realizimit dhe programimit si: **"**Riparim automjeti" realizuar më shumë për 244 mijë lekë, apo 5 herë më shumë se programimi; "sigurim automjetesh"realizuar më shumë për 230 mijë më shumë, apo 12.5 herë më shumë se programimi etj. Po ashtu sikundër ka zëra që janë realizuar shumë më pak nga programimi si "blerje karburanti", "energji", "telefona" dhe "dieta brenda vendit".
d.Vendime gjyqësore, janë realizuar në vlerë 2,708 mijë lekë, ose sa 54% e të gjithë 602, të cilat janë programuar në vlerë 1,300 mijë lekë, pra është realizuar më shumë se dyfishin e vlerës së programuar.
Të gjitha sa thamë më lart, programimi i zërave të buxhetit bëhet formal dhe i pa studjuar nga struktura menaxhuese e këtij institucioni. Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të punohet për një programim real të shpenzimeve buxhetore, sipas kërkesave reale të institucionit dhe në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për këtë qëllim, duke eliminuar formalitetin në programimin e këtyre fondeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, paraqitja e informacionit, si dhe të dhënat e raportuara në **raportin e monitorimit** duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Rezultoi që të dhënat e raportuara në raportin e këtij institucioni për vitin 2016, nuk janë raporte monitorimi sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe në anekset përkatëse. Raporti i monitorimit të këtij viti ka të plotësuara vetëm disa nga tabelat e raportimit dhe jo relacionin e tij, ku mungon analiza e mirëfilltë e objektivave të politikës së programit. Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës, si në udhëzimin e mësipërm është e rëndësishme edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arritjet edhe problematikat.
Pjesë e raportit të monitorimit duhet të jenë edhe shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, si edhe treguesit e performancës së realizimit të tyre. Pra kërkohet të bëhet një raport monitorimi me dy pjesë: e para për përdorimin e fondeve që kalojnë nga buxheti dhe Thesari dhe pjesa e dytë nga përdorimi i vlerave monetare nga llogaria e konfiskimeve dhe sekuestrimeve që realizon ky institucion nga llogaria bankare. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, të hartohen raporte monitorimi për të dy aktivitetet (si për fondet buxhetore dhe për fondet nga llogaritë e administratorëve), në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore", me qëllim përmirësimin e performancës së përdorimit të këtyre fondeve, ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, jashtë programimit dhe për herë të parë, është shtuar gjatë vitit në artikullin **604** "Transferta të brendëshme", vlera prej **25,000,000 lekë,** me shkresën e Ministrisë së Financave nr.17928/2, datë 18.01.2016 "Dërgohet urdhër nr. 9, datë 18.01.2016, për destinimin e fondit të posaçëm në mbështetje të urdhërit të ministrit të financave nr.84, datë 08.10.2014", vlerë e cila do të përdoret për likujdime në disa institucione e shoqëri, e që vite më parë janë kryer direkt nga Ministria e Financës. Në këtë institucion dokumentacioni shoqërues i pagesave për këto transferta administroheshin nga Administratori i Terenit, ndërsa veprimet e likujdimit kryheshin dhe kontabilizoheshin nga Financjerja e institucionit pa dokumenta shoqëruese, duke munguar kështu kontrolli i dyfishtë i këtyre veprimeve kontabël. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, të përcaktojnë qartë se kush do ti administrojë fondet për likujdimin e institucioneve apo shoqërive që ndihmojnë në luftën kundër krimit të organizuar dhe ndihmojnë viktimat e tij, duke përcaktuar edhe kontabilizimin dhe dokumentacionin ligjor të tyre.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Organizimi dhe dokumentimi i veprimeve kontabël të aktivitetit nga fondet buxhetore është mbajtur dhe kontabilizuar në regull dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndërsa kontabiliteti i aktivitetit të administratorëve dhe pronat që kanë ata në administrim, rezultuan me problematika regjistrimi, si:

a. Administratorët nga ana financiare, rakordojnë për shpenzimet dhe të ardhurat analitike me Kordinatorin Financiar të institucionit, i cili i kontrollon dhe regjistron ato në partitarë të veçantë për çdo pronë dhe administrator, por pa i kontabilizuar ato në llogari të veçanta, në mënyrë që këto të ardhura dhe shpenzime të kenë rakordimin dhe kontrollin dyfish të tyre.
b. Për të ardhurat dhe shpenzimet për këtë aktivitet, ky institucion ka të hapur një llogari në bankën e nivelit të dytë "Veneto Bank" dhe lëvizjet e kësaj llogarie i regjistron bruto financierja e institucionit, por pa i kontabilizuar të ardhurat, apo shpenzimet në mënyrë analitike dhe në administrim të kujt prone janë. Në regulloren e brendëshme të këtij institucioni nuk është përcaktuar qartë se kujt i takon mbajtja, regjistrimi dhe nxjerrja e rezultatit nga aktiviteti i administratorëve. Në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar citohet: "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar, ose në bartës informatikë. Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese. Pra ky aktivitet ekonomik, regjistrimi kontabël bruto behej në sektorin e administrimit (financë) të brendshëm dhe dokumentacioni orgjinal dhe analitik mbahej nga kordinatori financiar, në kundërshtim me ligjin e sipërcituar.
c. Pjesë e të ardhurave nga ky aktivitet, por jashtë llogarisë të të ardhurave dhe shpenzimeve janë dhe "Depozitat dhe Interesat e depozitave të sekuestruara dhe konfiskuara", të cilat janë të ardhura që kapitalizohen me urdhër të Ministrit të Financave dhe mbas vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Interesat e këtyre depozitave rikapitalizohen në kapitalin themeltar të depozitës dhe janë në administrim të administratorëve përkatës, të cilët i pasqyrojnë në kartela përkatëse për çdo depozitë dhe kuadrojnë si për çdo pasuri me kordinatorin financiar, por pa kaluar nga sektori i financës së institucionit. Pra specialistja e financës disponon të dhëna vetëm për llogarinë likujduese të V Bank, llogari e cila përdoret për të paguar shpenzimet që duhen për administrimin e pasurive dhe për derdhur të ardhurat e realizuara nga objektet e dhëna me qera, apo nga derdhjet në këtë llogari me urdhër të Ministrit të Financave dhe nuk disponon të dhëna pët interesat e depozitave.
d. Gjithashtu për këtë aktivitet nuk kishte nxjerje të pasqyrave financiare, por vetëm raporte për Komitetin Këshillimor Ndëristitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar për të ardhurat e shpenzimet dhe problematikat e hasura. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, për të vënë në baza ligjore administrimin e aseteve dhe fondeve publike të aktivitetit të administratorëve, të përcaktojnë mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit dhe nxjerjen e llogarisë vjetore për këtë aktivitet.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i inventarizimit të aseteve rezultoi:
a. Urdhëri i titullarit "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve dhe materialeve në AAPSK" ka përcaktuar bazë ligjore shumë të prapambetur, kur duhet të ishte cituar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimi i Ministrisë

së Financave nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me nr.20, datë 17.11.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
b. Gjatë verifikimit listës së objekteve të inventarizuar dhe të regjistrit të aktiveve të qendrueshme konstatohet se janë kaluar dhe kontabilizuar në aktive të qendrueshme (llogaria 218 inventar ekonomik) edhe një sasi e aktiveve qarkulluese, (pra llogaria 327 "objekte inventari"), për objekte të cilat nuk e kanë as rolin dhe vlerën si active të qendrueshme si: Makina kapse dokumentash copë 5, me cmim 200 lekë; Makina kapse dokumentash të mëdha copë 1, me cmim 2,500 lekë; Kosh plerash copë 5 me cmim 900 lekë; Tabela dyersh copë 6, me çmim 500 lekë; e kështu me radhë kyce, dryna, shirita,kosha letre, foto presidenti, zgjatuesa dhe usb etj, duke denatyruar vlerën reale të këtyre paisjeve.
c. Nuk është bërë inventarizimi në fund të vitit i llogarive inventariale 311 "Materiale" dhe 327 "Objekte inventari", gjendje në magazinë.
d**.** Në përfundim të invetarizimit, janë përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe antarët e komisionit të inventarizimit, por pa hartuar një raport nga komisioni i inventarizimit lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, vlerësim paraprak të cilësisë dhe kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike për titullarin e institucionit dhe materialet që janë për të dalë jashtë përdorimit.
e. Nuk ka dalë urdhër dhe nuk është kryer, inventarizimi në fund të vitit i llogarive të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të aseteve dhe magazinës së Administratorëve. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 41-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6.1. Rekomandimi: Nga struktura drejtuese dhe menaxhuese e këtij institucioni, për të vënë në baza ligjore administrimin e aseteve, të kryhet inventarizimi i të gjitha aseteve të qendruesme dhe qarkulluese, për të dy aktivitetet e këtij institucioni, si për inventarizimet, nxjerrjet jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
Nga strukturat menaxhuese të sistemohen në kontabilitet dhe të bëhet ndarja ligjore midis aktiveve të qëndrueshme dhe aktiveve qarkulluese.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga vlersimi i bazës rregullative konstatohet se Agjencia nuk funksionon nëpërmjet një sistemi të informatizuar në lidhje me pasuritë e mara nën administrim: nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim të procesit**,** mungesa e një sistemi Informatik e bën të pamundur mbikqyrjen e procesve, shton volumin shkresor, ndërkohë që nuk mundëson kryerjen e veprimeve on-line nga ana e administratoreve, ul nivelin e bashkërendimit me institucione të tjera, zeron mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e te dhënave me institucioneve që bashkëpunojmë me Agjencinë si dhe pengon dhëninen në kohë reale të informacioneve të kërkuar nga institucionet vendase dhe të huaja në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.1. Rekomandimi: AAPSK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të planifikojnë mundësinë e ngritjes së një sistemi informatik, i cili do të ndihmojë në ngritjen e një database me të dhëna historike mbi çdo pasuri të konfiskuara dhe sekuestruara që administrohen nga kjo Agjenci, nga dalja e vendimit të gjykatës, deri në përfundim të procesit**,** duke bërë të mundur mbikqyrjen e procesve, të ul volumin e komunikimit shkresor, të mundësojë kryerjen e veprimeve on-line nga ana e administratoreve, të rrisi nivelin e bashkërendimit me institucione të tjera, shton mundësinë e lidhjes dhe kryqëzimin e te dhënave me institucioneve që bashkëpunojmë me Agjencinë si dhe mundëson dhënien në kohë reale të

informacioneve të kërkuara nga institucionet të ndryshme në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016 dhe 8-mujorit të vitit 2017 sipas raportit të aktivitetit 2016 dhe 9-mujorit 2017, në drejtim të AAPSK kanë ardhur 54 vendime gjykatash, nga të cilat 25 gjatë vitit 2016 dhe 29 gjatë pjesës tjetër të periudhës së auditimit, si dhe vetëm 1 Urdhër i Ministrisë së Financave nr.7, datë 20.01.2017, ndërkohë që sipas librit të protokollit, kanë ardhur për administrim përkatësisht 38 dhe 33 vendime gjykate, duke përbërë një diferencë prej 13 vendimesh në vitin 2016 dhe 4 vendimesh në tetëmujorin e vitit 2017, nga vendimet që janë marrë në ekzekutim. Kjo agjenci prej marrjes së vendimeve i përcjell tek administratori i pasurisë, kur është i përcaktuar në vendim, por për to nuk bëhet një rakordim i mëvonshëm, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të tyre, duke rritur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.

-Sipas raportit mujor të administrimit të pasurive, në muajin dhjetor 2016 dhe gusht 2017, grupi i auditimit, duke iu referuar datës së marrjes në dorëzim të pasurive, përmblodhi të dhënat, nga ku rezulton se ka një diferencë midis pasurive të raportuara në raportin e aktivitetit të agjencisë dhe raportimit mujor të administratorëve të pasurive, për pasuritë që ata administrojnë, që konfirmon problematikën në këtë mënyrë regjistrimi. Kështu u konstatua një diferencë në numrin e pasurive të administruara, prej 15 pasurish për vitin 2016 dhe 39 pasurish në tetëmujorin e vitit 2017. Diferencat e këtij lloji dhe mbartja e tyre në muaj, flasin për një mosrakordim të vazhdueshëm midis administratorëve, si dhe mosmbajtje të të njëjtit konvencion regjistrimi, pasi koordinatorët inventarin e pasurive e ndërtojnë në bazë të vendimeve të fundit dhe pasurive të marra në administrim, duke bërë një fshirje të ruajtjeve të mëparshme të pasurive për të cilat ka dalë vendimi I revokimit, si dhe të mos përfshirjes në të të pasurive të pamarra ndonjëherë në administrim. Megjithatë përsëri për këto pasuri të pa marra në administrim nuk ka një regjistër, megjithë përpjekjet e mundshme, të vazhdueshme të administratorëve të pasurive, në drejtim të zbatimit të vendimit. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1. Rekomandimi: AASPK duhet të kryej rakordime të mëvonshme, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë numërore apo cilësore të vendimeve,nga momenti i marrjes së këtyre vendimeve nga Administratori i pasurisë, deri në ekzekutimin e tij, duke ulur riskun e humbjes së gjurmës së auditit si dhe plotësisë së të dhënave.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia bën një inventarizim elektronik të pasurive në administrim, të sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara, në format lehtësisht të fshishëm apo modifikueshëm, të aksesueshëm, që nuk ruan gjurmë të veprimeve, të pa shoqëruar nga një regjistër i mirëfilltë fizik, përmbledhës, historik të të gjitha llojeve të pasurive, sipas statusit të tyre, të marrjes apo jo në dorëzim. Mbajtja e listës së pasurive të marra në administrim, të sekuestruara, konfiskuara apo revokuara bëhet nga secili administrator në bazë të vendimeve gjyqësore, por dhe nga administratori kordinator në formë elektronike, përmbledhëse. Nga verifikimi i këtij regjistrimi konstatohet se nuk mbahet një rrjedhshmëri historike e vendimeve të gjykatave, që nga momenti I lindjes së detyrimit të sekuestrimit deri në tjetërsimin e tij në një formë tjetër, të konfiskimit apo revokimit, duke mos u ruajtur një gjurmë e plotë auditimi, që të cojë në vendimin final të zbatuar nga AAPSK. Në regjistrin elektronik evidentohet vetëm vendimi I fundit në lidhje me pasuritë, duke mos ripërshkruar gjithë

veprimtarinë e administratorit, në lidhje me pasuritë, si dhe duke mos shfaqur një raportim të plotë dhe konciz.
- Nga AAPSK nuk është bërë një inventarizim I pajisjeve/ makinerive të sekuestruara/ konfiskuara të ndodhura në magazinat e saj, duke rritur riskun e humbjes/ tjetërsimit gjatë procesit të administrimit të tyre në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar… pjesa III,26.."*Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar*", 28… "*Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi dhe ato nën administrim në formën e pjesëmarrjeve në kapital*". *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1 Rekomandimi: AAPSK duhet të krijojë një regjistër fizik, përmbledhës të pasurive të marra dhe jo në administrim, ku të specifikohet gjithë rrugëtimi i secilës pasuri në Agjenci, prej vendimit të gjykatës, deri në revokimin e saj, në funksion të zbatimit të plotë të vendimeve gjyqësore në drejtim të marrjes në administrim të pasurive, si dhe raportimit konciz.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit rezultoi se AAPSK ka 9 pasuri të pamarra në administrim, të cilat mund të evidentohen vetëm në dosjet e pasurive, pa një raportim të veçantë moszbatimi. Për këto pasuri nuk ka një regjistër listues të numrit dhe problematikave që kanë sjellë në mosekzekutim të vendimit të gjykatës, duke shfaqur një risk në moszbatim të vendimeve të sekuestrimit/ konfiskimit dhe revokimit. Si dhe, AAPSK ka në administrim 27 pasuri të revokuara, por të padorëzuara, nga të cilat 22 janë llogari bankare të shtetasve, që pas revokimit nuk ka informacion të destinacionit, për të cilat AAPSK ka detyrim ligjor për njoftim dhe dorëzim dhe 5 pasuri të paluajtshme. Ndër pasuritë e paluajtshme të revokuara, por të padorëzuara në vitin 2017, një pasuri "magazinë'është në përdorim të AAPSK, një "magazinë"në përdorim të Nj.M.L.F dhe nuk janë dorëzuar pasi nuk është gjetur zgjidhja për të zhvendosur makineritë dhe pajisjet që në dy ambjentet ndodhen brenda, ndërsa 3 pasuritë e tjera të paluajtshme, që I përkasin "Ringjalljes së trashëgimisë islame", nuk janë dorëzuar për faktin se subjekti që I ka në pronësi, nuk I ka marrë në dorëzim pas vendimit të revokimit. Këto 3 pasuri janë dhënë me qera prej AAPSK, pra janë ende në administrim të saj. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

10.1 Rekomandimi: Nga AAPSK për pasuritë e pamarra në administrim dhe për pasuritë e padorëzuara, të bëhet një raportim i veçantë, ku të specifikohet problematika që ka çuar në mosekzekutim të vendimit për secilën pasuri, duke rritur transparencën në mungesën apo pamundësinë e administrimit të pasurive.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ekziston një vonesë në ekzekutimin e vendimit, si rezultat i vonesës në njoftim, apo bashkëpunim, që këto hallka(Gjykata, Prokurori, Shërbimi përmbarimor) kanë kundrejt AAPSK, në kundërshtim me VKM nr.563, datë 14.7.2010 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarimor me agjencinë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarimit", Kreu I, pika2 …. "Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të

ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve", si dhe… "Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, brenda afateve të parashikuara." Kështu nga auditimi i zbatimit të afateve të marrjes në dorëzim të pasurive kundrejt datës së vendimit, rezultoi se, ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kështu nga 82 pasuri të paluajtshme në administrim të AAPSK në vitin 2016, u morën në shqyrtim 64 pasuri, pra rreth 78% të tyre, nga të cilat rezultoi se 36 pasuri, apo 56% të rasteve kishin vonesë në marrjen në dorëzim nga 1-9 muaj, 9 pasuri, apo 14% e rasteve kishin vonesë nga 1-7 vjet, 16 pasuri, apo 25% e tyre kishin vonesa nga 16-30 ditë dhe vetëm 3 raste ose **5% të pasurive të paluajtshme** për sekuestrim, vendimi ishte **ekzekutuar brenda afateve ligjore.** Ndërkohë që lista e shoqërive tregtare/ bizneseve për administrim sipas vendimeve të gjykatave përbëhet nga 11 biznese, vetëm 3 shoqëri janë marrë në administrim, 2 prej të cilave pa aktivitet, duke rezultuar se AAPSK administron vetëm 1 shoqëri në aktivitet. Për 45 llogaritë bankare të marra në administrim u konstatua se **64% e llogarive bankare janë marrë në ekzekutim brenda afateve** ligjore. Në 15 makineri/ pajisje në administrim të AAPSK, nga të cilat u verifikua data e marrjes në dorëzim e 9 pasurive, rezultoi se 5 automjete janë marrë në administrim në periudhën nga 1-5 vjet dhe 4 prej tyre në një periudhë që ka zgjatur nga 2-4 muaj, duke treguar problematikën në të cilën ndeshet AAPSK për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave në lidhje me mjetet motorike. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

11.1 Rekomandimi: AAPSK të rrisë përpjekjet për të intensifikuar bashkëpunimin me hallkat ndërmjetëse, për përmirësimin e punës administruese të pasurive për sekuestrim/ konfiskim/ revokim, në funksion të shkurtimit të kohës së marrjes në administrim dhe shfrytëzimit efiçent të këtyre pasurive.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se AAPSK ka administruar gjithsej 82 pasuri të paluajtshme në vitin 2016 dhe 78 pasuri të paluajtshme në 8-mujorin e vitit 2017, ndër të cilat 57 dhe 46 përkatësisht janë tokë are, ose 70 % dhe 60% e pasurive në administrim. AAPSK megjithëse i ka në administrim tokat arë, pyje, ullishte, ajo nuk siguron të ardhura prej tyre, por u shpërndan shpenzime të administrimit dhe në këto kushte, mund të krijojë të ardhura potencialisht prej 30% dhe 40% të pasurive të paluajtshme. Gjatë vitit 2016 nga AAPSK janë dhënë me qira 10 objekte dhe janë përfituar prej tyre, të ardhura nga qiraja në vlerën total 1,304,455 lekë, ndërsa për periudhën 01.01.2017 deri më 30.08.2017 janë dhënë me qira 22 objekte dhe janë përfituar prej tyre të ardhura në vlerën total 5,069,470 lekë.

Komisionet e ngritura për vlerësimin e çmimit për dhënien me qira të objekte, kanë propozuar çmime shumë të ulta në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues të qirave të ndërtesave për qëllime tatimor". Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirave rezultoi se përgjithësisht pagesat e qirasë janë kryer pas datës 5 të çdo muaji, në kundërshtim me pikat 5.4, 5.5, të Kontratave të Qirasë ku citohet se pagesa është parapagim dhe bëhet brenda datës 5 të çdo muaji si dhe për çdo ditë vonesë nga data e caktuar Qiramarrësi do të paguajë kamatëvonesë 0.1% të shumës së qirasë. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-41të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

12.1. Rekomandimi: AAPSK pavarësisht vështirësisë që u jep statusi specifik këtyre pasurive duhet të marri masa të menjëhershme për zbatimin me korrektësi të procedurave të miratuara për vendosjen e çmimeve të qerave, me qëllim maksimizimin e të ardhurat që përfitohen prej tyre dhe për të gjitha rastet e pagesave të kryera pas datës së përcaktuar në kontratën e qirasë të llogarisë kamatvonesat.

Menjëherë

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konluzionet dhe baza për opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërisë financiare (ISSAI 4100). *Nga auditimi i përputhshmërinë , për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve dhe politikave, mbi të cilat realizohet buxheti (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, gjatë auditimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e dhënies me qera të pasurive që lidhen me mosaplikimin e saktë të elementëve të vlerës së pasurisë që jepet me qera, procedura jo të sakta gjatë veprimtarisë së administrimit të pasurive, që lidhen me, mangësi në procedurat e ndjekura për administrimin ,inventarizimin dhe rregjistrimin e tyre. Si konkluzion, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, i mbështetur në standardet Intosai dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin AAPSK, rezultuan mospërputhje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat nën gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të pakualifikuar të përputhshmërisë[3].*
Në Opinionin tonë, AASPK përveç mangësive të identifikuara më sipër dhe të trajtuara në këtë P/Raport (të cilat nuk janë materiale dhe jo të përhapura), menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në AAPSK-së nuk ka funksionuar si duhet, pasi punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion i cili të jetë efektiv për të garantuar përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e institucionit.

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e Projekt Raportit të Auditimit është edhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë :
1-Akt Konstatim nr.1 datë 14.11.2017 " *Për pikën nr. 2. Auditim i dhënies me qera të pasurive në administrim.*
2-Observacioni i Agjencisë AAPSK, *për Projekt Raportin e Auditimit datë 14.12.2017,* dërguar me e-mail.

Përgjigja e subjektit të audituar.

Lënda: *Observacion mbi Raportin Paraprak të auditimit.*
Pasi u njohëm me Raportin Paraprak të auditimit, të mbërritur me shkresën nr. 999/3 prot, dt. 23.11.2017, protokolluar me tonën nr. 1016/7, dt. 24.11.2017, konstatuam se grupi i auditimit, në përgjithësi, ka trajtuar në mënyrë të drejte të gjithë problematiken që lidhet me funksionimin e AAPSK-së për periudhën e audituar. Gjithashtu ka nxjerrë në pah një pjese të mirë të vështirësive dhe problematikave që lidhen me administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
Nga ana jonë janë vërejtur disa pika për të cilat kemi një mendim të ndryshëm nga ai i grupit të auditimit, të cilat po i përcjellim në vijim së bashku me argumentet mbështetëse.

[3] *Opinioni i pakualifikuar shprehet kur mbështetur në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar, asnjë çështje nuk ka ardhur në vëmendjen e audituesit që të bëjë që audituesi të besojë që informacioni mbi çështjen dhe objektin e auditimit nuk është përgatitur në çdo aspekt material në përputhje me kriteret e vlerësimit.*

1. Ne faqen 19 të Raportit paraprak, në paragrafin e 3-te citohet: *"Nga AAPSK nuk është bere inventarizimi i pajisjeve / makinerive te sekuestruara / konfiskuara të ndodhura në magazine..."*

Sa me sipër sqarojmë se: Të gjitha pasuritë e luajtshme të depozituara në magazinën e AAPSK-së, janë të pasqyruara në kartelat përkatëse që mbahen nga administratoret e pasurive, të cilët i kane nën administrim.

2. Në lidhje me rekomandimin nr. 1 (faqe nr. 64) *" AAPSK-ja në bashkëpunim me MFE të planifikoje mundësinë e ngritjes së një sistemi informatik..."*, shprehim dakordesine tone te plotë, duke Ju sqaruar se nga ana jonë është paraqitur në MFE për tre vjet rresht (2015-2017) kërkesa për financim të këtij projekti, por deri në këtë moment ende nuk është miratuar.

3. Sa i përket rekomandimit nr. 2, në piken 3 citohet : *"Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore..."* ju sqarojmë se nga ana jonë është hartuar gjurma e auditimit dhe se bashku me projekt urdhrin për miratimin e saj i është dërguar Ministrit të Financave me shkresën nr. 849 prot, dt. 14.10.2016. (bashkëlidhur kopje). Deri në momentin aktual nuk kemi një përgjigje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sa i përket hartimit të regjistrit të Risqeve për vitin 2017 jemi dakord dhe do të realizohet menjëherë.

4. Për sa i përket rekomandimit nr. 3, *"AAPSK-ja duhet të kryeje rakordime të mëvonshme, për të verifikuar zbatueshmërinë e plotë ..."* jemi dakord me rekomandimin dhe do të zbatohet nëpërmjet nxjerrjes së urdhri të brendshëm dhe kryerjes së rakordimit brenda vitit 2017.

Ndërsa, për sa i përket evidentimit se nuk ka një regjistër të pasurive ende te pa marra në administrim, Ju sqarojmë se:

AAPSK-ja ka evidentuar në regjistrat e pasurive nen administrim, vetëm ato pasuri të cilat janë marre nëpërmjet aktit zyrtar (Proces verbalit te Dorëzimit) të hartuar nga Përmbaruesi gjyqësor, i cili ja dorëzon Administratorit te pasurisë. VKM 687/2011, Kreu VI, Pika 1, germa ç) citon: "*ç) Përmbaruesi gjyqësor dokumenton inventarizimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, në prani të administratorit të pasurisë dhe ia dorëzon këtij të fundit me **procesverbal**, të nënshkruar nga të pranishmit, duke zbatuar procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.*"

Megjithatë, ky konstatim i evidentuar nga grupi i auditimit, u vlerësua si drejte dhe nga ana e AAPSK-se u morën masa për hartimin e regjistrit te pasurive te pa marra në administrim për vitin 2017, gjate kohës se kryerjes se auditimit.

5. Në lidhje me rekomandimin nr. 4 (faqe nr. 69) dhe gjetjeve të lidhura me të, siç janë trajtuar në pjesën specifike të projekt-raportit, mbi vendosjen e çmimeve të qirave, ju sqarojmë se problematika dhe vështirësitë reale janë konstatuar edhe nga ana e grupit të auditimit, por zbatimi i përcaktimeve të VKM nr. 469, dt. 03.06.2015 *"Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit referues të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore"* nga ana e Komisioneve të ngritura për këtë qellim për vendosjen e çmimit të qerasë, në disa raste ka qenë i pamundur.

Arsyet janë:

- Komisioni i përcaktimit të çmimit të qiradhënies ngrihet dhe vepron bazuar në Udhëzimin nr. 27, dt. 23.09.2008, të Ministrit të Financave, në të cilin përcaktohet qartë procedura që duhet ndjekur, por edhe kriteret ku bazohet vendosja e çmimit të qirasë. (Kreu III, pika 2.1.1[4]). Theksojmë se këto nuk janë prona në kushte normale në qarkullimin civil, pasi përveç statusit ligjor (të sekuestruara / konfiskuara), kane edhe problematika specifike që lidhen me: **1-** emrin e keq të pronarit; **2-** afatin e qiradhënies për 1 vit duke bere të pamundur një planifikim afatgjate biznesi dhe investimesh nga ana e qiramarrësit; **3-** vendndodhjen e pasurive (shume prej tyre janë në zona turistike bregdetare dhe mund të shfrytëzohet vetëm për një

[4] - kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.

periudhe kohore te caktuar, gjate sezonit veror). Për rrjedhim, çmimi i qirasë nuk mund të përcaktohet "në mënyrë mekanike" duke u mbështetur vetëm në VKM nr. 469, dt. 03.06.2015, për me tepër që kjo e fundit përcakton vlerën referuese **vetëm për qëllime tatimore.**

- Balancimin e shpenzimeve për administrimin (roje,sigurim etj) me të ardhurat e përftuara të pasurisë nga dhënia apo mosdhënia me qira. Në disa raste të veçanta, është gjykuar me më shume leverdi vendosja e një qiraje më të ulet, duke kursyer në këtë mënyrë, shpenzimet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë, të cilat do të kryheshin nga Agjencia në rastin e mosdhënies me qira të pasurisë.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se në asnjë rast çmimi i qirasë së lidhur në kontratë nuk ka qenë më i ulet se ai i propozuar nga Komisioni, për rrjedhim nuk ka qenë e nevojshme të aplikohet pika 2.3 e Kreut III të Udhëzimit nr. 27, dt. 23.09.2008.

Në përfundim e për sa arsyetuam më lart, e gjejmë të vështirë zbatimin e këtij rekomandimi për të gjitha rastet e qiradhënies, por duke mbajtur parasysh përcaktimet e VKM nr. 469/2015 dhe duke vlerësuar rast pas rasti çdo pronë specifike.

6. Sa i përket **Gjetjeve** nga auditimi *"në zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit..."* (faqe nr. 70), sqarojmë se:

- Planifikimi për shpenzimet buxhetore (llog. 600, 601, 602) ka qenë i bazuar në strukturën organike të miratuar si dhe në nevojat për shpenzime të kushtëzuara nga vendndodhja e zyrave të AAPSK-së (në qendrën e biznesit "Tëin Toëers", bul. Dëshmorët e Kombit), për rrjedhoje disa shpenzime si: Ngrohja e zyrave; Mirëmbajtja e ambienteve te përbashkëta, etj. ishin të paracaktuara nga bordi i bashkëpronarëve te qendrës së biznesit dhe nuk mund të prokuroheshin. Shërbimi i Internetit furnizohej nga Ministria e Financave pa pagese. Shërbimi i ruajtjes së zyrave i përfshirë në çmimin e mirëmbajtjes.
- Me ndryshimin e ambienteve të zyrave të AAPSK-së, në adresën aktuale, shpenzimet e ngrohjes dhe mirëmbajtjes nuk ishin më të nevojshme, por nevojiteshin ato për ruajtjen e zyrave si dhe shërbimin e internetit.
- Mos plotësimi i vendeve vakante në strukturën e miratuar, nga ana e Departamentit të Administratës Publike gjate vitit 2016, ka sjellë në mosrealizimin faktik të zërave të planifikuar për Paga dhe Sigurime shoqërore (600, 601).
- Sa i përket tejkalimit të shpenzimeve gjyqësore në vitin 2016, sqarojmë se kjo ka ardhur si pasojë e bllokimit të vendimeve nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit përgjatë gjithë vitit 2015, duke rezultuar në pagesën gjatë vitit 2016 edhe të atyre vendimeve gjyqësore të cilat ishin planifikuar për tu paguar për vitin 2015.

Sa më lart, jemi të mendimit se nga ana jone programimi i zërave të buxhetit është bërë **real** (jo formal), por ndryshimi i rrethanave objektive (të sqaruara më sipër), ka sjellë edhe ndryshmet në zbatimin faktik të programit buxhetor, të pasqyruar në gjetjet e grupit te auditimit. Sidoqoftë, rekomandimi do të mbahet në vëmendje për planifikimin e periudhave të ardhshme.

7. Në lidhje me **Gjetjet nga auditimi mbi raportin e monitorimit** (faqe 71), dhe rekomandimin 1.3, ju sqarojmë se nga ana e AAPSK-së është hartuar çdo 4-mujor raporti i monitorimit për fondet buxhetore, duke plotësuar <u>të gjitha</u> tabelat, siç përcaktohen në Udhëzimin nr. 22, dt. 17.11.2016 të Ministrit të Financave. Duke qene se AAPSK, në baze të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 35, dt. 18.4.2017 *"Për përcaktimin e strukturës së programeve të shpenzimeve të ministrisë së financave dhe ekipeve të menaxhimit të tyre"* është përfshirë në Programin 6 "Lufta kundër transaksioneve financiar jo-ligjore", i cili drejtohet nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme te Parandalimit të Pastrimit të Parave, dërgon vetëm tabelat e plotësuara, ndërsa raporti përmbledhës për programin hartohet nga DPPPP-ja.

Sa i përket pjesës rekomanduese për hartim te raportit të monitorimit edhe për përdorimin e vlerave monetare nga llogaria "Të ardhura dhe shpenzime për administrimin e pasurive të sekuestruara / konfiskuara", shprehemi se nuk jemi dakord për arsye se:

ky monitorim është **i pamundur**, për sa kohe në nuk mund të planifikojmë paraprakisht sasinë e pasurive që do të sekuestrohen/ konfiskohen, apo revokohen gjatë vitit, e për rrjedhoje, as shpenzimet që do të kryhen për to. Gjithashtu, është e pamundur të behet një plan real mbi të ardhurat që do të realizohen nga administrimi i këtyre pasurive (Qira, interesa bankare). Pra, për sa kohë është i pamundur një planifikim real i shpenzimeve dhe të ardhurave për pasuritë e sekuestruar / konfiskuara edhe monitorimi i tyre do të ishte fiktiv.

8. Sa i përket rekomandimit nr. 1.4 (faqe 71), mbi administrimin e Fondit të posaçëm (Art. 604 "Transferta të brendshme", Ju sqarojmë se ndarja e këtij fondi sipas institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile përfituese, behet nga Ministri i Financave. Disbursimi i shumave përkatëse si dhe monitorimi i zbatimit të projekteve të financuar nga këto fonde, kryhet nga strukturat e AAPSK-se. Konkretisht, monitorimi kryhet nga një Grup pune i cili drejtohet nga Koordinatori i Terrenit, ndërsa pagesat në degën e Thesarit kryhen nga sektori Administrativ me ane të Urdhër Shpenzimeve të firmosura rregullisht nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues bazuar në dokumentacionin justifikues të dosjeve.

Pagesat nga dega e thesarit nuk kalohen pa paraqitur dokumentacionin shoqërues, i cili pasi vuloset nga specialistja e degës së thesarit, rikthehet në dosjen projektit deri në përfundimin e plote të tij. Theksojmë se, projektet e financuara nga Fondi i Posaçëm kanë një shtrirje kohore 6 deri në 12 muaj dhe pagesat kryhen të pjesshme, sipas fazave të zbatimi të projektit. Me realizimin e plote të projektit dhe disbursimin total të shumës së akorduar, dosja kalon në sektorin e financës.

9. Në lidhje me rekomandimin nr. 1.5 (faqe 73) mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, na duhet t'Ju sqarojmë se mbajtja e kontabilitetit dhe nxjerrja e bilancit nga ana jonë është kryer në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 27, dt. 23.9.2008, të Ministrit të Financave, Kreu IV[5].

Por, sa i përket propozimit tuaj për të përcaktuar mënyrën për mbajtjen e kontabiliteti dhe nxjerrjen e bilancit për aktivitetin e administrimit të pasurive, nga ana jonë do të kërkohet mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Përgatitur nga:
M.H., Administrator (koord. financiar)
E.D., Përgjegjës sek. Administrativ
E.H., specialiste finance

Në përfundim AAPSK, duke falënderuar grupin e auditimit në përgjithësi për punën e bere gjatë auditimit të institucionit tone, në vijim të takimit ballafaques me audituesit, kërkon marrje parasysh të observacioneve dhe përfshirjen e tyre në Raportin përfundimtar të auditimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYEADMINISTRATOR

A.K

Bashkelidhur Observacionet e bera nga secili Administrator i pasurive.

ANEX 1: OBSERVACIONET E Administratoreve të Pasurive

[5] 4. Agjencia mban në bilancin e saj shifrat e miratuara në planin e buxhetit të miratuar nga Ministri i Financave.
6. Të ardhurat dhe shpenzimet për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara evidentohen dhe mbahen jashtë bilancit të Agjencisë dhe raportohen sipas planit të raportimit të miratuar në planin vjetor të punës dhe buxhetit.
7. Vlerat monetare të sekuestruara/konfiskuara *cash* ose në numra llogarie të subjekteve do të mbahen dhe evidentohen jashtë bilancit të Agjencisë.

{Ref. 1, E.P}

Referuar PROJEKT RAPORTIT për auditimin e ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bazë të Programit të Auditimit nr. 999/3, datë 23.11.2017, protokolluar ne AAPSK nr. 1016/7 datë 24.11.2017 dhe referuar problematikave të ngritura nga ana juaj në paragrafet përkatës gjithashtu edhe të dhënave në tabelën e objekteve me qira për vitet 2016-2017 po ju paraqes observacionin si më poshtë vijon:

Referuar paragrafit "auditimi i dosjeve" pika 2 (faqja 27) *" Ministri i Financave sipas Urdhërit nr. 8, datë 10.03.2005, ka vendosur sekuestrimin e pasurisë " Zyra O5', në Laprakë , me sipërfaqe 70 m², në pronësi të fondacionit " Ringjallja e trashëgimisë Islame", edhe pse ka dalë masa e revokimit objekti vazhdon të jepet me qira nga AAPSK...*", ju bëjme me dije se për urdhrin nr. 8 datë 10.03.2005 i cili përfshin tre pasuritë e mëposhtme:

- Apartamenti A12 me sip. 76 m2, në U3E1 kati mexaninë;
- Zyra O5 me sip. 70 m2, në U3E1 kati mexaninë ;
- Zyra A13 me sip. 58 m2, në U3E1 kati mexaninë; nuk ka Urdhër revokimi.

Urdhri i revokimit nr. 7 datë 01.02.2013 përfshin Urdhrin nr. 2 datë 03.12.2004 I cili përmban pasuri të tjera të Kompleksit ....." jo të ....." pasi për tre pasuritë që unë administroj ekziston një kontratë shitje midis ....." dhe "....." duke bërë që pasuritë që unë administroj janë të sekuestruara.

Pasuritë e mësipërme i kam marrë në administrim në bazë të Urdhrit nr. 799 datë 04.10.2016. Sqarojmë se: **Zyra O5** – me destinacion "Ambient pune", në momentin e marrjes në administrim prej meje, ishte e dhëne me qira me kontratën nr. 404 datë 31.05.2016 me çmimin 10.000 lekë në muaj.

Referuar Paragrafit 2.3 " Zbatimi i procedurave të dhënies në përdorim të aseteve, dhënia me qira të objekteve si dhe administrimi i vlerave monetare nëpërmjet bankave." Fq/26, pika 2 (faqja 27) dhe pika 6 (faqja 29) ju sqaroj si më poshtë vijon:

-Me shkresën me nr. 410 datë 18.04.2017 kam kërkuar "ngritje komisioni" për pasurinë Zyra O5, një muaj përpara mbarimit të afatit të kontratës ekzistuese të vitit 2016. Në kushtet që qiramarrësi ka kryer investime në vlera të konsiderueshme në këtë pasuri *(demonstrim me foto si ka qenë dhe si është sot)* dhe faktit që kjo pasuri ka statusin " pasuri e sekuestruar", u pa e arsyeshme që të mos ngrihet "Komisioni për testim tregu" dhe të rinovohej kontrata me të njëjtin çmim prej 10000 lekë në muaj. Në lidhje me dhënien me qira të pasurisë në fjalë dhe referuar Vendimit Nr. 469, datë 3.6.2015 përkatësisht pika 3. 'për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1m² sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

(c) Për 1m² sipërfaqe për zyrë dhe magazinë, vlera minimale e qirasë mujore është e barabartë me vlerën minimale të qirasë mujore per 1m² sipërfaqe të apartamenteve të banimit, sipas zonave të Tiranës.

Për të gjitha pasuritë që kam në administrim , pra qira nën çmimin minimal, jam bazuar në:

VKM nr. 687/2011, kreu VI pika "ë" citohet:

"Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori"

Në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008 kreu III, pika 2, 2.1, 2.1.1, 2.3 citohet:

2. Procedurat e dhënies me qira ndjekin parimet e përgjithshme dhe ecurinë e tregut të lirë dhe janë si më poshtë:

2.1 Caktimi i çmimit të qirasë. Për caktimin e çmimeve të dhënies me qira kryeadministratori ngre rast pas rasti një komision për vlerësimin e tregut. Komisioni përbëhet nga administratori i pasurisë dhe 2 përfaqësues të AAPSK-së.

2.1.1 Komisioni bën vlerësimin e tregut duke u bazuar në:

- vlerësimin e ekspertit vlerësues, nëse ka të tillë,
- çmimet e aplikuara në zonën përreth pasurisë së sekuestruar,
- çmimet zyrtare për objekte të së njëjtës natyrë,
- kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.
2.3 Kontrata me çmim më të ulët sesa çmimi i vlerësuar. Në kushtet e mungesës së kërkesës së tregut për qiramarrje, administratori i pasurisë i kërkon kryeadministratorit të Agjencisë miratimin për aplikimin e çmimeve më të ulëta sesa çmimet e dhëna nga komisioni.
Kryeadministratori mund të miratojë çmime më të ulëta të qirasë ose mund t'i kërkojë Ministrit të Financave miratimin për dhënien me huapërdorje të pasurisë, duke i paraqitur argumentet përkatëse.
Të gjendur përpara fakteve të lartpërmendura komisioni pa të arsyeshme që këtë apartament t'ia linte me qira Z. E.B në vlerën 10000 lekë i cili u zotua në kërkesën e tij se do paguante të gjitha detyrimet që do rridhnin nga kontrata. Aktualisht pasuria në fjalë është e revokuar sipas vendimit **nr. 20 datë 23.06.2017**, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime Sa I përket paragrafit të fundit (faqja 23) cituar nga ana juaj *" në raportin e muajit gusht të administratorit të pasurive E.P nuk figuron vlera e përafërt e tregut e dy automjeteve të marra në administrim, ndërsa figurojnë në inventarin e përgjithshëm, duke bërë që të ketë një diferencë në vlerat me 1.2 milion lekë..."* , ju bëj me dije se është bërë një gabim në printim nga ana ime. Këto dy mjete I kam marrë në administrim në datën 05.06.2017 dhe në raportet qershor, korrik, shtator, tetor janë të pasqyruara.
Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj!
Bashkëlidhur do të gjeni:
- Kopje të shkresës nr. 799 Prot. datë 04.10.2016.
- Kopje të urdhërit nr. 8 datë 10.03.2005.
- Kopje të kontratës nr. 95 datë 29.01.2000.
- Kopje e urdhërit nr. 7 dhe 7/1 datë 01.02.2013.
- Foto të pasurive "zyra O5"
- Kopje të raporteve mujore.

{Ref. 2, A.B }
Referuar Projekt Raportit të Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në bazë të programit të auditivit nr. 999/3, datë 23.11.2017, protokolluar në AAPSK me nr. 1016/7, datë 24.11.2017 dhe referuar të dhënave në lidhje me paragrafin e dytë faqe 23, ku citohet raporti i administratorit A B po ju paraqes observacionin si vijon:

- Për sa i përket mos raportimin për pasurinë Garazh e shtetasit A.V.

Kjo pasuri ka statusin e konfiskuar me vendim te formës se prere. Për këtë ka dale urdhër i ministrit te financave për shitjen dhe është përgatitur dosja e shitjes e cila i është dërguar drejtoria e drejtimit të pronës publike. Pas shpalljes se ankandit nga ana e kësaj drejtorie nuk pati asnjë interes për blerjen e kësaj pasurie. kjo pasuri ka qënë ne administrim nga administrator kleant xholi. me urdhrin nr. 1012, datë 06.12.2017 të kryeadministratorit jam emëruar administrator i kësaj pasurie. me urdhrin nr. 41, datë 8.05.2017 të ministrit të financave nder te tjera është vendosur kalimi i kësaj pasurie në dispozicion të projektit c.a/.u.s.e të financuar nga bashkimi evropian.

- Me urdhrin nr. 25, datë 21.03.2017 të Ministrit të Financave **"Mënyrën e përdorimit te pasurive Vlera Monetare te Konfiskuara"** është urdhëruar kalimi ne Buxhetin e shtetit te pasurive Vlerave Monetare te konfiskuara ne shumen prej 456,845,026,85 leke sipas tabelës bashkangjitur. Pjese e kësaj tabele janë dhe llogarite bankare te shtetasit K.I. si dhe llogarite e

shtetasve H. dhe E.M.. Kalimi i këtyre fondeve ne buxhet te shtetit ka sjelle edhe uljen e vlerave te përafërta te tregut ne raportin përmbledhës.

- Per sa i takon vlerave te përafërta te tregut për pasuritë 6/266+2-14 dhe 17/45+1-25 ju sqaroj si me poshtë:

Këto pasuri si dhe disa pasuri te tjera janë sekuestruar me vendimin Nr. 22, datë 12.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe janë mare ne dorëzim ne datat 14 dhe 15 Shtator 2017 prandaj ka qene e pa mundur nxjerra e vlerave te tregut për pasuritë e me sipërme ne fund te muajit Gusht. Per pasurite e tjera te cilave ju eshte nxjere vlera e tregut eshte bere ne baze te vendimit te gjykates i cili ne pjesen arsyetuse te tij kishte edhe cmimet e blerjeve te ketyre pasurive.

- Per sa ju perket pasurive te pa mara ne dorëzim ju sqaroj se:

1. Pasuria e paluajtshme nr. 152/6 e shtetasit R.F. Me urdhrin Brendshem nr 528, datë 04/07/2016 jam caktuar administrator për kete pasuri. Kjo pasuri me vendimin nr. 2 date 16. 01.2014 eshte vendosur sekuestrimi dhe pezullimi i mases se sekuestros. Per kete pasuri kemi kërkuar disa here informacion Gjykatës për Krimet e Rënda si dhe Prokurorisë por nga ana e tyre nuk ka asnjë kthim përgjigje. Gjithashtu i kemi dërguar disa shkresa Zyrës se Përmbarimit Gjyqësor Durrës për ekzekutimin e këtij vendimi por deri tani nuk ka patur reagime.
2. Dy llogari bankare ne emer te shtetasit I.M. Me urdhrin Brendshem nr 528, datë 04/07/2016 jam caktuar administrator për keto llogari. Jane derguar disa shkresa Zyres se permbnarimit Gjyqesor Tirane per ekzekutimin e këtij vendimi por nga ana e kësaj zyre nuk ka patur asnjë reagim duke bere te pa mundur marjen ne dorëzim te ketyre llogarive.
3. Dy automjete ne emer te shtetasit I.M. Me urdhrin Brendshem nr 528, datë 04/07/2016 jam caktuar administrator i ketyre automjeteve. Jane derguar disa shkresa Zyres se permbnarimit Gjyqesor Tirane për ekzekutimin e këtij vendimi por nga ana e kësaj zyre nuk ka patur asnjë reagim duke bere te pa mundur marjen ne dorëzim te ketyre automjeteve.

- ..... Me vendimin nr. 21, datë 10.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është vendosur heqja e masës së sekuestros per kete pasuri. Ky vendim është ekzekutuar me date 7.08.2017 si pasoje eshte hequr edhe nga inventari i pasurive te AAPSK-se.

{Ref. 3, E.O }

Referuar Projekt Raportit te Auditimit, në Agjencinë e Pasurive të Sekuestrura dhe Konfiskuara në bazë të Programit të Auditimit nr. 999/3, datë 23.11.2017, protokolluar ne AAPSK nr.1016/7datë 24.11.2017, në objektet e paraqitura, në tabelën e objekteve me qira viti 2016 rreshti 7 (shtatë) dhe në tabelën e objekteve me qira viti 2017 rreshti 12 (njëmbëdhjetë) të cilat janë listuar në administrimin tim dhe per të cilat ndjej të nevojshme të sqaroj se:Ku është konstatuar gabim

-Objekti i vendosur në tabelën e vitit 2016 në rreshtin e 7 (shtatë) me qiramarrës zotin A.K nuk ka të bëjë me objektin 3-katësh në fshatin Rreth Shijak me sip. 453 m2 me çmim qiraje mujore 1200 lekë në muaj siç është përcaktuar në këtë tabelë por lidhet me kontraten ***nr. 540/1, datë 22.09.2015*** për dhënien me qira të objektit ndërtesë 1 – katëshe me dy dhoma gjumi, aneks banjo dhe kuzhinë me sipërfaqe 98 m2 po në fshatin Rreth, me qiramarrës po zotin A.K. Kjo kontratë ka zgjatur deri në momentin e revokimit të kësaj pasurie dhe kthimin e saj zonjës D.K me vendimin nr. 8, datë 14.06.2015 të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë protokolluar në AAPSK më datë 23.06.2016.

Bashkëlidhur:

a) Kontrate nr. 540/1, datë 22.09.2015 kopje;
b) Kërkesë për marrje me qira nr.540 Prot, datë16.09.2015 kopje;
c) Kontratë nr. 617 Prot. datë 28.06.2017 kopje;
d) Foto të objektit Rreth Shijak me sip 453 kopje;

e) Procesverbal testim tregu objekti 453 Rreth, Shijak;

- **{Ref. 4, B.I. }**

Referuar Projekt Raportit të Auditimit, mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në bazë të Programit të Auditimit nr. 999/3, datë 23.11.2017, protokolluar në AAPSK nr. 1016/7 datë 24.11.2017 dhe referuar të dhënave në lidhje me pikën 2.2 fraksion 7 (faqja 25), ku citohet se nuk rezultojnë të marra 3 llogari bankare pranë Intesa San Paolo Bank, në emër të shtetasve R.R., M.G. dhe R .G. po ju paraqes observacionin si vijon:
Bazuar në Ligjin 10192, datë 03.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"*, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 3, datë 10.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, është vendosur masa e sekuestros mbi shumat monetare të shtetasve M.G, S.R, R.G., të përbërë prej:

- **Shumës 310.000 (treqind e dhjet mijë) Euro**, që ndodhen në bankën Intesa San Paolo Group, në llogarinë e shtetases R.R. e datëlindjes 21.06.1977.
- **Shumës 500 (pesëqind) Euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër 95212135101, në bankën Intesa San Paolo Group.
- **Shumës 2000 (dy mije) Euro**, në emër të shtetasve R.G dhe S.G., në llogarinë me numër 95179435101, në bankën I.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur:
"Pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokim apo shuarje të masës së sekuestros preventive".
Sipas vendimit nr. 19 datë 07.10.2014, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë vendosi :
"Zgjatjen e afatit për një periudhë tremujore të masës së sekuestrimit, vendosur me vendimin nr.03 datë 10.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda,Tiranë".
Referuar shkresës sonë nr. 306 Prot. datë 26.03.2014 drejtuar zyrës së Përmbarimit Tiranë, kemi kërkuar ekzekutimin e vendimit nr. 03 datë 10.03.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda,Tiranë.
Referuar shkresës nr. 2246 Prot. datë 02.04.2014 të Zyrës së Permbarimit Tiranë, kërkuar protokolluar me tonën nr. 341 datë 08.04.2014, na informon që ka urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros konservative në llogaritë e palës debitore.
Referuar Urdhërit të Brendshëm nr. 470, datë 21.06.2016 jam emëruar administratore e llogarive bankare të mësipërme.
Referuar shkresës sonë nr. 685 Prot. datë 30.08.2016 drejtuar Prokurorit të çështjes per dijeni Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kemi kërkuar informacion në lidhje me vazhdimësin e vendimit Gjyqësor Penal, në lidhje me sekuestron preventive.
Gjatë kësaj periudhe kam vajtur disa herë ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda Tiranë, për të marrë informacion nga prokurori i çështjes dhe asnjëherë nuk ka qenë në institucion kur unë shkoja për ta takuar, ndërkohë edhe punonjësit nuk jepnin numrin e telefonit, nga komunikimi me prokurorë të tjerë më thonin që ty ke bërë një shkresë, pra prit përgjigjen e shkresës.
Referuar shkresës sonë nr. 180/2 Prot. datë 24.02.2017 drejtuar Prokurorit të çështjes per dijeni Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kemi kërkuar përsëri informacion nëse ka rënë apo jo pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 03 datë 10.03.2014.
Edhe pas kësaj shkrese nuk kemi pasur përgjigje nga prokuroria.
Pas insistimit nga unë si administratore e këtyre vlerave monetare, më në fund unë arrita të takoj prokurorin e çështjes, dhe kërkoi që unë ti dërgoja përsëri shkresë jo prokurorit por Gjykatës së Shkallës së Parë për tëv marrë informacion në lidhje me pasuritë e mësipërme.

Referuar shkresës sonë nr. 955 Prot. datë 24.10.2017 drejtuar Prokurorit të çështjes dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kemi kërkuar **përsëri** informacion nëse ka rënë apo jo pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 03 datë 10.03.2014.
Referuar shkresës nr.1302 Prot. datë 30.10.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, protokolluar me tonën nr. 955/1 datë 31.10.2017, kjo gjykatë na informon në lidhje me vendimin nr. 16 datë 27.07.2015 në të cilin ka vendosur:

- Pushimin e gjykimit të kërkesës nr. 5/32 regjistri themeltar datë 31.12.2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda,Tiranë", me objekt: "Konfiskimin e shumave monetare të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G.".
- Revokimin e masës së sekuestros mbi shumat monetare të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G, dhe konkretisht të :
  - **Shumës 310.000 (treqind e dhjet mijë) Euro**, që ndodhen në bankën Intesa San Paolo Group, në llogarinë e shtetases R.R., e datëlindjes 21.06.1977.
  - **Shumës 500 (pesëqind) Euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër 95212135101, në bankën Intesa San Paolo Group.
  - **Shumës 2000 (dy mijë) Euro**, në emër të shtetasve R.G. dhe S.G., në llogarinë me numër 95179435101, në bankën Intesa San Paolo Group.

Gjithashtu kancelari i kësaj gjykate në shkresën përcjellëse na ka cituar që:" Sipas urdhërit të Gjykatës , ky vendim i është komunikuar vetëm zyrës së Permbarimit Tiranë, dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda.
Referuar shkresës sonë nr. 971 prot. datë 02.11.2017 drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë, kemi kërkuar :
"Në zbatim të VKM-së nr. 563, date 14.07.2010 *"Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave të Hollësishme të Bashkëpunimit të Shërbimit Përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara"* Kreu i I- rë *pikat 1;2; dhe 3,* po ju **kërkojmë caktimin e datës dhe marrjen e masave në lidhje me procedurat e zbatimit** të Vendimit nr. 16, datë 27.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë.
Bazuar ne nenin 28 të Ligjit 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", *ku citohet:"**Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara**", ju lutemi që : "Data e ekzekutimit të vendimit të revokimit të kryhet pas datës 15.11.2017".*
Referuar shkresës sonë nr. 971 prot. datë 02.11.2017 drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë, kemi kërkuar :
*"Në zbatim të VKM-se nr. 563, date 14.07.2010 "Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave të Hollësishme të Bashkëpunimit të Shërbimit Përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara" Kreu i I- rë pikat 1;2; dhe 3, po ju **kërkojmë caktimin e datës dhe marrjen e masave në lidhje me procedurat e zbatimit** të Vendimit nr. 16, datë 27.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë.*
*Bazuar ne nenin 28 të Ligjit 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", ku citohet:"**Vendimi i revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara**", ju lutemi që : "Data e ekzekutimit të vendimit të revokimit të kryhet pas datës 15.11.2017".*
Referuar shkresës nr. 971/2 Prot. datë 15.11.2017 drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë, ka bërë kërkesë të përsëritur në lidhje me caktimin e datës për të ekzekutuar vendimin nr.03 datë 10.03.2014.
Referuar shkresës nr. 10236 Prot. datë 21.11.2017 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë , protokolluar me tonën nr. 971/3 Prot. datë 30.11.2017, Zyra e permbarimit Tiranë kërkon

prezencën e AAPSK-së me datë 30.11.2017 ora 13:00 në Intesa San Paolo për të ekzekutuar vendimin nr. 03 datë 10.03.2014.
Referuar e-mailit zyrtar datë 30.11.2017 Përmbaruesi L.Ll. na informon që ka kontaktuar me punonjësin e bankës ISP, I cili e ka informuar se vendimi është ekzekutuar, pra ISP do ta njoftojë me shkresë zyrtare përmbaruesin dhe përmbaruesi do të vendosë në dijeni të shkresës edhe AAPSK.
Referuar e-mailit të dërguar nga AAPSK drejtuar përmbaruesit L.LL, në përgjigje të e-mailit kam kërkuar të caktojë një datë për të mbajtur process-verbal në ISP dhe për të konstatuar arsyet se si është ekzekutuar një vendim pa prezencën e përmbaruesit dhe administratorit të pasurisë, në mënyrë që të jemi të qartë për hapat që do të ndiqen.
Jemi në pritje të një përgjigjeje nga Zyra e përmbarimit Tiranë.
Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj,
Bashkëlidhur do të gjeni:
- Kopje të shkresës nr. 306 Prot. datë 26.03.2014 .
- Kopje të shkresës nr. 2246 Prot. datë 02.04.2014.
- Kopje Urdhërit të Brendshëm nr. 470, datë 21.06.2016
- Kopje të shkresës nr. 685 Prot. datë 30.08.2016
- Kopje të shkresës nr. 180/2 Prot. datë 24.02.2017 .
- Kopje të shkresës nr. 955 Prot. datë 24.10.2017.
- Kopje të shkresës nr. nr.1302 Prot. datë 30.10.2017 .
- Kopje të shkresës nr. 971 prot. datë 02.11.2017.
- Kopje të shkresës nr. nr. 971/2 Prot. datë 15.11.2017.
- E-maili i dërguar nga permbaruesi me date 30.11.2017.
- Kthim - përgjigje e-mailit drejtuar përmbaruesit.

{Ref. 5, B.B }

Në projekt Raportin e paraqitur me keqardhje konstatoj se nuk është marrë parasysh,asgjë lidhur me observacionin e parë.
Për sa më siper ju kërkoi dhe insistoi në pasqyrimin real e të vertetë të ketij vlersimi nga ana juaj.
Së pari ju bëjë me dije se është lehtësisht e kontrollueshme, jo vetem nga procedurat e ndjekura, por edhe nga verifikimi konkrete i kësaj procedure.
Në pikën 1 faqe 27 të projekt raportit thuhet se:
Kryeadministratori ka nxjerrë Urdhërin e Brënshëm nr 478/2 date 05.05.2017 "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të cmimeve të tregut për pasuritë e konfiskuara". Komisioni ka propozuar që cmimi për truallin me sipërfaqe 4500m2, të jetë 15000 leke/muaj… duke vazhduar që cmimi i llogaritur sipas VKM-së nr.469,datë 03.06.2015 duhet te ishte 215.055 lekë/muaj.
Sa më siper ju bëjmë me dije se:
Nuk është dhënë me qira trualli prej 4500 m2 dhe aktualisht nuk mund të jepet kjo siperfaqe me qira, pasi në këtë truall janë parkuar të gjitha automjetet e shoqërisë si dhe makinerit e paisje të ndryshme. Me qira është dhënë gropa për riparimin e automjeteve(vendriparimi , e cila ndodhet në siperfaqen e këtij trualli.
Proçedurat që janë ndjekur për dhëniën me qira të vendriparimit të automjeteve dhe jo truallit 4500m2 sic paraqitet ne projekt raportin e duket qartë si më poshtë:
1-Në urdherin e Brenshem nr. 478/2 date 05.05.2017 shprehet:
Ngritja e komisionit për vlerësimin e cmimeve të tregut të qiradhënies **për pasurinë '' vendriparim e parkim'',** të pasurise së paluatshme nr 7/248,ZK8533, vol 19 ,faqe 105 truall me siperfaqe 4500m2 në pronësi të zonjës M.C.(bashkëngjitur urdhërin e brënshëm)

2-Në kërkesën e Z. R.S shprehet:
Shpreh interesim për të marrë me qira një pjesë në këtë **objekt vendriparimin e automjeteve** dhe parkim për mbajtjen automjetit. **(bashëngjitur kërkesën e bërë)**
3-Në kërkesën për ngritje komisioni shprehet:
Referuar kërkesës nr 478 dt. 05.05.2017 te Z. R.S i cili ka shprehur interesin për marrjen me qira të një pjese të objektit të mësipërm(**vendriparimin e parkim automjetesh**)…Në kushtet kur nuk kemi pasur asnjë kërkesë për marrjen me qira të objektit,mendoj që shfrytezimi qoftë edhe i kësaj pjese do të sjellë të ardhura për AAPSK. (bashkëngjitur kërkësa për ngritje komisioni)
4-Testimi i tregut
Komisioni është shprehur se Cmim qiraje për shfrytezim vendriparimi të automjeteve nuk ka përreth zonës së studimit nga komisioni. Vendriparimi është model i vjetër me gropë dhe i pambuluar.(bashkë ngjitur foton dhe materialin e testimit të tregut)
5-Kontratë qiraje.
Në kontratën e qirasë prot.nr484,datë 08.05.2017 ne piken 1 Hyrjë thuhet:
Kërkesa për marrjen me qira është pjesë në këtë truall**, vendriparim e parkim**.
(bashkë ngjitur kontrata e qirasë)

{Ref. 6, E.B }
Observacion: Mbi PROJEKT RAPORTIN për auditimin (faqja 24, pika 1, 2 dhe 3) shikoj të arsyeshëme disa sqarime mbi çmimin e dalë të qirasë për pasurinë:
Pronë truall me sipërfaqe 500 m^2, ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3184, me nr. Pasurie 8/17,me adresë Rinia, Durrës,së bashku me një objekt Bar – Restorant me sip. 130 m^2, i cili është ndërtuar pranë kësaj sipërfaqe toke.

Objekti: Auditimi i zbatimit të procedurave të dhënies me qira të objekteve

1-Baza ligjore
Në përputhje me ligjin 10192/209 ndryshuar me ligjin 70/2017 neni 16 pika 1 citohet:
"Administratori ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu, ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive"
Në përputhje me VKM 687/2011, kreu VI pika "ë" citohet:
"Në rastet e dhënies me qira të pasurive të sekuestruara, kryeadministratori ngre komisionin për vlerësimin e çmimit të tregut. Nëse është e pamundur dhënia me qira me çmimin e tregut, me propozimin e administratorit të pasurisë, çmimi i qirasë mund të negociohet nga kryeadministratori"
Në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008 kreu III, pika 2, 2.1, 2.1.1, 2.3 citohet:
2. Procedurat e dhënies me qira ndjekin parimet e përgjithshme dhe ecurinë e tregut të lirë dhe janë si më poshtë:
2.1 Caktimi i çmimit të qirasë. Për caktimin e çmimeve të dhënies me qira kryeadministratori ngre rast pas rasti një komision për vlerësimin e tregut. Komisioni përbëhet nga administratori i pasurisë dhe 2 përfaqësues të AAPSK-së.
2.1.1 Komisioni bën vlerësimin e tregut duke u bazuar në:
- vlerësimin e ekspertit vlerësues, nëse ka të tillë,
- çmimet e aplikuara në zonën përreth pasurisë së sekuestruar,
-çmimet zyrtare për objekte të së njëjtës natyrë,
- kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhet pasuria.

2.3 Kontrata me çmim më të ulët sesa çmimi i vlerësuar. Në kushtet e mungesës së kërkesës së tregut për qiramarrje, administratori i pasurisë i kërkon kryeadministratorit të Agjencisë miratimin për aplikimin e çmimeve më të ulëta sesa çmimet e dhëna nga komisioni.
Kryeadministratori mund të miratojë çmime më të ulëta të qirasë ose mund t'i kërkojë Ministrit të Financave miratimin për dhënien me huapërdorje të pasurisë, duke i paraqitur argumentet përkatëse.

2- Proçedurat
Kjo pasuri si shumë të tjera në AAPSK mbart problemet e veta.
Pas shumë kontakteve dhe shkresave me Përmbaruesin për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda, pasi vetë Përmbaruesi shprehte shënja frike për ekzekutimin e këtij vendimi.
Pas marjes në dorzim të pasurisë është formuluar një relacion mbi testim tregut me nr 25, datë 26.01.2011, nga i cili kmisioni i asaj kohe doli në një vlerë prej 25.000 lekë në muaj.
Për vite me rradhë kjo pasuri kishte vetëm shpenzime për ruajtjen fizike. Amortizimi i shpejtë që po pësonte nga shkaqet natyrore pasi shpesh herë uji i detit e përmbyt lokalin dhe kripa grryen cdo pjesë të tij. Materiali prej gipsi që përbën pjesën më të madhe të lokalit kishte filluar të shkëputej pjesë pjesë.
U mendua se duke ulur cmimin qoftë ky edhe minimal, do të reduktoheshin shpenzime të tepërta duke qënë se praktika na ka treguar se vendimet e Gjykatave zgjasin shumë dhe problematikat e pasurive që dalin deri në fazat e revokimit ose të rastit aktual konfiskimit dhe kalimit në shtet janë nga më të shumtat dhe më të ndryshmet.
Duhet theksuar se ky objekt ne maksimumin e tij punon vetëm 2 muaj në vit, muajt e tjerë rrinë i mbyllur. Aktualisht lokali është i mbyllur. Mund të vërtetoh lehtësisht.

3- Disa nga shumë shkaqe të tjera, që komisioni ka dalë në çmimin aktual
1.Kjo pasuri është pronë e një nga bandave më të rrezikshme të Durrësit, pasuri e tre vëllezërve të vrarë. Një lokal në periferi të Durrësit.
2.Rruga që të dërgon në këtë pasuri deri vonë ka qënë e prishur dhe në pamundësi për të kaluar automjetet. Shkaqet grryerja e rrugës nga uji i detit. (foto)
3.Pasuria nuk ka as paisjet minimale për një fuksionim normal për vetë fuksioni që ka ky

4.Kontrata që AAPSK aplikon me qiramarrësit ka një pikë ku thotë se. Kontrata prishet automatikisht nese me vendim Ghykate pasuria revokohet dhe i kthehet pronarëve të tyre.
5.Të interesuarit duhet investojnë një shumë të madhe për vënien në punë të saj.
6.Largohen të interesuarit sapo vihen në dijeni se kjo pasuri i përket personave me rekorde kriminale.

4-Konkluzioni
Në vitin 14.10.2013 pranë AAPSK u paraqit një kërkesë për marje më qira. Në këto kushte vetë ligji parashikon nxjerrjen e të ardhurave kur është e mundur. Me negocimin e Kryeadministratorit të asaj kohe u vendos ulja e cmimit në 10.000 lekë në muaj. Shpesh herë qiramarrësit kan patur probleme dhe konflikte me familjarët e pasurisë. Në disa raste edhe nga persona të panjohur kan patur kërcënime dhe prishje të investimit të tyre. Keto arsyje kanë sjellë edhe largimin e tyre dhe tëhqjen nga ky biznes. AAPSK shpesh herë është treguar elastike me qëllim mos largimin e qiramarrësve pasi kjo do rriste në mënyrë të ndjeshme shpenzimet.
Duhet theksuar se ky objekt ne maksimumin e tij punon vetëm 2 muaj në vit, muajt e tjerë rrinë i mbyllur. Aktualisht lokali është i mbyllur. Mund të vërtetohet lehtësisht.

{Ref. 7, S.M }

Observacion mbi Projekt- Raportin e Auditimit Protokolluar me nr.1016/7, datë 24.11.2017 të A.A.P.S.K-së.

❖ ***Pasuria: Zyra Z O5 me sip.70 m2, në U3E1 kati mexaninë me adresë: Rruga e Durrësit, kompleksi "....", Laprak, Tiranë ,në pronësi të fondacionit "....." sekuestruar në bazë të urdhërit nr.8,dt.10.03.2005 (e cituar në fq.28).***

Kjo pasuri është marrë në administrim nga A.A.P.S.K-ja më datë 03.06.2011.

Në proçes-verbalin e komisionit për vlerësimin e çmimeve të tregut me nr.1117,datë 20.07.2011, në bazë të sondashit të zonës ku ndodhet objekti, zonës përreth dhe njoftimeve në gazetën çelësi bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008, ka propozuar që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira të pasurisë së sipërcituar, të jetë 15 000 - 20 000 lekë në muaj. Është bërë publikimi në faqen e njoftimeve.com, dhe afishimeve në pjesët e objektit me çmim 20 000 lek/muaj,si dhe nr.i kontaktit të administratorit të pasurisë.

Bashkëlidhur Obsevacionit kopje të proçes-verbalin me nr.1117,datë 20.07.2011 si dhe publikimi i njoftimit.

Ju bëjmë me dije se nga momenti i marrrjes në administrim (datë 03.06.2011 deri më datë 19.03.2014, datë e cila përkon me kërkesën e shprehjes së interesit për marrjes me qira të pasurisë së sipërcituar nuk ka pasur kërkesa (shprehje interesi). Ndodhur para këtij fakti referuar kërkesës së qirasë nr.296 prot.datë 19.03.2014 të depozituar pranë AAPSK-së (bashkëlidhur Obsevacionit kopje), është bërë relacion nga Administratori i pasurisë,drejtuar Koordinatorëve dhe Kryeadministratorit i miratuar prej tyre (Relacioni nr.296/1 prot.datë 22.04.2014 bashkëlidhur Obsevacionit kopje), mbi dhënien me qira,arsyet e dhënies me qira, duke propozuar që çmimi i qirasë të jetë 10 000 lekë/muaj.

Përsa i përket vonesave të pagesave të qirasë në afat ju bëj me dije se qiramarësi bënte lëvizje të shpeshta për arsye pune si jashtë tiranës ashtu edhe jashtë vëndit.Ndodhur në këto kushte i kam telefonuar qiramarësit duke i kërkuar kryerjen e menjëhershne të pagesave.Qiramarësi më ka pohuar se në pamundësi të kohës së kryerjes së pagesave duke qenë se ndodhem jashtë për arsye pune të më mundësosh kryerjen e pagesave të cilat do ti sjell nëpërmjet ekonomistes. Të ndodhur para këtij fakti në cilësinë e administratorit të pasurisë është parë e aresyeshme arkëtimi i pagesave për muajt e pa paguar.Përsa i përket rilidhjes së kontratës, nisur nga fakti i sipërcituar që kjo pasuri ishte pa qera nga viti 2011 deri në vitin 2014,qiramaresi ka investuar duke i ngritur vlerën pasurisë është parë e arësyeshme rilidhja e kontratës,duke eleminuar shpenzimet që do të bëheshin në pasuri si,shpenzime mirëmbajte,pagesa uji dhe energjie(tarifa shërbimi) etj.

Efektet negative nga mosdhënia me qira:

- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.),
- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:

- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

❖ ***Ambient shërbimi, me sipërfaqe 175 m2, me adresë në Rrugën e Kavajës, ish parku.Sekuestruar me vendimin nr.13,datë 27.06.2016,ne emer të debitorit M.F.(e cituar në fq.28).***

Si rezultat i korespondencave shkresore të përsëritura me përmbaruesin gjyqësor kjo pasuri është marrrë në administrim nga A.A.P.S.K-ja më datë 23.12.2017.

Komisioni për vlerësimin e çmimeve të tregut në bazë të kërkesës për ngritjen e komisionit, vizitoi objektin dhe vërejti se ambienti është bosh.Nga informacioni i marrë ky ambient ka qenë pa aktivitet për një kohë të gjatë. Ka detyrime të ujit dhe energjisë të pa paguara në shuma të konsiderueshme(të mbartura para marrjes në administrim)për të cilën janë ndjekur proçedurat mbi Aplikimin e Akt-marveshjes me OSHE-në mbi pagesën me 12 këste të detyrimit të energjisë.Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme(statusin e sekuestruar) me pasuritë.Për sa më sipër cituam komisioni bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008, propozoi që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira për pasurinë e mësipërme të jetë 25 000 lekë/muaj.

Efektet negative nga mosdhënia me qira:

- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),
- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.),
- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:

- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

Përsa i përket pagesës së qirasë +garancisë së muajit të pare qiramarësi e kishte të pamundur pagesën për arsye familjare.Në cilësinë e administratorit të pasurisë më është kërkuar nga ana e qiramarësit z.K.Z për arsyet e tij familjare që të kryehet pagasa.

❖ ***Ambient shërbimi me sipërfaqe 133 m2, me adresë: Rruga "Jordan Misja", Tiranë,ne emer të debitorit M.F. (e cituar në fq.29).***

Komisioni për vlerësimin e çmimeve të tregut në bazë të kërkesës për ngritjen e komisionit, vizitoi objektin dhe vërejti se brënda objektit ndodhen një aneks ku tavani është i dëmtuar,Ambienti është bosh.Nga informacioni i marrë ky ambient ka qenë pa aktivitet për një kohë të gjatë. Ka detyrime të ujit dhe energjisë të pa paguara (të mbartura para marrjes në administrim) për të cilën janë ndjekur proçedurat mbi Aplikimin e Akt-marveshjes me OSHE-në mbi pagesën me 12 këste të detyrimit të energjisë.Ambienti ndodhet në fund të pallatit , e cila mbyllet me një derë duralumin. Ky fakt është i dukshëm nëpërmjet fotove.(bashkëlidhur foto) . Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme(statusin e sekuestruar) me pasuritë.Për sa më sipër cituam komisioni bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008, propozoi që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira për pasurinë e mësipërme të jetë 16 000 lekë/muaj.

Efektet negative nga mosdhënia me qira:

- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),
- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.),

- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:

- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

❖ ***Apartament, me sipërfaqe 69.6 m2, me numër pasurie 5/56+1-64, zona kadastrale nr.3126, ndodhur në Shëngjin, Lezhë ,sekuestruar me vendimin nr.13,datë 27.06.2016,ne emer të debitorit M.F. (e cituar në akt në fq.5.pika 8). Apartament, me sipërfaqe 49.3 m2, me numër pasurie 5/56+1-63, zona kadastrale nr.3126, ndodhur në Shëngjin, Lezhë, sekuestruar me vendimin nr.13,datë 27.06.2016,ne emer të debitorit M.F (e cituar në fq.30).***

Komisioni për vlerësimin e çmimeve të tregut në bazë të kërkesës për ngritjen e komisionit, vizitoi objektin dhe vërejti se apartamentet janë përbri njëra tjetrës, të lidhura me njëra tjetrën nëpërmjet koridorit të përbashkët, e cila mbyllet me një derë duralumin.Nga kontaktet me administratoret e pallateve, rojet e objekteve u konstatua se apartamentet jepen me qira në sezonin e pushimeve dhe konkretisht në muajt korrik-gusht.Qiratë zakonishtë varjojnë nga 2 000 – 3 000 lekë/nata, kjo në vartësi të pozicionit dhe mobilimit (akomodimit) të ambientit.Apartamentet që ndodhen në këtë zonë në përgjithësi janë të mbyllura ,të cilat funksionojnë vetëm për periudhën e sezonit të verës (pushimeve verore). Ky fakt është i dukshëm nëpërmjet fotove.(bashkëlidhur fotot). Për sa më sipër cituam komisioni bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008, propozoi që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira për pasurinë e mësipërme me sip. 69.6 m2,të jetë 8 000 lekë/muaj. dhe per pasurin me sip. 49.3 m2 te jetë 7 000 lek/muaj.eshte bere publikimi në gazeten çelesi(bashkelidhur kopje).

Persa i perket pagesave të cituara në datat 11.04.2017 ne shumen 840 lek,04.05.2017 ne shumën 2,250 leke,26.05.2017 ne shumen 9,650 leke,28.06.2017 ne shumen 15.000 leke. Ju bëjme me dije se dy pasuritë e sipercituara kane pasur detyrime te papaguara energji dhe uji ne shumat 16 358 leke energji dhe 23 041 leke ujë.Ndodhur para ketij fakti qiramaresi ka bëre pagesen e detyrimeve dhe nuk ka derdhur qirane per periudhen 20.03.2017- 31.03.2017,muajin prill 2017 dhe muajin maj ka derdhur diferencen e ngelur nga pegesat e ujit dhe dritave ne shumen7,389 leke. Pagesat 840 lek, 2,250 lek,jane pagesa tatimi ne burim.Pagesa 9,650 = 2 250 tatimqeraje + 7,389 qera.Pagesa 15.000 leke pagese e muajit qershor 2017. Në mënyre analitike do te gjeni relacionin shpjegues nr.283/4 prot.date 08.05.2017 nga administratori i pasurisë drejtuar koordinatoreve dhe kryeadministratorit,(bashkelidhur observacionit kopje).

Efektet negative nga mosdhënia me qira:

- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),
- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.),
- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Qiramarësit kanë kontrata afat gjata,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:

- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

❖ ***Ambient shërbimi me sipërfaqe 56.84 m2, ndodhur në Orikum, Vlorë. Ambient shërbimi me sipërfaqe 78.66 m2, ndodhur në Orikum, Vlorë. sekuestruar me vendimin nr.13,datë 27.06.2016,ne emer të debitorit M.F e cituar në faqen 31 (tabela e objekteve me qira 2016-2017)***

Komisioni për vlerësimin e çmimeve të tregut në bazë të kërkesës për ngritjen e komisionit, vizitoi objektin dhe vërejti se,
- Qiramarrësit në këtë zonë janë me kontrata afatgjata dhe nuk kanë probleme me pasuritë që banojnë, ndërsa pasuritë në fjalë ka statusin "e sekuestruar" dhe marrëdhëniet kontraktuale janë një vjeçare.
- Puna (Ofrimi i shërbimeve) në këtë zonë është në periudhën e pushumeve verore.
- Objekti ndodhet në peroiferi të Orikumit i aneksuar.(Bashkëlidhur fotot)
-Ambientet e shërbimeve që ndodhen në këtë objekt janë të mbyllura.Sipas informacionit të marrë nga banorët këto ambiente funksionojnë vetëm sezonin veror.

Objekti është marrë me qira sipas kontratës nr.99 rep.nr.24/1koleksioni datë 10.01.2014, me qiradhënës z.M.F dhe qiramarës z.D.R..Në kontratë ndër të tjera citohet: " Njësitë e shërbimit të treguara më sipër janë të lidhura me njëra tjetrën dhe qiradhënësi z.M F ia jep me qira qiramarësit z.D.R.". Kjo kontratë është lidhur për një periudhë tre vjeçare nga data 09.01.2014 deri 08.01.2017.Vlera e qirasë mujore është 10 000 (dhjetë mijë) lek/muaj .Sa më siper komisioni bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008,propozoi që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira të ambientit të mësipërm të jetë 10 000 – 12 000 lek/ muaj**.**

Efektet negative nga mosdhënia me qira:
- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),
- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.)**,**
- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Ambientet jepen me qira vetem në sezonin e pushimeve verore,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:
- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

❖ ***Apartament me nr.pasurie 1056,me sipërfaqe 87.425m2,në emër të ".....".sh.p.k,kati i tretë, Shëngjin, Lezhë, sekuestruara me Vendimin nr. 17, datë 02.08.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në emër të shtetasit A.N. (e cituar në fq.30).***

Komisioni për vlerësimin e çmimeve të tregut në bazë të kërkesës për ngritjen e komisionit, vizitoi objektin dhe vërejti se nga konstatimi fizik rezultoi se në këtë apartamente kishte banues me qira.Ky fakt është konstatuar më datë 24.09.2016 në procesverbalin e veprimeve përmbarimore, të cilë duke qenë se punojnë në ndertime në zonën e Shëngjinit, kanë shprehur interesin për marrjen me qira si apartamente banimi
- Puna në këtë zonë është në periudhën e pushumeve verore.
-Apatamentet që ndodhen në këtë objekt janë të mbyllura.Sipas informacionit të marrë nga banorët këto ambiente funksionojnë vetëm sezonin veror. Qiratë zakonishtë jepen nga
2 000 – 3 000 lekë/nata, kjo në vartësi të pozicionit dhe mobilimit (akomodimit) të ambientit. Sa më siper komisioni bazuar dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 23.09.2008, propozoi që çmimi që mund të aplikohet në rast të dhënies me qira të ambientit të mësipërm të jetë 8 000 lek/ muaj**.**

Efektet negative nga mosdhënia me qira:
- Shpenzimet për pagesat e energjisë, ujit(tarifa shërbimi),

- Shpenzimet e mirëmbajtjes që kryhen për ruajtjen e pasurisë nga shkatërrimi, dëmtimi apo faktorë të tjerë dhe që kushtëzohen nga ruajtja e gjendjes fizike të pasurisë ashtu siç është marrë në dorëzim,
- Shpenzimet për pagesat për ndërrimin e bravave (dryna, kyçe etj.)**,**
- Shpenzimet për instalime dhe riparime të domosdoshme,
- Shpenzimet për pagesat e shërbimit të ruajtjes fizike të pasurive,
- Ambientet jepen me qira vetem në sezonin e pushimeve verore,dhe nuk kanë probleme me pasuritë(statusin e sekuestruar)

Efektet Pozitive nga dhënia me qira:

- Eleminimi i zërave të shpenzimeve të sipërcituara dhe shtimi i vlerës së pasurisë.

Sa më sipër kam shpjeguar në mënyre të konkretizuar ju bëj me dije:

- Pasuritë qe kam në administrim jan në emer të debitorit M F, dhe A N, persona të cilët kanë influencë negative në zonën ku ndodhen pasuritë,përsa i përket interesimit pë marrjen me qira të pasurive të tyre.
- Largohen të interesuarit sapo vihen në dijeni se kjo pasuri i përket personave me rekorde kriminale.
- Pasuritë kanë qenë bosh dhe të pa shfrytëzuara per një kohë të gjatë. Pra nuk kanë as paisjet minimale për një fuksionim normal.
- Kontratat janë një vjeçare
- Të interesuarit duhet investojnë një shumë të madhe për vënien në punë të saj.

Nisur nga problematikat e sipërcituara çmimet e qirave të propozuara nga komisioni kanë qenë atraktive dhe konkuruese në tregun e qiradhënies ku ndodhen pasuritë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. M.Ll.
2. N.Ll.
3. I.I.
4. H.S.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A.S.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT